Dituri natyre

Udhëzues për mësuesit



Terry Hudson

Alan Haigh

Debbie Roberts

Geraldine Shaw

1

botimet ideart

Udhëzues për mësuesit Dituri natyre 1

Titulli origjinal: OXFORD International Primary Science 1 Teacher's Guide
Shtëpia Botuese: OXFORD University Press

Autorë: Terry Hudson, Alan Haigh, Debbie Roberts, Geraldine Shaw
© Terry Hudson, Alan Haigh, Debbie Roberts, Geraldine Shaw 2014

OXFORD International Primary Science 1 was originally published in English in 2014.
This translation is published by arrangement with Oxford University Press.

Udhëzuesi për mësuesit Dituri natyre 1 është botuar fillimisht në gjuhën angleze në vitin 2014.
Ky tekst i përkthyer botohet në marrëveshje me Oxford University Press.

Botues: Redin JEGENI
Përktheu dhe përshtati: Fatbardh Sokoli, Kristaq Piti, Fatos Mustafaj
Redaktor letrar: Loredan Bubani

Ilustrimet: Oxford University Press
Design: OXFORD University Press
Dizajni për botimin shqip: Rezart Elezi

© Copyright IDEART 2015
© Të gjitha të drejtat e rezervuara

Riprodhimi i librit, qoftë edhe në formë të pjesëshme, është i ndaluar.
Nuk mund të kopjohet asnjë tekst apo zgjidhje grafike e tij pa lejen dhe miratimin paraprak të IDEART, i cili është mbajtës i vetëm i së drejtës së botimit dhe shpërndarjes së tij, përveç rasteve kur kjo e drejtë lejohet qartazi nga ligji.
Botuesi është i gatshëm t'i ofrojë të drejtat pa pagesë për citimet, përdorimet me qëllim studimi vetiak apo për elementë të veçantë grafikë që gjenden në këtë libër, duke nënshkruar fillimisht marrëveshje për to.
Të drejtat morale të autorëve dhe artistëve që punuan për realizminin e këtij projekti mbrohen nga IDEART, bazuar në legjislacionin shqiptar mbi pronësinë intelektuale dhe të Drejtat e Autorit, Nr. 9380, dt. 28.04.2005 si dhe në konventat, dispozitat dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

ISBN: 978-9928-128-98-0
(shënimi CIP i katalogut gjendet në Bibliotekën Kombëtare Tiranë)

Botimi i parë, 2015

www.ideart.al

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova"
Kompleksi "Green Park" 2/10
Tiranë Shqipëri
info@ideart.al
Tel: ++355 4 2233205

Përmbajtja

Hyrje **iv**

Si të bëhesh një shkencëtar **2**

1 Qeniet e gjalla dhe rritja **6**

E gjallë apo jo e gjallë 8

Ku jetojnë bimët dhe kafshët? 10

Familjet 12

Familjet 14

Çfarë kemi mësuar rreth qenieve të gjalla dhe rritjes 16

2 Bimët **18**

Pjesët e një bime 20

Rritja e bimëve 22

Rritja e bimëve 24

Çfarë u nevojitet bimëve për t'u rritur 26

Çfarë u nevojitet bimëve për t'u rritur 28

Çfarë kemi mësuar rreth bimëve 30

3 Ne njerëzit **32**

Të njëjtë, por të ndryshëm 34

Trupi ynë 36

Pesë shqisat 38

Pesë shqisat 40

Të ushqyerit e shëndetshëm 42

Çfarë kemi mësuar rreth njeriut 44

4 Larmia e materialeve **46**

Materiale të ndryshme 48

Vetitë e materialeve 50

Përdorimi i materialeve 52

Klasifikimi i materialeve 54

Çfarë kemi mësuar rreth larmisë së materialeve 56

5 Shtytje dhe tërheqje **58**

Si lëvizin trupat 60

Si lëvizin trupat 62

T'i bëjmë trupat të lëvizin më shpejt ose më ngadalë 64

T'i bëjmë trupat të lëvizin më shpejt ose më ngadalë 66

Vëzhgim mbi trupat që lëvizin 68

Vëzhgim mbi trupat që lëvizin 70

Çfarë kemi mësuar rreth shtytjes dhe tërheqjes 72

6 Prodhimi i tingujve **74**

Flasim dhe dëgjojmë 76

Flasim dhe dëgjojmë 78

Tingujt dhe lëvizja 80

Tingujt dhe lëvizja 82

Krahasimi i tingujve 84

Çfarë kemi mësuar rreth prodhimit të tingullit 86

Fjalor **88**

Plani mësimor **91**

Hyrje

Prezantimi i Shkencës Për Ciklin Fillor sipas Oxford International

Kjo seri bazohet në Strukturën e Provimeve Ndërkombëtare të Kembrixhit për Shkencën. Librat për çdo klasë janë në vijimësi, në mënyrë që të përmbushen të gjithë objektivat e specifikuara të të mësuarit-përfshirë këtu, ato që lidhen me kërkimin shkencor. Objektivat përkatëse për çdo mësim është i renditur në secilën faqe; shih "Përshkrimi i mësimit".

Kjo hyrje tregon sesi ju ndihmojnë librat të zhvilloni të kuptuarit, shprehitë dhe njohuritë shkencore tek nxënësit.

Librat janë hartuar për nxënësit e klasës 1-5. Për secilin vit ka një libër të nxënësit dhe një udhëzues të mësuesit.

Shkenca është një lëndë që përveçse ofron njohuri, është edhe një mënyrë të menduari dhe punuari. Ajo na ndihmon ta kuptojmë botën në të cilën jetojmë dhe na pajis me shprehi intelektuale që na ndihmojnë në të gjitha drejtimet e punës dhe në jetë. Kjo seri ka 4 qëllime kryesore:

- Të japë fakte dhe njohuri shkencore
- Të përfshijë të kuptuarit shkencor
- Të japë metodat shkencore të kërkimit
- Të nxisë të menduarit dhe arsyetimin shkencor

Libri i nxënësit i jep konceptet në një vijueshmëri logjike dhe mundëson një paraqitje konkrete të ideve të reja. Idetë shkencore dhe konceptet kyçe shpjegohen dhe më pas nxënësve u kërkohet të diskutojnë dhe t'i zbatojnë njohuritë e reja.

Të kuptuarit shkencor

Njohuria pa kuptimin është e thatë e vlen thjesht për rikujtesë. Të kuptuarit kalon në një nivel më të thellë intelektual dhe i mundëson nxënësit të mendojnë e të zbatojnë këto njohuri. Të mësuarit e frytshëm kërkon mbajtjen e qëndrimeve, zhvillimin e shprehive dhe të entusiazmit të duhur; kjo nxitet përmes mësimdhënies së mirë dhe burimeve të përshtatëshme të informacionit. Me zhvillimin e të mësuarit të frytshëm, nxënësi fiton parimet dhe praktikën shkencore.

Megjithëse ky nuk është një libër teorik, është me rëndësi të merren parasysh idetë përforcuese, të cilat kanë dëshmuar rezultat të mirë në klasë. Këto ndahen në tri kategori:

- Metoda e mësimdhënies
- Stili konjitiv
- Të mësuarit aktiv
- Të mësuarit aktiv

Faktet dhe njohuritë shkencore

Njohuria apo përmbajtja në këtë seri bazohet në strukturën e Kembrixhit. Ky libër ka 6 tematika:

Klasa 1		
Tematika 1.1 Qeniet e gjalla dhe rritja	Tematika 1.2 Bimët	Tematika 1.3 Ne njerëzit
Tematika 1.4 Larmia e materialeve	Tematika 1.5 Shtytjet dhe tërheqjet	Tematika 1.6 Prodhimi i tingujve
Klasa 2		
Tematika 2.1 Drita dhe errësira	Tematika 2.3 Materialet e ndryshueshme	Tematika 2.5 Dita dhe nata
Tematika 2.2 Elektriciteti	Tematika 2.4 Shikimi i shkëmbinjve	Tematika 2.6 Bimët dhe kafshët
Klasa 3		
Tematika 3.1 Proceset jetësore	Tematika 3.3 Bimët që çelin lule	Tematika 3.5 Shqisat
Tematika 3.2 Materialet	Tematika 3.4 Prezantimi i forcave	Tematika 3.6 Të ruash shëndetin
Klasa 4		
Tematika 4.1 Skeleti dhe muskujt	Tematika 4.3 Si funksionojne magnetët	Tematika 4.5 Krijimi i qarqeve
Tematika 4.2 Trupat e ngurtë,të lëngshëm dhe gaztë	Tematika 4.4 Habitatet	Tematika 4.6 Tingulli
Klasa 5		
Tematika 5.1 Mënyra si i shohim gjërat	Tematika 5.3 Cikli jetësor i një bime lulezuese	Tematika 5.5 Lëvizjet e tokës
Tematika 5.2 Avullimi dhe kondensimi	Tematika 5.4 Studimi i rritjes së bimëve	Tematika 5.6 Hijet

Metoda e mësimdhënies

Mësimdhënia është çelësi, por lloji i strategjive të përdorura është tepër domethënës nëse duam të arrijmë qëllimin e të kuptuarit. T'i tregosh dhe japësh nxënësit informacione është e rëndësishme, por këto janë sipërfaqësore për intelektin e tij/saj dhe zakonisht përmirësojnë thjeshtë kujtesën afatshkurtër të fakteve shkencore. Kjo quhet shpesh "të mësuarit pasiv", meqenëse nxënësi nuk angazhohet me intelektin e tij/saj gjatë procesit mësimor.

Shumë njerëz kanë një ide fikse se mësuesi/ja qëndron para nxënësve dhe u flet atyre duke përdorur shpesh dërrasën e zezë për të shkruar si dhe u jep atyre informacionin e ri për të mësuar. Hamendësimi që bëhet është se meqë mesimdhënia bëhet kësisoj dhe të mësuarit realizohet. Kjo metodë didaktike bazohet në idenë se komunikimi i drejtpërdrejt është strategjia e duhur. Përkundrazi, strategjitë heuristike e nxisin nxënësin t'i zbulojë vetë gjërat përmes vëzhgimit dhe kërkimit. Duhet të jetë e qartë se më shumë se dy të kundërta, këto dy filozofi zenë skajet e një spektri. Nuk ka të ngjarë që përvojat e të mësuarit të jenë ose didaktike, ose vetëm heuristike dhe është e vështirë ta përfytyrosh një mësues, pavarësisht filozofisë së tij/saj personale, të mbështetet plotësisht vetëm në njerën apo në tjetrën. Secila metodë ka përparësitë dhe dobësitë e veta.

Stili konjitiv

Stili konjitiv është mënyra e parapëlqyer dhe personale sesi një individ i organizon dhe i parashtron informacionet. Stili konjitiv ose mënyra e të menduarit ka ndikim në atë sesi nxënësi e sheh dhe e kupton botën.

Stilet konjitive qëndrojnë brenda këtyre dy dimensioneve.

1. Dimensioni analitik i së tërës. A e organizon një individ informacionin të plotë apo pjesë-pjesë?
2. Dimensioni i imazho-verbal. A e paraqet një individ informacionin me fjalë apo me figura?

Këto tregohen si më poshtë:

I plotë ⟷ analist

Verbal ⟷ imazhdhënës

Kjo na ndihmon të kuptojmë se disa nxënës priren ta shohin të gjithë panoramën kur studiojnë një çështje apo një temë, kurse të tjerë janë më rehat kur studiojnë vetëm një apo dy aspekte të tij.

Verbalët mendojnë me fjalë ose me anë të asosacioneve. Imazheristët përjetojnë imazhe mendore kur atyre u jepet informacioni. Këto stile konjitive mund të kenë ndikimin kryesor në përpunimin e informacionit.

Përparësitë e metodës didaktike • Objektiva të qarta të mësuari • Mësuesi demonstron një metodë profesionale p.sh paraqitjen • Mësuesi shihet si "ekspert" • Më pak probleme me menaxhimin e klasës dhe sjelljes		Përparësitë e metodës heuristike • Eshtë motivuese dhe e fuqishme • Zhvillon një varg shprehish • Të mësuarit është i duhuri • Nxit aftësitë krijuese dhe zgjidhjen e problemeve • Nxënësi ka rolin e tij në të mësuarit
Metoda didaktike	⟷	Metoda heuristike
Të metat e metodës didaktike • Mund të ngrihet mbi njohuri të pasakta • Mund të mos jetë motivuese • Nuk zhvillon shprehi • Nuk i jep nxënësit përgjegjësi • E kufizuar nga mësuesi		Të metat e metodës heuristike • Mund të mos trajtojë parimet themelore-tepër pragmatike • Nëse mësohen vetëm shprehitë ekzistuese, kjo metodë mund të mos nxisë shqyrtimin e metodave ekzistuese • Mungesa e strukturës mund të sjellë ngatërresa • Menaxhimi i klasës mund të jetë problematik

(Cotton, J., 1995, *The Theory, Learning, An and Introduction,* Kogan Page, London)

Eshtë shumë e rëndësishme të jeni në dijeni të stileve konjitive të mundshme të nxënësit dhe të siguroheni që metoda jonë nuk kërkon teprinë e një stili duke shmangur stilin tjetër. Për shembull, verbal përdor marëdhëniet shoqërore dhe grupimet shoqërore për t'i diskutuar idetë e tij/saj si ndihmëse për të mësuar, kështu që përfiton nga puna e diskutimit në grup. Imazheristi duket më pak i varur nga të folurit, si ndihmesë për të kuptuar.

Kjo lidhet me teorinë e inteligjencave të shumëfishta të Havard Gardnerit, e cila ka ngjashmëri me modelin më të thjeshtë por më të cituar të stileve të të mësuarit, atë Audio –Vizuale, Kinestetik (VAK i zhvilluar qysh në vitet '20). Gardneri identifikoi 7 lloje inteligjencash të shumëfishta dhe përdorimi i këtij modeli ka pasur një ndikim themelor në mësimdhënie. Shtatë inteligjencat janë:

- Gjuhësore – fjalët dhe gjuha
- Logjike-matematikore – logjika dhe numrat
- Muzikore – muzika, tingujt, ritmi
- Kinestetike-trupore – kontrolli i lëvizjeve të trupit
- Vizualo-hapësinore – imazhet dhe hapësira
- Ndërpersonale – ndjenjat e njerëzve të tjerë
- Intrapersonale – vetëdija e vetvetes.

Gardneri mendonte se lloji i inteligjencës ndikon në stilin e parapëlqyer të të mësuarit. Për shembull, personi që është shumë logjik dhe matematikor por i dobët nga ana gjuhësore mund të zhvillojë shprehi gjuhësore nëse nxitet të flasë e të shkruajë për matematikën e numrat.

Modeli VAK e pranon faktin që njerëzit mësojne në mënyra të ndryshme. Sipas modelit, pjesa më e madhe e njerëzve zotërojnë një stil dominant të mësuari, por shumë prej tyre mund të jenë një përzierje e dy apo e të trejave bashkë. Këto stile janë::

- Vizuale – me shikim dhe lexim
- Audio – me dëgjim dhe të folur
- Kinestetike – me prekje dhe veprim.

Eshtë e qartë që, nëse ne e pranojmë këtë model, atëhere puna jonë me nxënësit duhet të përfshijë aspekte nga secili stil i parapëlqyer. Nxënësi që ka një stil të mësuari vizual pengohet e mbase dekurajohet nëse dëgjon për periudha të gjata kohore. Po ashtu, nxënësi kinestetik preferon t'i bëjë gjërat në vend që t'i shikojë apo t'i dëgjojë.

Lev Vigocki nënvizoi rolin kyç të gjuhës në zhvillimin e fëmijës dhe nevojën për të marrë parasysh faktorët shoqërorë dhe kulturorë. Më tej, ai theksoi rëndësinë e marëdhënieve shoqërore ndërmjet mësuesit dhe nxënësit dhe nxënësve me njëri-tjetrin. Gjuha dhe trajtimi me diskutim kanë qenë çelësi për zhvillim.

Në vitet '70 Benjamin Blumi propozoi një 'taksonomi edukative' duke identifikuar 'territore' të ndryshme të të mësuarit:

- Konjitive – (njohuritë)
- Afektive – (qëndrimet)
- Psikomotore – (shprehitë).

Janë pikërisht idetë e Blumit për territorin konjitiv që kanë pasur një ndikim kaq të madh tek mësuesit dhe mësimdhënia. Territori mund të shihet si një shkallë që fillon me kujtesën dhe vazhdon me detyra më komplekse, si për shembull analizimi. Kjo na jep një të dhënë për progresin e kompleksitetit për veprimtaritë dhe pyetjet tona. 'Këmbët' e shkallës janë:

- Kujto të dhënat
- Kupto
- Zbato përdor
- Analizo
- Sintetizo
- Vlerëso

Kjo shkallë e ka ndihmuar mësuesin për hartimin e detyrave, vijueshmërinë e detyrave dhe të pyetjeve në përshtatje me nivelin e të menduarit të nxënësit. Eshtë me rëndësi që kjo të merret parasysh kur synoni të zhvilloni shprehitë e nxënësit për të menduar dhe për të arsyetuar.

Të mësuarit aktiv

Metodat e të mësuarit aktiv janë hartuar për ta nxitur nxënësin që të angazhohet me detyra dhe që të zhvillojë shprehi që kanë më pak gjasa të zhvillohen gjatë të mësuarit me qendër mësuesin, mësimet didaktike. Në njëfarë mënyre, të mësuarit aktiv është një term i përgjithshëm që lidh së bashku një mori modelesh mësimdhënieje që kanë dalë nga idetë e "të mësuarit me zbulim".

Eshtë e rëndësishme të theksojmë që tabela e mësipërme nuk tregon që majtas është mësimdhënia e keqe, (me qendër mësuesin) kurse djathtas është mësimdhënia e mirë (me qendër nxënësin). Faktet tregojnë se udhëzimi për të gjithë klasën mund të

Të mësuarit me qendër mësuesin	Të mësuarit me qëndër nxënësin
Ekspozimi i mësuesit	Puna në grup
Theksi mbi konkurrimin	Theksi mbi bashkëpunimin
Mësimdhënia për gjithë klasën	Të mësuarit bazuar në burimet e informacionit
Mësuesi përgjegjes për të mësuarit	Nxënësi më përgjeses për të mësuarit
Mësuesi që ofron njohuri	Mësuesi si udhërrëfyes/lehtësues
Nxënësi shihet si enë e zbrazët që duhet	Nxënësi ka autorësinë e ideve dhe punës
Njohuria e lëndës vlerësohet	Shprehitë në proces vlerësohen
Disiplina e vendosur nga mësuesi	Vet-disiplinimi
Theksimi i roleve mësues nxënës	Nxënësi shihet si burim njohurish dhe idesh
Mësuesi vendos për kurrikulën	Nxënësi i përfshirë në planifikimin e kurrikulës
Roli pasiv i nxënësit	Nxënësi i përfshirë aktivisht në mësim
Spektër i kufizuar stilesh të mësuari	Spektër i gjerë stilesh të mësuari në funksionim

jetë po aq i frytshëm sa edhe udhëzimi individual, sidomos përsa i përket kohës që nxënësi shpenzon për një detyrë. Çelësi për një mësimdhënie të mirë është përzgjedhja e duhur. Fraza më e përshtatshme mund të jetë: " përshtatja sipas qëllimit"

Strategjitë e mundshme për të mësuarit aktiv

- Diskutimi në grup (të flasësh dhe të dëgjosh)
- Të lëxuarit aktiv
- Të shkruarit aktiv
- Paraqitja
- Loja në role dhe dramatizimet
- Teknologjia e informacionit
- Vizitat, vizitorët dhe udhëtimet në terren
- Ballafaqimi i të dhënave
- Zgjidhja e problemeve
- Rregjistrimet audio dhe video
- Lojërat dhe simulimet

Në përputhje me idetë dhe filozofitë e parashtruara më sipër, libri i nxënësit i paraqet idetë me një larmi mënyrash: me shkrim, diagrame, grafikë, tabela dhe foto. Mësimet përmbajnë një shumëllojshmëri të gjerë metodash të të mësuarit dhe të mësimdhënies, si për shembull lexim dhe shkrim individual, në dyshe, diskutim në grupe të vogla, diskutim dhe veprimtari me të gjithë klasën, zgjidhje problemesh, shqyrtime, veprimtari kërkimore, prezantime, anketa, përsëritje dhe reflektim. Përveç këtyre, udhëzuesi i mësuesit ka të përfshira edhe sugjerime për veprimtari të tjera, si udhëtimet në terren dhe vizitat edukative.

Kërkimi shkencor- të mësuarit e proceseve shkencore

Kjo seri nxit kërkimet shkencore dhe ndjek nga afër metodologjinë e strukturës së shkencës në Kembrixh. Nxënësi nxitet të reflektojë mënyrat e ndryshme me të cilat shkencëtarët punojnë dhe mendojnë, të cilat kanë prodhuar njohuritë, teoritë dhe ligjet e shkencës në këto 100 vitet e fundit. Ajo bazohet në "empirizëm"; arritja te njohuria dhe te të kuptuarit përmes vëzhgimit dhe eksperimentit.

Shkencëtarët ecin përpara me anë të vëzhgimit dhe me vënien në pikëpyetje të asaj që shohin dhe dinë. Nisur nga kjo ata zhvillojne hipoteza që i provojnë me anë të eksperimenteve për të gjetur të vërtetën dhe për të zhvilluar njohuri. Kjo do të shpjegohet më tej në pjesën "Si të bëhesh një shkencëtar", në librin e nxënësit dhe në udhëzuesin e mësuesit.

Shkenca i mëson nxënësit të mendojnë në mënyrë të strukturuar, që është e mirë për të analizuar dhe zgjidhur probleme. Megjithatë, shkenca është edhe një orvatje njerëzore krijuese dhe ka rëndësi që nxënësi ta kuptojë këtë. Përfytyrimi është po aq thelbësor në progresin shkencor, sa është edhe në letërsi dhe në artet e tjera.

Librat në këtë seri i lejojnë nxënësit të zhvillojnë shprehinë e kerkimit shkencor duke iu drejtuar çdo procesi të duhur të kërkimit shkencor në secilën fazë. Përveç kësaj, në fazat e mëvonshme nxënësi nxitet të planifikojë dhe të kryejë një studim në shkallë të plotë dhe në këtë mënyrë t'i zbatojë shprehitë e mësuara më herët.

Hyrje

Të menduarit dhe të arsyetuarit shkencor

Eshtë thelbësore që përveç përvetësimit të njohurive shkencore, nxënësi të nxitet dhe të mësohet të mendojë dhe të gjejë arsyen e gjërave. Përveçse janë shprehi jetësore të rëndësishme, aftësitë për të menduar, arsyetuar dhe studiuar e bëjnë nxënësin të pavarur, në gjendje t'i interpretojë dhe kuptojë idetë e reja më shpejt. Fatkeqësisht, ky aspekt i edukimit shpesh neglizhohet.

Në këtë seri, kjo aftësi për të menduar dhe për të arsyetuar nxitet, ushqehet, praktikohet dhe vlerësohet në çdo nivel. Shkencëtarët përdorin të menduarin logjik deduktiv për të arritur në konkluzione të drejta, të cilat i çojnë ata tek e njohura, duke zbuluar të panjohurën. Ata përdorin arsyen dhe argumentin mbështetur në fakte dhe prova për të vërtetuar rastin. Duke e lejuar nxënësin t'i provojë keto procese, kureshtja dhe entuziasmi i tij ruhet, gjë që të mësuarit e një grupi faktesh nuk e bën dot këtë gjë. E gjithë premisa e metodave të "të mësuarit me zbulim" është që ne ta lejojmë nxënësin ta perjetojë gëzimin e zbulimit. Si mësues, ju kërkojmë t'i rezistoni tundimit për t'i dhënë nxënësit përgjigje, zgjidhje dhe më tepër ndihmë sesa duhet. Shpresojmë që veprimtaritë mësimore brenda librave dhe ndihmesa e dhënë në udhëzuesin e mësuesit , do t'ju ndihmojnë për të krijuar një mjedis mësimor ku sipas rastit, nxënësi të planifikojë, të zbulojë dhe t'i mësojë vetë idetë e reja, duke ju pasur juve si një udhëzues dhe lehtësues. Jepi atij kohë që t'i mendojë dhe t'i diskutojë idetë, përpara se t'i udhëzosh lehtësisht të tjerët që kanë nevojë për t'u ndihmuar.

Teknikat e mësimdhënies

Kjo është një hyrje e shkurtër për disa teknika mësimdhënieje që do t'ju ndihmojnë me mësim-dhënien dhe të mësuarit e njohurive shkencore.

Mund të thuhet që shkenca përbëhet nga tre kategori:

- Faktet shkencore
- Njohuritë shkencore
- Të kuptuarit e shkencës

Faktet shkencore dhe njohuritë shkencore janë të dobishme për t'i pasur, por fatkeqësisht ato jo gjithnjë përmbledhin edhe të kuptuarin e shkencës. Të jesh i aftë të kujtosh fakte dhe njohuri shkencore vlen, por vetëm kur do të duhet ta kujtosh atë fakt specifik. Për shëmbull:

- Pyetja: Kush ishte shkencëtari që zbuloi forcën e gravitetit?
- Përgjigje: Isak Njutoni

Fakti që nxënësi e di përgjigjen nuk e çon atë më tutje. Ajo nuk kërkon shprehi më të larta të organizimit të menduarit, as nuk e ndihmon për të zgjidhur ndonjë problem tjetër. Nga ana tjetër, nëse nxënësi e kupton teorinë e lëvizjes dhe të gravitetit të Njutonit, ai fillon të shpjegojë dhe të parashikojë sesi lëvizin, pluskojnë apo fluturojnë trupat.

Të kuptuarit i mundëson nxënësit për t'i zbatuar njohuritë, për zgjidhjen e problemeve dhe e bën atë të ecë përpara me të mësuarin.

Kjo seri synon të ofrojë fakte dhe njohuri shkencore por gjithashtu synon të kuptuarit shkencor. Disa strategji të caktuara janë më të mira për të mësuar të kuptuarin, sesa të tjerat.

Pyetjet e duhura janë çelësi

Njeriu mëson të kuptojë duke dëgjuar dhe duke lexuar, por kjo është e mundur vetëm atëhere kur ka përfituar teknika të sofistikuara të mesuari dhe ka një të kuptuar si dhe njohuri të përgjithshme të mjaftueshme ku ai mund të përputhë çdo ide të re. Ja sesi e përmirësoni të kuptuarin tuaj në lidhje me mësimdhënien, për shëmbull, përmes këtyre metodave, por kjo nuk është e vërtetë për atë që është nxënës fillestar. Për nxënësin pa përvojë dhe më pak të aftë, është mësuesi që i mundëson atij përparimin nga cektësia e kujtesës deri tek thellësia e të kuptuarit. Metodat e të mësuarit dhe të mësimdhënies që nxiten në këtë seri fokusohen në të mësuarit e të kuptuarit. Njohuritë dhe faktet shkencore sigurisht trajtohen, përndryshe do të kishte një mungesë të kontekstit dhe të përmbajtjes; veprimtaritë janë hartuar gjithashtu për të zhvilluar shprehitë e të menduarit dhe të mësuarit.

Studimet tregojnë se mësuesit bëjnë deri në 400 pyetje në ditë. Kjo mund të jetë 30% e kohës së mësimit. Atëhere, është e qartë se koha që shpenzohet për të përmirësuar teknikat e të pyeturit do të ketë një ndikim të rëndësishëm në të mësuarit.

Për t'iu dhënë një ide për kompleksitetin e pyetjeve duhet të sillni në vëmendje praktikën tuaj personale:

- Pse po e bëni pyetjen
- Çfarë lloj pyetjesh keni ndërmend të bëni
- Kur duhet të bëni pyetje
- Si keni ndërmend t'i bëni pyetjet
- Kujt do t'ia drejtoni pyetjet
- Si e prisni se do të jetë përgjigja e pyetjeve
- Si do të përgjigjeni nëse personi nuk e kupton pyetjen
- Si do të reagoni kundrejt një përgjigjeje të papërshtatshme apo të gabuar
- Si do të reagoni ndaj një përgjigjeje të saktë
- Sa kohë do të prisni për një përgjigje.

Si mësues, ne pyesim për një mori arsyesh:

- Për të tërhequr vemendjen
- Për të kontrolluar nëse nxënësit po na kushtojnë vemendje
- Për të përforcuar apo përsëritur një temë
- Për të rritur të kuptuarit
- Për të nxitur të menduarit
- Për të zhvilluar një diskutim

Për t'u përqëndruar tek të menduarit dhe të kuptuarit na nevojitet t'i rikthehemi Blumit. Siç u përmend, Blumi përshkruan 6 nivele të përpunimit të mendimit:

- Njohurinë
- Kuptimin
- Zbatimin
- Analizën
- Sintezën
- Vlerësimin

Kjo thekson nevojën për të bërë pyetje të hartuara mirë që nxisin të menduarin më të thellë. Nëse ne bëjmë pyetje vetëm tek skaji fundor i spektrit të njohurisë nuk do ta nxisim nxenësin te analizojë ose të sintetizojë idetë e reja. Neve na nevojitet gjithashtu të mendojmë për natyrën dhe stilin e pyetjeve tona. Dy kategoritë kryesore janë ato të hapura dhe të mbyllura.

Pyetjet e mbyllura

Këto priren të kenë një përgjigje të saktë ose një varg të kufizuar përgjigjesh. Ato kërkojne kujtesë faktike. Ato janë të dobishme për pyetje për të gjithë grupin apo si një punë e re. Për shembull:

- Pyetja: Cila është temperatura e vlimit të ujit në nivelin e detit?
- Përgjigja: 100°C.
- Pyetja: Cilat janë tri fazat e ciklit të ujit?
- Përgjigja: Uji; retë; shiu

Këto janë shumë të mira për të rikujtuar njohuritë por zakonisht nuk janë produktive për ndonjë gjë tjetër.

Pyetjet e hapura

Këto mund të kenë përgjigje të mundshme të ndryshme dhe mund të jetë e vështirë për të vendosur se cilat janë të sakta. Ato përdoren për të zhvilluar të kuptuarin dhe për të nxitur njerëzit të mendojnë për çështje dhe ide. Ato i nxisin njerëzit të mendojnë e të manipulojnë informacionin dhe janë shumë më komplekse. Ne nuk kërkojmë një përgjigje të vetme të saktë; ne kërkojmë për atë që nxënësi mendon se është përgjigja e duhur. Vetëm kur mësuesi e bën nxënësin të mendojë, atëhere ai mund ta përdorë këtë informacion duke e çuar të mësuarit drejt përgjigjes së duhur dhe në të njejtën kohë duke nxitur të kuptuarit.

Prandaj, këto pyetje janë produktive në drejtimin edukativ. Për shembull:

Pyetja: Ku mendon se e ka burimin uji në retë e shiut?

Përgjigja: Çdo përgjigje e ka një "saktësi" të vogël brënda, çka mësuesi e përdor. Nxënësi mund të përgjigjet "Nga deti".

Më pas, mësuesi ndjek linja të tjera të ndryshme pyetjesh për ta zgjatur të mësuarit. Për shëmbull, mësuesi mund të pyesë "A njeh burime të tjera nga vjen uji?"ose "Si mendon se uji kaloi te retë?" Këto pyetje pasuese me "si" dhe"pse" e nxisin nxënësin të mendojë më thellë për shkencën dhe të kuptuarit, për idetë dhe parimet bazë të saj. Pyetjet e hapura kërkojnë nga nxënësi të bëjë lidhjet ndërmjet ideve dhe njohurisë së zbatuar; ato shpesh kërkojnë një kohë më të gjatë për t'u menduar dhe përgjigjur sesa pyetjet e mbyllura dhe mund të çojnë në diskutime dhe debate më të gjera.

Seritë e pyetjeve

Pyetjet e hapura e të mbyllura mund të lidhen së bashku për të formuar një seri të tillë. Një seri pyetjesh duhet të planifikohet mirë dhe mund të çojë në përmiruesimin së tepërmi të të kuptuarit. Fillon me disa pyetje të mbyllura relativisht të thjeshta dhe kaloni te më tepër pyetje të hapura. Kjo njihet si "ndërtimi i axhendës". Ti mund të kalosh gjithashtu nga diskutimet individuale, në dyshe dhe më pas në grupe të vogla, ndërkohë që pyetjet bëhen më të hapura dhe kërkojnë një nivel më të lartë të menduari. Në këtë seri ne nxisim një "klasë pyetëse", ku përdoren pyetjet e mbyllura por gjithashtu edhe pyetjet e hapura, çka nxisin mëndjet për pyetje.

Disa këshilla - për teknikat e pyetje - përgjigjeve

1 Teknika "mos e drejto nxënësin në tunele të errëta". Nxënësi duhet ta dijë se ku po shkon para se ta nisë udhëtimin e tij të të mësuarit, prandaj atij i duhet treguar atij kjo gjë. P.sh.:

"Sot do të mësojmë sesi magnetët veprojnë ndaj njëri-tjetrit" .

Kjo pyetje i jep nxënësit idenë kryesore se ku ta mbështesë informacionin që pason dhe ta kuptojë atë me logjikë.

2 Teknika "pyete nxënësin se çfarë mendon ai" Nxënësit zakonisht i mungon siguria për t'iu përgjigjur pyetjeve si:

'Si kaloi uji nga deti te retë?'

Po të mos jetë i sigurtë që e di përgjigjen e saktë, ai ndoshta nuk do jetë i gatshëm për t'u përgjigjur sepse ka frikë nga dështimi. Gjithsesi, rregullojeni pyetjen dhe thuaj:

Si mendon se uji ka kaluar nga deti tek retë?

Kështu, po e lejon atë të përpiqet për përgjigjen e saktë edhe nëse ai nuk është i sigurtë. Kësisoj, nuk ke të njëjtët nxënës që dalin vullnetarë per t'u përgjigjur dhe u jep nxënësve të tjerë sigurinë duke u rritur vetëvlerësimin.

3 Teknika "lavdërimi për të gjitha përgjigjet".

Nëse nxënësi do të jetë bashkëpunues, i hapur për t'i ndarë mendimet dhe sugjerimet e tij/saj, atëhere ne duhet ta vlerësojmë dhe të lavdërojmë për përpjekjet e tij/saj, pa i dhënë rëndësi sa gabim mund të jetë; edhe nëse situata është "Përpjekje e mirë, por ende jo aty ku duhet". Shih nëse mund ta ndihmosh mendon se mund të ketë lidhje me nxehtësinë e Diellit?'

Në shumicën e përpjekjeve të nxënësit, ekziston një element saktësie për të cilën mund ta lavdërojmë.

4 Teknika "shpjego nëpërmjet përgjigjeve të nxënësve"

Në librin e nxënësit gjendet një pyetje e tillë:

Pse lëvizin trupat?

Si nxënës, unë nuk e di përgjigjen dhe i druhem gabimit. Nëse mësuesi përdor teknikën 2 dhe 3 dhe e pyet nxënësin se çfarë mendon si dhe e vlerëson përgjigjen e tij/saj, atëhere kjo linjë produktive pyetjesh do të bëjë që mësuesi ta çojë nxënësin dhe pjesën tjetër të klasës jo vetëm tek përgjigja e saktë, por gjithashtu edhe te të kuptuarit.

Arti i këtyre teknikave është të përzgjedhësh elementin e saktësisë te nxënësi, e më pas ta zgjerosh dhe ta shpjegosh për t'i ndihmuar gjithë të tjerët ta kuptojnë. Për shëmbull:

Nxënësi: Unë mendoj se kjo vjen për shkak se trupat shtyhen dhe tërhiqen.

Mësuesi: Përgjigje e mirë. E gjitha ka të bëjë me forcat që veprojnë mbi trupin. Gjithsesi, a mendon se trupi në rënie shtyhet? Apo tërhiqet?

Nxënësi: Jo, vetëm tërhiqet!

Mësuesi: Mirë, kjo është e rëndësishme. Më ke thënë se mbi trupin që noton veprojnë forca shtytëse dhe tërheqëse. Si mendon, a janë të njëllojta ato?

Në këtë mënyrë mësuesi drejton, zgjeron dhe adreson përgjigjet e nxënësit te mbërrijne tek te kuptuarit e përgjigjes. Ti thjesht mund t'ia thuash nxënësit që në fillim si udhëzim didaktik, megjithatë do të zbulosh që për shkak se ka qenë aktivisht i përfshirë në këtë udhëtim ai jo vetëm që nuk do ta harrojë por do ta kuptojë.

5 Teknika "mos e ler nxënësin të ketë vështirësi"

Nëse zbulon që po i drejtoni pyetje dhe përgjigjet nuk çojnë fare tek ajo që po kërkon, atëhere jepi nxënësit përgjigjen ose sugjeroi një zgjedhje pyetjesh. Pa e bërë këtë gjë, përparimi i mësimit ndalet dhe mësuesi e nxënësi irritohen; vazhdo me mësimin. Tregoi, zgjeroi dhe shpjegoi atij përgjigjen.

6 Teknika "përgjigja e duhur"

Nëse merr përgjigjen e duhur, atëhere çdo gjë është mirë apo jo? Vetëm personi që ka dhënë përgjigjen

e kupton pse është e saktë, kështu që ti duhet ta zgjerosh dhe ta shpjegosh atë, në mënyrë që pjesa tjetër e klasës të bëhet pjesë e të kuptuarit të nxënësit.

Mësuesi: Përgjigje e mirë, çfarë të bëri të mendosh për të?

Mësuesi: E kuptoj ku e ke fjalën; ti bëre lidhjen ndërmjet çajnikut që vlon dhe avullit, prandaj mendove se nxehtësia e Diellit bën të njejtën gjë me detin, veçse që është e padukshme. Të lumtë!

Teknikat e mësimdhënies së studimit shkencor

Teknikat e lartpërmendura janë e njejta strategji që përdoret për pyetjet shkencore. Gjithsesi, në kërkimin shkencor ekziston një shtresë metodologjie për t'u shtuar, ku këto shprehi shkencore duhet të mësohen: vëzhgimi, krahasimi, parashikimi, faktorët identifikues, ndryshorja e kontrollit, testimi i besueshëm, regjistrimi dhe interpretimi.

Tanimë teknika jote duhet të zgjerohet tek pyetjet rreth proceseve ashtu si dhe tek pyetjet rreth përmbajtjes. Për shëmbull:

- Çfarë mendon se do të ndodhë?
- Pse po të kërkohet që të shtosh ekzaktësisht 200 cm^3 ujë? Pse mos të shtosh më tepër?
- Çfarë sheh? A ke parë diçka të tillë më parë?
- Si do ta provoje për të parë se kush është më e lehtë?
- Pse më parë kjo provë nuk është e besueshme?

Tek pjesa "Kërkimi shkencor" të udhëzuesit të mësuesit ka më tepër sugjerime dhe këshilla për metodat e përshtatshme.

Libri i nxënësit përfshin një mori shëmbujsh me pyetje të tilla, por ti munde t'i ndjekësh ato hap pas hapi duke i bërë një mënyrë të zakonshme për të nxitur nxënësit të mendojnë për shkencën. Kur je duke demonstruar një dukuri apo diskutuar një ide, bëji nxënësit pyetje të bazuara në studim. Përfshi gjithashtu pyetje për sigurinë dhe për përdorimin e përditshem të shkencës. Metoda e bazuar në studim e nxit nxënësin të mendojë pse dhe si, jo thjesht, çfarë.

Puna në grupe ose me gjithë klasën

Pjesmarrjen dhe ndihmesën më të madhe zakonisht e nxisin grupet e vogla. Puna në grup mund ta ndihmojë nxënësin të mësojë më mirë. Ai e mëson shkencën më mirë dhe të mësuarit bashkëpunues ndihmon në marrëdhënien shoqërore, motivimin dhe në përmiresimin e vetëvlerësimit. Nxënësi që është i ndrojtur ka më shumë gjasa të ndihmojë në një diskutim kur është bashkë me një person ose dy persona të tjerë, sesa t'i shprehë vullnetarisht idetë e tij para të gjithë klasës. Grupi i vogël është gjithashtu një forum i mirë për të gjeneruar kreativitet.

Një përparësi tjetër për mos t'u nënvlerësuar është që puna në grupe të vogla e liron mësuesin nga të qenurit para klasës dhe të drejtuarit e tërë klasës. Mësuesi mund të lëvizë nëpër dhomës dhe të drejtojë vemendjen dhe mbështetjen kur dhe aty ku është më së shumti e nevojshme. Kështu mund të përmbushen më mirë nevojat individuale

Si t'i përdorim këto libra?

Libri i Nxënësit

Faqet e para

Çdo tematikë fillon me faqe hyrëse plot ngjyra. Qëllimi i këtyre faqeve është për ta filluar tematikën me një sërë imazhesh dhe veprimtarish të gëzueshme që e angazhojnë menjëhere nxënësin në idetë kryesore që përfshihen në atë tematikë. Gjithashtu nxënësi nxitet të mendojë për të kuptuarit dhe njohuritë që ka. Këto faqe hyrëse janë kryesisht figurative, por me disa pyetje dhe veprimtari të shkurtra për të paraqitur një skicim të shpejtë të asaj që do trajtohet dhe për të nxitur diskutimin. Kjo e ndihmon nxënësin të shohë thelbin e tematikës dhe përmbajtjen e saj. Nxite sa më shumë diskutimin kur përdor faqet hyrëse. Kjo ofron një mundësi shumë të mirë për të vënë theksin në studimin shkencor dhe shprehitë vëzhguese. Në udhërrëfyesin e mësimdhënies ofrohet një ndihmesë më e madhe; aty ka ide specifike të lidhura me secilën faqe hyrëse.

Faqet tematike

Për secilën tematikë pjesa më e madhe e faqeve të temave, lidhet me përmbajtjen shkencore ose me studimin shkencor përkatës. Secila prej tyre është e lidhur drejtpërdrejt me një objektiv të të mësuari për atë temë. Faqet janë shumë figurative, me figura tërheqëse që lidhen me temën, me diagrame e veprimtari.

Në librin e nxënësit paraqiten 5 lloje veprimtarish:

Veprimtaritë me shkrim. Ekziston një hapësirë për nxënësin për të shënuar përgjigjet e shkurtra të pyetjeve kyçe, duke përdorur informacionin në këto faqe.

Veprimtaritë me diskutim. Nxënësi nxitet të diskutojë ide dhe metoda shkencore dhe mendohet të punojë në grupe dyshe dhe në grupe të vogla prej 3 ose 4 vetash për këtë lloj veprimtarie.

Puna kërkimore. Tek libri i nxënësit nxënësi prezantohet me punë kërkimore dhe krahas tij nxitet të përdorë fletoren e punës për veprimtari kërkimore duke mbajtur shënime shkencore dhe rezultate për secilën punë kërkimore. Puna kërkimore ndihmohet edhe nga udhëzimet hap-pas-hapi të udhëzuesit të mësuesit.

Veprimtaritë e matjes.

Pyetjet "Mendo rreth...".

Udhëzuesi i Mësuesit

Udhëzuesi i Mësuesit përmban përgjigjet e pyetjeve me shkrim dhe përgjigjet e sugjeruara nga nxënësi kur ai angazhohet në veprimtari diskutimi. Për më tepër, sigurohet ndihmë edhe nga veprimtaritë e sugjeruara jashtë-klase si edhe nga pyetjet hap pas hapi, të cilat mund të doni t'i përdorni.

Aftësitë e kërkimit shkencor

Një element shumë i rëndësishëm dhe i përbashkët në faqet e librit të nxënësit janë veprimtaritë e ideuara për ta ndihmuar nxënësin të zhvillojë shprehitë e tij/saj të kërkimit shkencor. Nxënësi/ja nxitet të bëjë parashikime, të hartojë dhe të planifikojë punë kërkimore për kryerjen e hetimeve të përzgjedhura dhe për mbledhjen e të dhënave të sondazheve, për interpretimin dhe analizën e rezultateve. Nganjëherë shprehitë e kërkimit shkencor trajtohen veçmas, kurse herë të tjera, sidomos në fazat e mëvonshme, nxënësi/ja mundohet t'i bashkojë ato për të kryer kërkime deri diku komplekse.

Për t'i ardhur në ndihmë zhvillimit të kësaj shprehie, veprimtaritë kërkimore kanë udhëzime të qarta apo, edhe nëse kanë për synim të jenë me një fund të hapur, ato përmbajnë një sërë pyetjesh ose udhëzimesh shtesë. Shënimet shpjeguese ndihmojnë për organizimin e klasës, për procesin e punës kërkimore, për rezultatet e pritshme dhe për burimet e informacionit.

Fletore pune për veprimtari kërkimore

Përgjigjet e shkurtra për pyetjet e llojit kërkimor shkruhen në hapësirën e caktuar në librin e nxënësit, por aty ku kërkohet planifikim më i hollësishëm pune kërkimore dhe planifikuese, nxënësi/ja kështillohet të përdorë një fletore për veprimtari kërkimore. Ju sugjerojmë ta pajisni nxënësin/en me një fletore shënimesh me fletë A4 në fillim të çdo faze, për ta përdorur për punë kërkimore përgjate gjithë vitit. Ky është një model sesi punojnë shkencëtarët; kështu siguroheni që nxënësi/ja i mban me hollësi planet, shënimet, regjistrimet, idetë dhe përmbledhjet në këtë fletore. Kjo e lë librin e nxënësit per pergjigje të shkurtra dhe të shpejta.

Pyetjet "Mendo rreth..."

Gjithashtu në disa raste secila tematikë përmban rubrika "Mendo rreth ... ". Këto synojnë të nxisin nxënësin/en të mendojë më thellë për një koncept ose që ai të përpiqet ta zbatojë një ide në një kontekst të ri. Ato janë shumë të dobishme për zhvillimin e shprehive të të menduarit dhe përdoren gjithashtu për diferencim.

Vlerësimi i njohurive

Çdo temë brenda nje tematike përmban në fund një mundësi vlerësimi. Kjo përbëhet nga pyetje me një larmi formatesh: lojëra të vogla, gjëegjeza, skema për t'u emërtuar, të cilat e nxisin nxënësin/en të provojë se sa ka kuptuar për objektivin e trajtuara. Tek shënimet e shpjegimit jepen këshilla sesi mund të përdoren dhe të integrohen ato në mësim.

Përveç kësaj, çdo tematikë tek libri i nxënësit mbyllet me rubrikën "Çfarë kemi mësuar rreth...". Megjithëse janë të vendosura në fund të tematikës këto faqe janë ideuar për t'u përdorur gjatë tematikës. Pasi mbaron secila temë dhe është kryer vleresimi formues, nxënësi/ja mund t'i qaset veprimtarive të duhura tek faqet "Çfarë kemi mësuar rreth...". Këto janë një provë e shkurtër për të mësuar se sa kanë kuptuar dhe një mundësi për të rishikuar përparimin dhe sigurinë. Duke iu rikthyer faqeve "Çfarë kemi mësuar rreth..." kur trajtohet çdo temë nxënësi/ja angazhohet rregullisht në procesin e përsëritjes dhe të reflektimit.

Përsëritje dhe reflektim njohurish

Ne fund të tematikës kerkoju nxënësve t'u hedhin një sy faqeve të përsëritjes dhe të shohin përparimin që kanë berë. Ai ritakohet me përgjigjet më të hershme dhe monitoron përparimin e tij/saj. Vlerësimi i shkallës së vetësigurisë lihet në gjykimin tuaj. Nxënësit/es i paraqitet një rrethor bosh dhe ti i

kerkon atij ta plotësojë atë brenda në disa mënyra, në varësi të moshës së tij dhe pëlqimit tuaj. Për shembull, ai mund të bëjë një fytyrë të buzëqeshur, fytyrë "asnjanëse" apo të ngrysur për të treguar shkallë të lartë, mesatare apo të ulët vetësigurie. Në mënyre të ngjashme, mund t'i kerkosh atij/asaj ta ngjyrosë rrethin me të gjelbër për të treguar shumë vetësiguri, me të verdhë për vetësiguri mesatare dhe me të kuqe për mungesë vetësigurie. Ndryshe, mund të krijosh një sistem më të sofistikuar duke i kërkuar nxënësit/es të shkruajë një numër nga 1 deri në 5 brenda rrethorit, ku 1 ka kuptimin që ai nuk ka vetësiguri dhe 5 që ai ka shumë vetësiguri.

Sistemi i dytë të lejon ta nxitësh nxënësin/en t'i shtojë pikë vetes për një tematike apo grup tematikash duke grumbulluar kështu disa të dhëna për përparimin.

Fjalori shpjegues

Libri i nxënësit përmban në fund edhe një fjalor shpjegues, i cili mbështetet në të gjitha tematikat. Kur nxënësi prezantohet me një fjalë të re kyçe, që i përket ose përmbajtjes ose kërkimit shkencor, kërkoi ta përfshijë në fjalorin e tij duke e parë fjalën në fund të librit dhe duke shkruar me ndihmën tënde, një përkufizim të thjeshtë me fjalët e tij. Atë e ndihmon shumë edhe libri i nxënësit, meqenëse fjalët kyçe nuk paraqiten pa u shpjeguar. Qëllimi i krijimit të fjalorit shpjegues nga vetë nxënësi është të nxisë një proces më interaktiv dhe të ndihmojë të mësuarit. Kjo gjë ndihmohet nga fjalori shpjegues i plotë i fjalëve kyçe në udhëzuesin e mësuesit.

Si ta përdorni formimin gjuhësor në klasë

Studimi i shkencës përfshin njohjen e një fjalori të gjerë dhe specifik. Kjo ndonjëherë njihet si gjuha e shkencës. Librin e nxënësit e ndihmon zhvillimin gjuhësor duke identifikuar qartë fjalët kyçe te rubrika "Fjalë kyçe" tek faqet hyrëse dhe duke theksuar me bojë të zezë përmbajtjen e rëndësishme dhe fjalët e studimit në çdo mësim. Fjalori shpjegues interaktiv është gjithashtu me rëndësi të madhe për ta ndihmuar nxënësin të kuptojë gjuhën. Faqet e temave në librin e nxënësit i kombinojnë gjithashtu fjalët me figura, meqenëse kjo është më e frytshmja për ta ndihmuar nxënësin të mësojë kuptimin e fjalëve. Lidhja e figurës me fjalën është një faktor kyç për zhvillimin gjuhësor. Faqet "Çfarë kemi mësuar rreth ... janë gjithashtu shumë të rëndësishme; libri i nxënësit i paraqet dhe i përforcon fjalët duke i shfaqur ato dhe më pas nxënësit i kërkohet t'i përdorë në diskutime dhe përgjigje.

Çdo pjesë e shënimeve të shpjegimit e lidhur me një veprimtari apo mësim të veçante ofron gjithashtu ndihmën gjuhësore specifike. Këshilla të hollësishme jepen për çdo fjalë kyçe dhe fjalë të tjera me rëndësi për shkrim e lexim shkencor. Sugjerohen një grup strategjish, përfshirë këtu renditjen e letrave dhe lojrat me letra, lojrat në grup për të përkufizuar ose shpjeguar fjalët, përdorimin e fjalëve të ngjashme për të shpjeguar kuptimin dhe origjinën e fjalëve.

Parimet bazë që e përforcojnë formimin gjuhësor:

- Fjalët duhet të paraqiten dhe shpegohen me kujdes.
- Fjala duhet të shpjegohet në kontekst.
- Ripërsëritja është me rëndësi.
- Fjala duhet të lidhet me figura ose veprime.
- Nxënësi duhet të zhvillojë fjalorin e tij shpjegues.
- Mësimi i fjalorit duhet të jetë argëtues.

Jo të gjithë nxënësit i kuptojnë me të njejtën shkallë idetë dhe konceptet, sepse edhe shprehitë gjuhësore i kanë të ndryshme. Faqet e librit të nxënësit janë hartuar për t'u ndjekur e përdorur lehtësisht, por ka gjithashtu sugjerime për punë dhe veprimtari të mëtejshme brenda secilit mësim tek udhëzuesi i mësuesit. Këto ndihmojnë që të diferencosh mësimin dhe të ofrosh mundësi të ndryshme të mësuari. Këshillat për punën në dyshe dhe në grup do të duken me vlerë të veçantë për përmbushjen e nevojave që ke. Përpos kësaj fletorja e punës me veprimtaritë kërkimore për nxënësit përmban një larmi të gjerë fletësh pune, veprimtarish dhe sugjerimesh, si ndihmë shtesë për punë jashtë klase dhe për të nxënë vetë në shtëpi. Përveç kësaj fletorja e punës i strukturon veprimtaritë kërkimore në mënyrë më të hollësishme, sidomos punën kërkimore, dhe për nxënësin më të dobët ajo është me vlerë të veçantë.

Si të bëhesh një shkencëtar: Kërkimi shkencor

Këto faqe do të mbështetin të mësuarit e nxënësve se si të ndjekin një kërkim shkencor dhe drejtime kërkimore në mësimin e shkences. Struktura e këtyre faqeve ndjek rigorozisht faqet në librin e nxënësit, kështu që mund ta udheheqesh nxënësin klasë pas klase në procesin e mësimit të shkencës.

Skema na tregon idetë kryesore rreth kërkimit shkencor që i jepen nxënësit.

Nxënësit gjithashtu marrin një shembull të një hetimi shkencor:

Cili material është më i mirë për ta ruajtur pambukun të thatë?



Disa njohuri paraprake

Nxënësit kanë bërë punë praktike në mësimin e shkencës edhe vitet e kaluara. Shpesh ata vetëm mund të kenë shikuar një demostrim ose të kenë kryer ndonjë eksperiment duke ndjekur udhezime me shkrim ose me gojë. Ndonëse kjo mund të duket e dobishme prapë se prapë kjo nuk i lejon ata të zhvillojnë aftësitë e tyre në kërkimin shkencor.

Synimi për kërkimin shkencor të përshtatur në këtë skemë është të nxisë nxënësit të bëhen më të përgjegjshëm në përcaktimin e asaj se çfarë dhe si duhet të vëzhgojnë. Nxënësit nxiten të reflektojnë për rezultatet dhe të shpjegojnë se çfarë u tregojne ato. E gjithe kjo mund të përmblidhet në:

ÇFARË po vëzhgoj?

SI po e vëzhgoj këtë?

ÇFARË më tregojnë rezultatet?

Nxënësit nuk duhet t'i kryejnë vëzhgimet e plota gjatë gjithë kohës. Ti mund t'i përqendrosh në një ose në dy nga fazat e kërkimit shkencor. Per shembull, paraqitu nxënësve rezultate nga burime të tërthorta dhe kërkoju atyre t'u japin kuptim këtyre rezultateve. Ose planifiko një hetim dhe diskutoje këtë, por mos e kryej hetimin. Kjo është një mënyrë e dobishme për të zhvilluar aftësi të kërkimit shkencor. Ndërkaq, është gjithashtu e rëndësishme që nxënësit të bëhen bashkë për të kryer hetime të plota. Kështu do të veprojnë ata kur të bëhen shkencëtarë.

Hetimet janë veprimtaria më e mirë brenda kontekstit të ideve shkencore që janë studiuar prej kohësh. Ato kurrë nuk duhet të jenë veprimtari plotësuese ose të bëhen sipas dëshirës. Nxënësve u nevojitet të kenë njohuri të mjaftueshme shkencore për të kapur kuptimin e hetimit që do të bëjnë. Idetë e kërkimit shkencor në skemen e mësipërme fillojnë me një situatë nxitëse. Është e rëndësishme që ne të ndërtojmë kontekstin brenda të cilit nxënësit mund të bëjnë pyetjet e duhura. Ata duhet të kenë një sasi informacioni për të kuptuar idetë shkencore bazë dhe për të bërë pyetje, por jo aq sa të shuhet kurioziteti dhe kënaqesia e zbulimit që do të presin.

Për këtë do t'ju ndihmonte puna me nxënësit sipas një rrjeti planizues. Ata mund ta shfrytëzojnë këtë rrjet, ndërmjet intervaleve të fazave te kërkimit shkencor.

Si përmbledhje:

Konteksti ⟶ Njohuri paraprake⟶ Nxitja ⟶ Kërkimi shkencor.

Bëj pyetje

Çelësi i një kërkimi shkencor të dobishëm është të nxitim nxënësit të bëjnë pyetje. Në shembullin e librit të nxënësit, nxënësve u kerkohet të fillojnë pyetjet me fjalë të tilla si: "cili", "çfarë", "si", "bëje", "a e bën". Atyre u jepen disa pyetje në përshtatje me shembullin e hetimit që do të bëjnë:

- Cili material është më i mirë për ta mbajtur pambukun të thatë?

- Çfarë do të ndodhë kur materialin e futim në ujë?
- A e ruan të thatë pambukun ky material?

Ndihmoi nxënësit të bëjnë pyetje. Kjo është pjesë e kërkimit shkencor. Edhe kur nuk zhvillon ndonjë vëzhgim, ti mund t'i nxitësh aftësitë pyetëse. Kur merr përsipër të bësh një vëzhgim përdor pyetje të tilla si: "Çfarë do të ndodh nëse..." ose "Pse bëhet kështu..."

Mendo se...

Në klasat e mëpasme kjo fazë quhet "parashikim". Në këtë fazë nxënësit nxiten të diskutojnë rreth asaj se çfarë mendojnë ata se do të ndodhë gjatë vëzhgimit. Nxënësve u jepet shembulli i një pyetjeje dhe i një parashikimi.

Pyetja: Cili material do ta ruajë pambukun të thatë për një kohë më të gjatë?

Parashikimi: Qesja plastike.

Ndihmoi nxënësit ta kuptojnë këtë fazë duke krijuar situata të ndryshme për të mbështetur parashikimin e tyre. Mbaje pambukun mbi ujë dhe pyet "Çfarë do të ndodhë nëse në pambuk do të futet ujë?" Klasa mund të diskutojë alternativa të ndryshme. Përgjigjet e sakta janë: "Pambuku do të bjerë", nëse mendojnë për forcat, ose "Pambuku do të laget", nëse mendojnë për vëzhgimin. Ata do të parashikojnë se çfarë do të ndodhë edhe gjatë zhvillimit të vëzhgimit.

Arrij tek...

Në klasat e mëpasme kjo fazë njihet si "planifikim i vëzhgimit". Nxënësit duhet të planifikojnë se çfarë kushtesh dhe pajisjesh nevojiten për realizimin e vëzhgimit. Këto ide lidhen me vëzhgimin e marrë si shembull, por gjithmonë bëhen dy pyetje të rëndësishme:

Çfarë do të mbash të pandryshuar?
Çfarë do të ndryshosh?

Është ide shumë e rëndësishme të diskutosh planin e vëzhgimit para se ta fillosh. Kjo do t'i lejojë nxënësit të kërkojnë shëmbuj të mirë dhe do të mundësojë kontrollin e ecurisë së planit. Nuk është kurrë herët që t'i mësojmë nxënësit të vlerësojnë se kur një provë është e besueshme.

Kërko për...

Kjo fazë mbështetet në aftësitë vrojtuese dhe në saktësinë e matjeve. Në vëzhgimet e paraqitura në faqet e librit të nxënësit, nxënësit:

- matin kohën.
- përcaktojnë se cilët trupa janë të lagur ose të thatë.

Në vëzhgime të tjera nxënësi do të duhet të përdorë vizoret ose termometrat. Kërkoju nxënësve të kenë parasysh se ka rëndësi edhe saktësia e matjeve. Kujtoju nxënësve se sa rëndësi ka për një mjek matja me kujdes e temperaturës. Për t'i ndihmuar nxënësit të bejnë një vëzhgim, mund të organizosh një lojë vrojtimi. Vendos dhjetë trupa mbi tryezë dhe lëri nxënësit t'i shikojnë për 30 sekonda. Pastaj ata mbyllin sytë; largo njërin nga trupat dhe u thuaj të hapin sytë. Kërkoju të shkruajnë se cili trup mungon.

Zbuloj se...

Sigurohu që nxënësit e dinë se ka metoda të ndryshme për të regjistruar rezultatet. Në këtë fazë të moshës së tyre, mënyra më e zakonëshme është ndërtimi i një tabele. Në Librin e Nxënësit tregohen tabelat për raste të tilla, por përshkruhet edhe mënyra si ndërtohet ajo. Nxënësit nxiten t'u kthehen herë pas here tabelave duke e përsëritur zbulimin e kryer në mënyra të ndryshme: duke shkruar fjalë, duke bërë skema ose duke folur.

Kjo do të thotë se...

Nxënësit nxiten t'i shikojnë rezultatet me kujdes. Në vëzhgimin e marrë si shembull ata krahasojnë materiale të ndryshme.

- A shikoni ndonjë rregull?
- A mund të vendosin se cili nga materialet është më i papërshkueshëm nga uji?
- A ishte i saktë parashikimi i tyre?

Kërkoju nxënësve të mendojnë nëse mund të bëjnë ndonjë përmirësim lidhur me matjet. Ky është një aspekt i rëndësishëm i kërkimit shkencor.

Si të bëhesh një shkencëtar: Fleta e vëzhgimit

Rrjeta e planifikimit të kërkimit shkencor

Bëj pyetje

Çfarë po përpiqem të hetoj? Cila është pyetja ime?

Mendo se...

Unë mendoj se ...

Arsyeja ime është që ...

Arrij tek...

Unë do të kem nevojë ...

Çfarë do të ndryshoj?

Çfarë do të mbaj të njëjtë?

Ajo që do të mat është ...

Ajo që unë do të bëj është ...

Do të jem i kujdesshëm për...

Skema ime për çfarë do të arrij

Kërkoj për...

Si mund t'i bëj vëzhgimet e mia të sakta?

Cilat pajisje matëse mund të përdor?

Zbuloj se...

Si do t'i mbaj rezultatet e mia të rregullta dhe të qarta?

A do të përdor një tabelë?

A do të ndërtoj një diagramë apo një grafik?

Tabela ime do të duket si kjo

Kjo do të thotë se...

A mund të dalloj ndonjë rregull (model)?

A ka ndonjë rezultat jo të zakonshëm?

A e mbështetin rezultatet parashikimin tim?

Si mund ta bëj hetimin më të saktë?

1 Qeniet e gjalla dhe rritja

Në këtë tematikë nxënësit:

- dinë se bimët dhe kafshët janë gjallesa;
- dinë se ka gjëra që nuk kanë qënë asnjëherë të gjalla;
- ekspolorojnë mënyrat se si bimët dhe kafshët popullojnë mjediset lokale;
- dinë për nevojën e një diete të shëndetshme që përfshin llojet e duhura të ushqimit dhe ujin;
- dinë se njerëzit dhe kafshët japin pasardhës, të cilët rriten dhe bëhen të rritur.



Njohuri përgatitore

Kjo tematikë u paraqet nxënësve idenë, se bimët dhe kafshët janë gjallesa që rriten dhe ndryshojnë. Nxënësit bëhen të vetëdijshm për ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet bimëve dhe qënieve tjera të gjalla dhe njohin se ka disa gjëra që nuk kanë qënë asnjëherë të gjalla.

Aftësitë e hulumtimit shkencor

Përmes kësaj tematike nxënësve u jepet mundësia për t'iu përgjigjur pyetjeve nga të dhënat e grumbulluara me anë të vëzhgimit. Ata do të kontribuojnë në diskutime dhe do të bëjnë supozime (parashikime) për dukuritë shkencore. Nxënësit do të mësojnë se si duhen sugjeruar idetë, si duhet të ndjekin udhëzimet dhe të regjistrojnë të dhënat. Përveç kësaj nxënësit do të krahasojnë të dhënat dhe do të shohim nëse parashikimet përputhen me rezultatet e tyre. Nxënësit do të modelojnë dhe do të komunikojnë për idetë duke i ndarë ndërmjet tyre, do të shpjegojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre të të menduarit shkencor.

Fjalë kyçe

pi ha familje fermë ushqim jetesë i gjallë lëviz jo e gjallë të vegjël bimë ujë i vërtetë

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

përgjigjju kërko

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të përfshihen në objektivat e tematikës;
- të mendojnë rreth ngjashmerive midis bimëve/ njerëzve;
- të mësojnë se bimët mund të lëvizin.

Në temën e ardhshme nxënësit do të mësojnë më shumë rreth gjallesave dhe gjërave jo të gjalla.

Kërkoju nxënësve të shohin figurat dhe fjalët në faqet hyrëse. Kërkoju nxënësve të shohin fjalët kyçe dhe thuaju se ata duhet ta mësojnë kuptimin e këtyre fjalëve. Tregoju ndërmjet objektivave dhe udhëzimeve, se gjatë kësaj tematike ato do të mësojnë më shumë për qëniet e gjalla dhe rritjen e tyre.

Kërkoju nxënësve të shohin nga afër figurën e luledielli. Nxirr se një luledielli është një bimë. Nëse në klasë ka ndonjë bimë tjetër, thuaju nxënësve se edhe ato janë bimë. Pamjet tregojnë se si luledielli lëviz kokën e lulëzuar dhe ndjek lëvizjen e Diellit në qiell. Përdor pamjen për t'i mbajtur nxënësit duke menduar rreth lëvizjes së bimës. Ky është një nga faktorët përcaktues nëse diçka është e gjallë ose jo, që do të trajtohen me më shumë hollësi në mësimin më pas.

Referohu faktit interesant.

Çfarë vëren lidhur me luledielli?

Kërkoju nxënësve të ndjekin Diellin në qiell. Pastaj pyet nxënësit nëse vërejnë se Dielli duket sikur gjatë ditës lëviz nga njëra anë e qiellit në anën tjetër.

Kërkoju nxënësve të shohin në tekst nga afër vendndodhjen e Diellit mbi luledielli. Pastaj kërkoju të tregojnë me gishtin e tyre pikën ku është Dielli në fletë dhe të dallojnë lëvizjen e dukshme të Diellit.

Bëj pyetjet:

- Çfarë mendon se "po bën" Dielli ?
- A mund ta përshkruash çfarë shikon?

Përgjigje e mundshme: *Duket sikur po lëviz nga njëra anë e figurës në anën tjetër të saj.*

Shpjegoju se figura përfaqëson lëvizjen në dukje të Diellit rreth qiellit përgjatë ditës, megjithëse është Toka që rrotullohet sipas boshtit të saj.

Nga është drejtuar lulja?

Kërkoju nxënësve të shohin përsëri tek lulja.

Pyeti ato:

- Çfarë ndodh me lulen, ndërsa Dielli lëviz?

Përgjigje e mundshme: *Lulja lëviz duke i treguar fytyrën Diellit.*

Nxiti nxënësit të parashikojnë, se çfarë ndodh me luledielli kur Dielli perëndon.

Pyeti nxënësit:

- Çfarë mendoni se ndodh me luledielli kur Dielli perëndon? Sugjero alternativa: *Ato flenë; petëlat mbyllen; ata qëndrojnë ashtu, duke pritur Diellin; ata kthehen në mes; ata kthehen në pikën fillestare duke pritur Diellin.*

Shpjegoju çfarë do të thotë fjala gjej dhe/ose parashikoj. Përcakto këto fjalë, duke menduar rreth asaj që mund të ndodhë gjatë një vëzhgimi.

Shpjegoju se natën luledielli kthehet në pozicionin normal dhe pastaj vazhdon e ndjek Diellin kur lind. Shpjegoju se ne e dimë se bimët janë të gjalla, ndaj është e mundur të lëvizin dhe se gjithashtu në shumë bimë lëvizja nuk është shumë e dukshme. Luledielli është një shembull i mirë se si bimët lëvizin.

- Kërkoju nxënësve t'iu tregojnë ndonjë gjë që kanë mësuar në këtë temë mësimore.
- Kujtoju nxënësve çështjet kyçe që kanë mësuar në këtë temë për qëniet e gjalla dhe rritjen.
- Tregoi nxënësve, se në temën e ardhshme ato do të mësojnë më shumë rreth së gjallës (gjallesave) dhe jo të gjallës.

Formim gjuhësor

Një pikë e vlefshme fillestare në temën hyrëse janë fjalët kyçe. Krijo në klasë një "Tabelë fjalësh", në mënyrë që nxënësit t'i shohin fjalët dhe të familjarizohen me to. Kur është e mundur, përdor edhe figura për t'i konkretizuar fjalët. Përfshi pjesëmarrjen e nxënësve në krijimin dhe ruajtjen e rubrikës "Tabelë fjalësh".

Në librin e nxënësit ka gjithashtu një fjalor, ku nxënësit mund të shtojnë rregullisht përkufizime, ndërkohë që ecin përpara në tematikë. Zhvillimi i fjalorit fillon që nga tema e parë. Përdorimi i rregullt i fjalorit do të rritë sigurinë e nxënësve në njohjen e fjalëve dhe do t'i familjarizojë ata me kuptimin e vetë termave. Për të përforcuar familjarizimin me fjalët e reja, thuaju nxënësve t'i dëgjojnë, t'i flasin dhe t'i shkruajnë ato.

Kur trajton koncepte shkencore, të tilla si shpërndarje etj., ilustroi ato me lojra. Për shembull kërkoju nxënësve të "shpërndajnë" disa ëmbëlsira ose sende të tjera, në mënyrë që ato të kenë të njëjtën sasi. Përforcoje këtë në mësimin pasardhës duke përsëritur ushtrime.

Veprimtari plotësuese

1 Kërkoju nxënësve të shohin fjalët kyçe dhe t'i idenifikojnë fjalët që janë përdorur në këtë temë: "bimë", "e gjallë", "jo e gjallë".

2 Kërkoju nxënësve të shkruajnë në fjalor përkufizimet e këtyre fjalëve.

E gjallë apo jo e gjallë

Mëso se kafshët dhe bimët janë qenie të gjalla.

Zbulo se ka gjëra që nuk kanë qënë asnjëherë qënie të gjalla.



Njohuri përgatitore

Kjo temë bën fjalë rreth asaj se si nxënësit do të mësojnë rreth së gjallës dhe gjërave që asnjëherë nuk kanë qenë të gjalla. Nisur nga dijet e marra në temën e mëparshme, nxënësit njohin që ka veçori të përbashkta për të gjitha gjallesat, si aftësia për t'u rritur, lëvizur dhe ngrënë.

Materiale burimore

Bimë e tharë, bimë e gjallë, makinë - lodër, komplet me pamje të gjallesave dhe jogjallesave.

Fjalë kyçe

ha	rrit	i/e gjallë
lëviz	jo e gjallë	bimë

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

përgjigjiu	kërko

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të renditin njohuritë e temës së mëparshme;
- të identifikojnë se bimët dhe kafshët janë gjallesa;
- të njohin ndryshimin midis gjallesave dhe gjërave jo të gjalla;
- të identifikojnë disa veçori që janë të përbashkta për të gjitha gjallesat, si p.sh., aftësia për të lëvizur, për t'u ushqyer dhe t'u rritur.

Në temën e ardhshme mësimore nxënësit do të mësojnë me shumë rreth mënyrave se si kafshët dhe bimët e ndryshme popullojnë mjedisin.

Nga e dimë nëse diçka është e gjallë apo asnjëherë nuk ka qënë e gjallë?

Diskuto këtë pyetje me nxënësit. Bëj pyetje dhe përdor shembuj për të nxjerrë që gjallesat mund të lëvizin, të ushqehen dhe të rriten. Shmang përfshirjen e riprodhimit, meqenëse nxënësit do ta mësojnë më pas në këtë tematikë.

Përgjigje e mundshme: *E gjalla mund të lëvizë, të ushqehet dhe të rritet; jo e gjalla nuk mund të bëjë asnjërën prej këtyre.*

Kërkoju nxënësve të shohin me kujdes fotot në libër. Fillo me diskutimin rreth ndryshimit midis së gjallës nga jo së gjallës. Bëj pyetje rreth figurës së parë:

- A mendon se kali është i gjallë apo diçka jo e gjallë? Pse mendon se është i gjallë?

Përgjigje e mundshme: *Mund të lëvizë, të ushqehet, të rritet dhe të prodhojë të vegjël (bebe).*

Shpjegoju se, nëqoftëse diçka mund të lëvizë, të hajë dhe të rritet, atëhere është e gjallë, është një gjallesë. Kujtoju nxënësve se si luldielli lëviz. Pastaj bëj pyetje rreth figurës së dytë:

- A mendon se është e gjallë apo jo e gjallë? *E gjallë.*

Nxënësit mund të thonë se është diçka jo e gjallë. Nëse kjo ndodh, përforco që, nëse diçka mund të lëvizë dhe rritet, është e gjallë (gjallesë).

- Pse mendon kështu?

Përgjigje e mundshme: *Mund të rritet; mund të lëvizë.*

Pastaj kërkoju nxënësve të shohin figurën e gurit (shkëmbit). Bëj pyetjen:

- A është guri i gjallë apo asnjëherë nuk ka qënë i gjallë? Pse?

Përgjigje e mundshme: *Ai nuk mund të lëvizë, nuk mund të hajë; nuk mund të rritet.*

Pyet nxënësit, nëse makina lodër në figurën e katërt është e gjallë apo jo e gjallë. Nxirr përgjigjen se "nuk mund të lëvizë". Shpjegoju nxënësve se një makinë mund të lëvizë, por nevojitet një person për ta drejtuar atë. Nxirr se një makinë - lodër nuk mund të hajë apo të rritet.

Vazhdo të shtrosh pyetje për dy figurat e mbetura (pema dhe peshku).

Qarko qeniet e gjalla.

Tregoju nxënësve modelin e përgjigjes, përpara se ata të fillojnë.

Përgjigje: *Gjallesa janë: kali, bima, peshku. Jogjallesa janë: shkëmbi, makina lodër.*

Shpërndaj në klasë paketën me foto e gjallesash dhe jogjallesave. Kërkoju nxënësve të punojnë në dyshe për të klasifikuar pamjet në kategori të sakta.

Lëviz në klasë për t'u siguruar se nxënësit janë të sigurtë në veprimtarinë e klasifikimit.

Kjo veprimtari përforcon se ka qënie të gjalla dhe disa gjëra që nuk janë të gjalla. Ndërsa ti lëviz në klasë, kërkoju nxënësve pse ato kanë vendosur disa figura në një kategori të veçantë.

Pse mendon, se kafshët dhe bimët janë të gjalla?

Tregoju nxënësve që ne kemi folur rreth kafshëve dhe bimëve si gjallesa. Pastaj kërkoju nxënësve të kujtojnë çfarë kanë të përbashkët kafshët dhe bimët, në mënyrë që të dalin tek ajo që ato janë të gjalla.

Përgjigje e mundshme: *Kafshët dhe bimët mund të hanë, të rriten dhe të lëvizin.*

Cilat fjalë janë të lidhura me qeniet e gjalla. Qarko.

Lista përfshin fjalë që janë të lidhura si me të gjallën (gjallesa), ashtu edhe me jo të gjallën (jogjallesa). Nxënësit qarkojnë fjalët e lidhura me gjallesat.

Shiko çdo fjalë. Pyet nxënësit nëse kjo apo ajo fjalë mund të aplikohet për gjallesa. Kërkoju nxënësve ta përsëritin fjalën. Kërkoju atyre të flasin.

Përgjigje*: E gjalla: ec, marr frymë, lëviz, tigër, rrit, ha. Jo e gjalla: ujë, qelq, gur, dru, plastikë, tryezë, karrige.*

Vlerësimi i njohurive

Plotëso me fjalën e saktë.

Kërkoju nxënësve të plotësojnë fjalitë duke përmbledhur çështjet kyçe të mësimit.

Shkruaj modelin e përgjigjes në dërrasën e zezë, që nxënësit të shikojnë si punohet. Shkruaj secilën fjalë të dhënë dhe thuaje me zë të lartë. Kërkoju nxënësve ta thonë fjalën kur ti e tregon atë. Drejto nxënësit tek përgjigjja e saktë duke shkruar fjalinë në dërrasën e zezë, ashtu siç e thua. P.sh.: Bimët dhe ....? janë gjallesa. Bëj të njëjtën gjë me çdo fjali. Kërkoju nxënësve të kopjojnë fjalët e dhëna në fletoren e shënimeve.

Përgjigje*: Bimët dhe kafshët janë gjallesa.*

Gjallesat mund të rriten, të lëvizin dhe të ushqehen.

Ndërtesat dhe gurët nuk kanë qënë asnjëherë të gjalla. Gjërat jo të gjalla nuk mund të rriten , të lëvizin dhe të ushqehen.

Përsëritje dhe reflektim

Mbylle mësimin duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë veprimtarinë në rubrikën përsëritje dhe reflektim "Çfarë kemi mësuar për qëniet e gjalla dhe rritjen së tyre" në faqen 16 të librit të nxënësit.

Formim gjuhësor

Përdor etiketat me figura të gjallesave dhe të jogjallesave. Vendos emrin për secilën dhe pastaj pyet nxënësit nëse është e gjallë apo jo e gjallë. Ktheje veprimtarinë në një lojë me skuadra.

Veprimtari plotësuese

1 Kërkoju nxënësve të krijojnë një poster që tregon një klasifikim: të gjalla dhe jo të gjalla.

Mendo rreth ... Tregoju nxënësve një bimë të tharë në një vazo dhe pyet nëse është e gjallë apo jo e gjallë. Nxirr se, megjithëse bima është jo e gjallë, ajo ka jetuar dikur. Kjo veprimtari ka për qëllim të rritë aftësitë e të menduarit dhe të arsyetuarit të nxënësve.

Ku jetojnë bimët dhe kafshët?

Zbulo të dhëna për kafshë dhe bimë të ndryshme si dhe vendin ku jetojnë.


Ku jetojnë bimët dhe kafshët?

Zbulo të dhëna për kafshë dhe bimë të ndryshme si dhe vendin ku jetojnë.

Ideja kryesore

Kafshët dhe bimët pëlqejnë të jetojnë në vende të ndryshme.

Pse ti jeton në një ndërtesë?

Shiko figurat e kafshëve dhe të bimëve që jetojnë në vende të ndryshme.

a. Pse palmat rriten në këtë vend?

b. Pse sorkadhja jeton në këtë vend?

c. Pse këtu nuk ka as bimë dhe as kafshë?

10

Ku jetojnë ato? Lidh kafshën dhe bimën me vendin e banimit.

Plotëso vendet bosh.

të jetojnë fjetur uji bëjnë

Kafshët dhe bimët kanë nevojë për një vend ku të jetojnë.

Kafshët kanë nevojë për ushqim, për ujë dhe një vend për të f_____.

Bimët kanë nevojë për u____ për t'u rritur.

Disa kafshë, mes tyre edhe zogjtë, d_____ një vend për të fjetur.

Shko në faqe 16 për të kontrolluar se çfarë di.

Qenet e gjalla dhe rrija

11

Njohuri përgatitore

Kjo temë bën fjalë për mjedisin ku jetojnë kafshë dhe bimë të ndryshme dhe se çfarë kushtesh i nevojiten atyre të lulëzojnë dhe të zhvillohen në atë mjedis. Ti mund të planifikosh një vizitë në një mjedis lokal, p.sh., një "shëtitje mësimore" në oborrin e shkollës ose në një rezervat natyror.

Materiale burimore

Hyrje në një habitat lokal; një fletore pune për gjërat që vëzhgon; figura dhe foto për identifikimin e bimëve dhe kafshëve.

Fjalë kyçe

pije ushqim ujë

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të njohin mjedise të ndryshme ku jetojnë bimë dhe kafshë;
- të dinë se bimët dhe kafshët kanë nevojë që brenda vendbanimit (habitatit) të tyre të gjejnë çdo gjë të nevojshme për të mbijetuar;
- të kuptojnë se bimët dhe kafshët jetojnë në një vendbanim të caktuar.

Në temën e ardhshme, nxënësit do të mësojnë më shumë lidhur me familjen e shëndetshme.

Pse ti jeton në një ndërtesë?

Nxënësit shohin një foto të një shtëpie. Pyeti ata, pse jetojnë në një ndërtesë dhe jo jashtë saj. Arrij në përfundimin se shtëpitë ofrojnë strehim dhe mbrojtje nga kushtet e papërshtatshme të motit.

Bëj pyetje:

- A han sipas vakteve në shtëpinë tënde?
- A ke në shtëpi ujë të freskët për të pirë?
- A ke vend për të fjetur?

Përdor pyetjet për të nxjerrë se shtëpitë e nxënësve sigurojnë gjërat elementare bazë, për të cilat ata kanë nevojë për të mbijetuar:

ushqim, ujë dhe strehim.

Tregoju nxënësve se ata do të shohin vende të ndryshme, ku jetojnë bimë dhe kafshë. Përdor të gjitha figurat që gjenden në librin e nxënësit dhe bashkëbisedo pse bimët dhe kafshët jetojnë pikërisht ne atë vend; gjithashtu bëj krahasimin e vendbanimeve të ndryshme.

Paraqit fjalën "*krahasim*" duke u kërkuar nxënësve të përshkruajnë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet vendbanimeve (habitateve).

Pastaj thuaju nxënësve të punojnë në dyshe. Kërkoju nxënësve të shikojnë figurat në tekst dhe bëj pyetje.

a. Pse palmat rriten në këtë vend?

Shpjego se nevojat e bimëve janë të ndryshme prej atyre të kafshëve; p.sh., sqaro se toka duhet të jetë e përshtatshme për llojin e bimës dhe se bimët kanë nevojë për ujë.

b. Pse sorkadhja jeton në këtë vend?

Nxirr se sorkadhja plotëson të gjitha nevojat e saj në atë mjedis, si të ushqyerit, ujin dhe strehimin. Thekso se kafshët dhe bimët mund të jetojnë vetëm në një mjedis të përshtatshëm për nevojat e tyre.

c. Pse këtu nuk ka as bimë dhe as kafshë?

Tani thuaju nxënësve të shikojnë figurat (ose fotot) e një mjedisi jo mikëpritës dhe diskuto rreth kësaj çështje.

Përgjigje e mundshme:

a) Për shkak se ka ujë.

b) Për shkak se ka ushqim dhe ujë.

c) Për shkak se nuk ka ushqim apo ujë. Nuk ka askund strehë për kafshët.

Nëse ti vendos të dalësh me nxënësit për një shëtitje mësimore, duhet të sigurosh një "bllok" figurash të gjërave dhe objekteve që kërkon. Tiparet kryesore që duhen marrë parasysh janë:

1. Çfarë bimësh dhe kafshësh mund të identifikosh në ketë mjedis?
2. Si e marrin ushqimin dhe ujin bimët dhe kafshët?
3. Çfarë materialesh janë të përshtatshme për strehimin e kafshëve?

Nëse udhëton në një rezervat natyror lokal, duhet te jesh i sigurt që ke leje nga prindërit dhe që ke ndërmarrë një vlerësim për rrezikut në përputhje me politikat e shkollës.

Ku jetojnë ato? Lidh kafshën dhe bimën me vendin e banimit.

Kjo është një veprimtari përforcuese për t'u bindur se nxënësit janë të sigurt në identifikimin e vendbanimit të bimëve dhe kafshëve. Nxënësit bëjnë vijat lidhëse ndërmjet figurave të kafshëve dhe bimëve me pamjet e vendeve ku jetojnë.

Bëj pyetje në lidhje me çdo figurë:

- Cili është vendbanimi i shpendëve / kaktuseve / dhelprave / peshqëve / merimangave?

Përgjigje:

shpend - fole

kaktus - shkretëtirë

dhelpër - strofull

peshk - liqen

merimangë - pëlhurë merimange

Vlerësimi i njohurive

Plotëso vendet bosh.

Kërkoju nxënësve të plotësojnë vendet boshe duke përdorur fjalët e dhëna.

Shkruaj në dërrasën e zezë çdo fjalë të dhënë dhe thuaje me zë të lartë. Thekso çdo fjalë siç duhet dhe kërkoju nxënësve që ta përsërisin me zë të lartë. Udhëzoi nxënësit në përgjigjen e saktë duke shkruar çdo fjali në dërrasën e zezë, ndërkohë që ti e thua atë. Për shembull: Kafshët dhe bimët duhet të kenë një vend për të jetuar dhe ...?

***Përgjigje**: Kafshët dhe bimët kanë nevojë për një vend ku të jetojnë.*

Kafshët kanë nevojë për ushqim, për ujë dhe një vend për të fjetur.

Bimët kanë nevojë për ujë për t'u rritur.

Disa kafshë, mes tyre edhe zogj bëjnë një vend për të fjetur.

Përsëritje dhe reflektim

Mbylle temën duke kërkuar që nxënësit të përfundojnë veprimtarinë e dhënë në rubrikën përsëritje dhe reflektim "Çfarë kemi mësuar..." në faqen 16 të librit e nxënësit.

Formim gjuhësor

Kontrollo, nëse nxënësit kanë kuptuar domethënien e fjalëve kyçe dhe idetë e paraqitura në mësim.

Krijo dy lloje kartash: një grup kartash me pamje, një grup të dytë me përkufizime. Kërkoju nxënësve të harmonizojnë pamjet me përkufizimet. Kërkoju nxënësve të shkruajnë në fjalorin e tyre "me gjuhën" e tyre një përkufizim të fjalëve kyçe. Përforco fjalët që nxënësit e kanë të vështirë t'i gjejnë, duke i shtuar ato tek "Tabela e fjalëve" në klasë.

Veprimtari plotësuese

1. Kërkoju nxënësve të përgatitin një fletëpalosje informuese për vendin që ata vizituan gjatë shëtitjes së tyre mësimore.
2. Kërkoju nxënësve të skicojnë një figurë të kafshës që u pëlqen, nga habitati i tij / i saj i zgjedhur. Kujtoju atyre të përfshijnë në figurë furnizimet me ujë dhe ushqime që janë të përshtatshme për kafshën.

Familjet

Të dinë se njerëzit dhe kafshët japin pasardhës, të cilët rriten dhe bëhen të rritur.



Njohuri përgatitore

Ky mësim përqëndrohet në ciklin e jetës së njerëzve që nga fëmijëria e deri në pleqëri, si dhe në aftësinë riprodhuese për të sjellë në jetë pasardhës. Hollësitë e riprodhimit nuk zbulohen, por tregohet që njerëzit kanë fëmijë dhe kjo shpjegon se si lloji njeri vazhdon. Ky mësim ka qëllim të theksojë se njerëzit kanë faza jetësore dhe se procesi sillet cikël: ne rritemi në njerëz të rritur, bëhemi me bebe (fëmijë), të cilët rriten dhe bëhen njerëz të rritur. Nuk flitet për procesin e riprodhimit të njeriut.

Nxënësit marrin pjesë në një kërkim: a rriten të gjithë njerëzit me të njëjtën shpejtësi. Paraprakisht përgatit një tabelë, ku të shkruash gjatësinë e secilit nxënës.

Materiale burimore

Klasa sjell pamje që tregojnë fazat jetësore të njeriut: bebe, fëmijë i vogël, fëmijë pak më i rritur, adoleshent, i rritur, i pjekur, person i moshuar; një metër shirit.

Fjalë kyçe

familje

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të mësojnë se njerëzit lindin bebe dhe bëhen të rritur;
- të kuptojnë se disa njerëz kanë fëmijë dhe se fëmijët bëhen të rritur;
- të marrin pjesë në një kërkim për të përcaktuar nëse njerëzit rriten të gjithë me të njëjtën shpejtësi.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të mësojnë më shumë lidhur me lënien e pasardhësve nga kafshët, të cilët më pas bëhen kafshë të rritura.

Sa fëmijë ka në familjen tënde?

A je fëmija më i vogël? A je fëmija më i madh?

A je fëmija i mesëm? A je fëmijë i vetëm?

Ushtrimi i parë i bën fëmijët të mendojnë rreth familjeve. Shkruaj pyetjet në dërrasën e zezë. Bëj që nxënësit të të pyesin ty fillimisht rreth familjes tënde. Pastaj, kërkoju që të punojnë në grupe dyshe dhe t'u përgjigjen pyetjeve të shokut/shoqes.

Kërkoju nxënësve të shkruajnë përgjigjet e tyre në hapësirën e lënë në librin e nxënësit.

Për tu siguruar që nxënësit kuptojnë fjalët "më i vogli" dhe "më i madhi", shpjegoi që më i vogli është fëmija që ka lindur i fundit dhe më i madhi është fëmija që ka lindur i pari. Jep një shembull për të ilustruar kuptimin e fjalëve "më i vogli" dhe "më i madhi"; p.sh., në një familje me dy fëmijë, me një djalë 15 vjeç dhe një vajzë 5 vjeçe, fëmija më i vogël është vajza 5 vjeçe dhe më i madhi është djali 15 vjeç.

Përgjigje e mundshme: *Jemi 2 fëmijë.*
Unë jam fëmija me i vogël.

Rritja

Kërkoju nxënësve të lexojnë fjalitë rreth rritjes dhe të shikojnë pamjet e fazave të jetës njerëzore. Nga ky ushtrim nxirr se jeta e njeriut ka faza që fillojnë me lindjen e vazhdojnë deri në moshë të thyer (apo vjetër) dhe që në një çast të caktuar të jetës, njerëzit mund të lindin fëmijë, të cilët më vonë bëhen njerëz të rritur.

Sigurohu që nxënësit nuk e kanë konceptin e gabuar që fëmijët lindin në moshë të vjetër.

A mund të mendosh dy gjëra për të cilat bebet kanë nevojë?

Tregoju nxënësve se fëmijët kanë shumë nevojë për ndihmë që të rriten dhe të jenë të shëndetshëm. Pastaj bëj pyetjen e librit.

Përgjigje e mundshme: *Për t'i ushqyer, për t'i ndërruar pelenat, për të lëvizur rreth e rrotull.*

A rriten të gjithë njerëzit me të njëjtat përmasa? Po apo jo?

Fëmijët shikojnë pamjet e disa të rriturve me përmasa të ndryshme dhe shkruajnë përgjigjet e tyre.

Përgjigje*: Jo.*

Vëzhgim: A rriten të gjithë njerëzit me të njëjtën shpejtësi?

Qëllimi i këtij vëzhgimi është që fëmijët të zbulojnë se njerëzit rriten me shpejtësi të ndryshme. Nxënësit do të praktikojnë aftësitë shkencore vëzhguese, të matjes dhe të krahasimit.

Përforco kuptimin e fjalës "krahasoj". Shpjego se disa njerëz janë më të gjatë/më të shkurtër se disa të tjerë, por megjithatë ne të gjithë rritemi. Kërkoju dy nxënësve të qëndrojnë të kthyer me kurriz për të matur gjatësinë e tyre. Pyet klasën, kush është fëmija më i shkurtër dhe kush është më i gjati. Tregoju nxënësve se, kur krahasojmë në shkencë, ne kërkojmë të gjejmë çfarë është e ndryshme dhe çfarë është e ngjashme.

Ty do të duhet: një metër shirit ose vizore, një tabelë e parapërgatitur (rekomandohet në përmasa A3).

1. Kërkoju nxënësve të rreshtohen në njërën anë të klasës.
2. Mat gjatësinë e secilit nxënës; shkruaj gjatësinë e secilit në tabelën që ke përgatitur përpara.
3. Tregoju nxënësve gjatësinë e nxënësit më të shkurtër dhe më të gjatë në klasë.
4. Tregoju nxënësve se si llogaritet lartësia mesatare.

a) Sa i/e gjatë je?

b) Sa i/e gjatë është nxënësi/ja më i/e gjatë?

c) Sa i/e gjatë është nxënësi/ja më i/e shkurtër?

d) Sa të gjatë janë shumica e nxënësve në klasë?

Kërkoju nxënësve të shkruajnë përgjigjet e këtyre pyetjeve në librin e nxënësit. Ndihmoi për të mbledhur së bashku të gjitha përgjigjet të nxënësve. Llogarit gjatësinë mesatare.

Shpjegoju se fjala "mesatare" në këtë kontekst do të thotë gjatësia e shumicës së nxënësve në klasë.

Përgjigje*: Përgjigjet do të ndryshojnë në varësi të gjatësisë së nxënësve në klasën tënde.*

Çfarë mund të mësojmë, kur matim gjatësinë trupore të çdo nxënësi/e në klasë?

Kjo pyetje i nxit nxënësit të shkruajnë përfundime mbështetur nga të dhënat e grumbulluara. Nga përgjigjet e tyre nxënësit do të mund të kuptojnë se disa nxënës janë më të gjatë se disa të tjerë. Përdor të dhënat që ke mbledhur për të diskutuar pyetjen dhe pastaj përgjigjen shkruaje në dërrasën e zezë.

Përgjigje*: Ne mund të mësojmë se njerezit nuk rriten me të njëjtën shpejtësi.*

Veprimtari plotësuese

Kërkoju nxënësve të krijojnë një grafik ose tabelë me të dhënat që ato kanë mbledhur nga vëzhgimi.

Familjet

Të dinë që njerëzit dhe kafshët lindin pasardhës, të cilët bëhen të rritur.



Njohuri përgatitore

Ky mësim mbështetet në punën e bërë në mësimin e mëparshëm dhe analizon idenë se gjithashtu kafshët kanë familjet e tyre. Nxënësit mësojnë se kafshët lënë pasardhës që rriten dhe bëhen kafshë të rritura. Ata njihen me idenë se pasardhësit e kafshëve kanë nevojë për ndihmë nga prindërit e tyre, derisa të bëhen të aftë të ushqehen vetë. Mësimi mund të mësohet në klasë duke përdorur mjetet që jepen në rubrikën "Mjete dhe pajisje, materiale burimore". Gjithashtu rekomandohet një vizitë në një park natyror ose ferme, që të shihen nga afër kafshë të porsa lindura.

Sigurohu që të kesh lejen nga prindërit e fëmijëve dhe të kesh bërë një vlerësim të rrezikut në përputhje me rregullat e shkollës për çdo udhëtim jashtë shkolle.

Materiale burimore

Mundësia e hyrjes në një park natyror ose fermë me kafshë të porsalindura; vizore dhe lapsa.

Përmbajtja e mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të dinë se kafshët lënë pasardhës që bëhen të rritura;
- të dinë se pasardhësit mund të kenë nevojë për ndihmë derisa të bëhen të aftë të ushqehen vetë;
- të jenë të aftë të lidhin pasardhësit me kafshën prindrore.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të shqyrtojnë e reflektojnë për çfarë kanë mësuar në këtë tematikë.

Kërkoju nxënësve të shikojnë nga afër në libër foton e këlyshëve të tigrit duke u larë nga nëna e tyre.

Çfar po bën tigri i rritur?

Sa pasardhës janë në figurë? Qarko përgjigjen.

Kërkoju nxënësve të shkruajnë në librin e nxënësit përgjigjet e këtyre pyetjeve.

Përgjigje: *Duke larë tigrin e vogël. 1 (2) 3 4.*

Pastaj bëj disa pytje që të fillosh një diskutim në klasë.

- Pse mendoni që po e bën tigri i rritur këtë veprim? Sepse këlyshët e tigrit janë shumë të vegjël për ta bërë këtë vetë.
- Më thoni diçka tjetër që mamaja mund të bëjë për të vegjëlit? Të gjuaj për ushqim, t'i ushqejë ata.

Lidh kafshën me pasardhësin e saj.

Shpjegoju që ne i quajmë këlyshë pasardhësit e kafshëve. Ti mund ta quash thjesht këlysh. Diskuto emrat e kafshëve prind dhe këlyshëve të tyre, psh, "kalë" dhe "mëz".

Kërkoju nxënësve të shikojnë me kujdes figurat dhe të lidhin me një vijë kafshët e rritura me pasardhësit e tyre. Nxit nxënësit të përdorin vizore që të vizatojnë vija të drejta.

Përgjigje:
Ari i bardhë - Këlysh ariu polar
Deve – Këlysh deveje
Rosë – Zog rose
Kalë - Mëz

Çfarë ndryshimesh ka midis të rriturit dhe pasardhësit?

Ky ushtrim ka të bëjë me atë se si disa kafshë ndryshojnë gjatë rritjes së tyre. Në figurat e librit nxënësit gjejnë ndryshimet midis kafshës prind dhe pasardhësit. Kjo përforcon idenë se pasardhësit rriten dhe bëhen kafshë të mëdha, dhe ndërkohë që kjo ndodh disa karakteristika zhvillohen. Fol rreth këtyre ndryshimeve dhe shpjego pse këto karakteristika rriten dhe zhvillohen, p.sh. brirët e cjapit zhvillohen për të luftuar.

Përgjigje të mundshme:

Luani i rritur ka një krifë.

Cjapi i rritur ka brirë.

Shqiponjat e rritura kanë pendë dhe një sqep të gjatë e të mprehtë.

Flutura duket krejt ndryshe: ajo ka flatra me ngjyra të ndezura.

Vlerësimi i njohurive

Lexo me nxënësit ushtrimet në fund të mësimit që të sigurohesh se gjithë e kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë. Disa nxënës mund të jenë në gjendje t'i bëjnë vetë këto ushtrime, të tjerë mund të kenë nevojë për ndihmë.

Qarko fjalën e saktë.

Kërkoju nxënësve të qarkojnë fjalën që është e saktë në fjali.

***Përgjigje**: Njerëzit për të njejtën periudhë kohe nuk rriten me të njëjtat përmasa.*

Qarko figurën e saktë.

Kërkoju nxënësve të rrethojnë figurën e saktë në çdo fjali.

Përgjigje:

1. Njerëzit në fillim janë (figura e një fëmije). Ata rriten dhe bëhen të rritur.

2. Përgjigjia lidhet me konceptin e fjalës "krahasim", se sa mirë e kanë kuptuar nxënësit atë, si dhe me kërkimin në këtë mësim.

Monitoro përgjigjet e tyre dhe mbështet nxënësit, të cilët kanë nevojë për ndihmë.

Përsëritje dhe reflektim

Mbylle temën e mësimit duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë ushtrimin në faqen 17 në librin e nxënësit.

Formim gjuhësor

1 Nxënësit njihen me shumë fjalë dhe koncepte të ndryshme gjatë tematikës. Në këtë mësim të fundit sigurohu që nxënësit janë të sigurtë për fjalët dhe idetë e reja, duke kontrolluar fjalorin e shkruar prej tyre. Sigurohu që nxënësit japin përkufizimet e duhura për fjalët që ata kanë përdorur gjatë kësaj tematike. Përkufizimet e sugjeruara për të gjitha fjalët kyçe janë të përfshira në fjalorin në fund të librit të mësuesit.

2 Ti mund të përdorësh etiketa që nxënësit të krahasojnë dhe të klasifikojnë qëniet e gjalla dhe jogjallesat. Kërkoju nxënësve të emërtojnë objektet për të parë nëse janë të sigurtë në përdorimin e gjuhës.

Veprimtari plotësuese

Kërkoju nxënësve të bëjnë një poster të kafshës së tyre të pëlqyer me pasardhësin e tij. Kërkoju atyre të tregojnë ndonjë karakteristikë që është e ndryshme midis pasardhësit dhe të rriturit.

Çfarë kemi mësuar rreth qenieve të gjalla dhe rritjes



Njohuri përgatitore

Qëllimi i kësaj pjesë është të nxitë nxënësit të përsëritin njohuritë e fituara në çdo temë mësimore të këaj tematikë. Çdo temë ka disa pyetje përforcuese, të cilave nxënësi duhet t'u përgjigjen. Këto janë pyetje që do të vlerësojnë njohuritë e nxënësit si dhe do të tregojnë të kuptuarin e temave nga ana e tij/saj.

Pas çdo grupi pyetjesh përforcuese ka disa formulime për përsëritje dhe reflektim, të cilave nxënësit duhet t'u përgjigjet.

Është e nevojshmë të lexosh formulimet dhe t'i ndihmosh nxënësit të plotësojnë rrethin e vetëvlerësimit, për të parë kështu se sa të sigurt janë ata për njohuritë e fituara në temën mësimore.

Në klasën e parë nxënësit mund të ngjyrosin një fytyrë të qeshur apo të trishtuar për të treguar nivelin e tyre të sigurisë ose mund të vënë një shenjë vlerësimi, si p.sh. shenjën V.

Është e rëndësishme që nxënësit të tregojnë pjesët, në të cilat ata nuk ndjehen të sigurt. Ky informacion është shumë i rëndësishëm për mësuesin dhe mundëson që të ofrosh ndihmën e nevojshme në vlerësimin përmbledhës (rubrika Vlerësimi i përmbledhës) në fund të tematikës.

Përsëritje dhe reflektim

E gjallë apo jo e gjallë?

Cila nga këto tregon një qenie të gjallë dhe cila një gjë jo të gjallë?

Shkruaj fjalët në kutinë e duhur.

Nëse është e nevojshme ti mund të tregosh në dërrasën e zezë se si duhet bërë ushtrimi. Vizato një tabelë dhe jepu nxënësve disa etiketa qëniesh të gjalla dhe sendesh për ta zgjidhur së bashku, p.sh., një lepur dhe një lepur lodër (trego figura të këtyre sendeve). Pastaj bëj pyetjet:

- A është lepuri qënie e gjallë apo send jo i gjallë? *I gjallë.*
- Si e dini që është e qënie e gjallë? *Ai mund të lëvizë, të hajë ose të rritet.*
- A është lepuri lodër një qënie e gjallë apo një send jo i gjallë? *Jo i gjallë.*
- Si e dini që nuk është qënie e gjallë? *Ai nuk mund të lëvizë, nuk mund të hajë dhe as të rritet.*

Pastaj, drejtoju nxënësve të njëjtat pyetje lidhur me figurat në librin e nxënësit dhe kërkoju të shkruajnë përgjigjet në tabelë.

Ti mund ta vazhdosh ushtrimin duke i dhënë nxënësve më shumë gjëra për t'i kategorizuar, si p.sh., një trung dhe një tufë me lule. Nxirr nga nxënësit që këto gjëra dikur kanë qënë të gjalla.

Përgjigje:

E gjallë	**Jo e gjallë**
Dele	gur

Ku jetojnë bimët dhe kafshët?

Ku jetojnë ato?

Lidh me një vijë secilën bimë dhe kafshë me vendin ku ajo jeton.

Diskuto vendbanimet e treguara në figura.
Për shembull, pyet:

- Cila bimë ose kafshë jeton në shkretëtirë? Kaktusi.
- Cilat bimë ose kafshë të tjera jetojnë në shkretëtirë?

Përgjigje të mundshme: *Hardhuca, gjarpri, akrepi etj.*

Ti mund të vazhdosh ushtrimin duke u treguar nxënësve figura bimësh dhe kafshësh të tjera që jetojnë në vendin tuaj, t'u kërkosh nxënësve vendbanimin që u pëlqen të jetojnë secila prej bimëve dhe kafshëve. Pastaj pyet, pse çdo bimë ose kafshë pëlqen të jetojë pikërisht në këtë vendbanim.

Përgjigje:
Shkretëtirë – Kaktus
Pyll – Shimpaze
Arktik – Ari Polar
Det – Yll Deti

Familjet

Rendit saktë katër fazat e jetës së njeriut. Lidh me një vijë secilin numër me figurën përkatëse.

Drejtoju nxënësve pyetjet e mëposhtme, përpara se ata të zgjidhin ushtrimin:

- A ka ndonjëri/a bebe në familje?
- A ka fëmijë të tjerë në familjen tënde?
- Kush janë njerëzit e rritur në familjen tënde?

Përgjigje të mundshme: *Nëna, babai, halla, daja etj.*

- A keni ndonjë gjysh/gjyshe në familjen tuaj?

Pastaj, kërkoju nxënësve të bëjnë ushtrimin duke renditur fazat e jetës sipas rendit të duhur, duke filluar me "beben".

Përgjigje*: bebe, fëmijë, i rritur, i moshuar.*

Përmblidh përmbajtjen duke u rikthyer tek tematika "Qeniet e gjalla dhe rritja". Bëj pyetje për të nxjerrë nga nxënësit që të gjitha bimët dhe kafshët mund të lëvizin, të marrin frymë, të rriten dhe të japin pasardhës.

Vlerësimi përmbledhës

Formulimet për përsëritje dhe reflektim në librin e nxënësit janë një pikënisje e përkryer kur diskutohet për përparimin individual të çdo nxënësi. Ky informacion mund të përdoret gjithashtu për të krijuar një raport për çdo nxënës në fund të vitit shkollor.

Ai gjithashtu mund të jetë i dobishëm për të mbajtur një regjistër (vlerësimi) për të gjithë klasën për nivelin e përgjithshëm të sigurisë, duke identifikuar çfarë mund të kenë nevojë të rishikohet më vonë (shih një shembull në tabelën e mëposhtme).

Formulimi për përsëritje dhe reflektim	Shumë i/e sigurt	Jo aq i/e sigurt	Jo i/e sigurt

Kjo analizë (apo ky feedback) mund të përdoret më pas për të formuar një program përmirësimi (program rehabilitimi), i cili do të shërbejë për të ndihmuar nxënësit që të përmirësohen në të ardhmen.

Thjesht mbaj dhe ruaj regjistrimin e të dhënave dhe analizën e vetëvlerësimeve të nxënësve.

Kërkohet një përshtypje e përgjithshme e vetëvlerësimit të klasës, jo një regjistrim i vlerësimit individual të nxënësve (të dhëna individuale).
Kjo është gjithçka që të duhet. P.sh.: pesëdhjetë përqind e klasës nuk ishin të sigurt në lidhje me ...

2 Bimët

Në këtë tematikë nxënësit:

- emërtojnë pjesët kryesore të një bime, duke vëzhguar një bimë të gjallë dhe modele bimësh;
- zbulojnë se si farat rriten në bimë që lulëzojnë;
- dinë se për t'u rritur bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë.

Njohuri përgatitore

Kjo tematikë i përfshin nxënësit në idenë se bimët janë gjallesa. Nxënësit do të kultivojnë fidanë luledielli etj. (fidanët zgjidhen sipas mundësisë dhe veçorive të zonës), si dhe do të vëzhgojnë dhe do të bëjmë krahasimin midis bimëve të vyshkëta dhe bimëve të shëndetshme.

Këto vëzhgime bëhen në mësime të veçanta, por ti mund t'i fillosh ato në çdo kohë të përshtatshme.

Ti duhet të planifikosh që mësimet e kësaj tematike t'i organizosh në mënyrën më të mirë dhe më të përshtatshme sipas afateve.

Nxënësit mësojnë se bimët zhvillohen dhe që gjatë zhvillimit ata ndryshojnë. Nxënësit bëhen të vetëdijshëm për ngjashmëritë dhe dallimet midis bimëve. Brenda tematikës ekziston mundësia që nxënësit të bashkërenditin njohuritë që marrin lidhur me rritjen e bimës me të kuptuarit e tyre në mënyrë shkencore. Është përfshirë dhe u demonstrohet kujdesi për bimët në zhvillim. Nxënësve u jepet mundësia të fillojnë të kultivojnë lulediellin (ti mund të marrësh dhe një bimë tjetër që kultivohet në zonë dhe që të duket më e përshtatshme), dhe më vonë ta marrin në shtëpitë e tyre për ta rritur plotësisht.

Në mënyrë që kjo temë të mësohet sa më me efikasitet sugjerohet që të kontrollosh listën e mjeteve, pajisjeve dhe të materialeve burimore për çdo mësim, në mënyrë që të planifikosh paraprakisht sa më shumë vëzhgime që kërkojnë përgatitje.

Kjo tematikë është e lidhur me të ushqyerit e shëndetshëm dhe siguron bazën për të mësuarit në vitet e mëvonshme të shkollimit.

Aftësitë e hulumtimit shkencor

Nxënësve u jepet mundësia për t'iu përgjigjur pyetjeve nga të dhënat e grumbulluara me anë të vëzhgimit. Ata do të kontribuojnë në diskutime dhe do të bëjnë supozime (parashikime) për dukuritë shkencore. Nxënësit do të mësojnë se si duhen sugjeruar idetë, si duhet të ndjekin udhëzimet dhe të regjistrojnë të dhënat. Përveç kësaj, nxënësit do të krahasojnë të dhënat dhe do të shohim nëse parashikimet përputhen me rezultatet e tyre. Nxënësit do të modelojnë dhe do të komunikojnë për idetë e tyre, duke i ndarë ndërmjet tyre, do të shpjegojnë dhe do të zhvillojnë aftësitë e tyre të të menduarit shkencor.

Fjalë kyçe

lule	gjethe	dritë
rrënjë	farë	kërcell

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

provë e drejtë (test i drejtë)

Materiale burimore

Përzgjedhje e frutave dhe perimeve të freskëta; figura dhe foto frutash dhe perimesh.

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të përfshihen në objektivat e tematikës;
- të identifikojnë dhe emërtojnë emrat e frutave dhe perimeve të zakonshme.

Në temën e ardhshëm nxënësit do të mësojnë më shumë për emrat e pjesëve të një bime.

Faqet fillestare janë të programuara të entuziasmojnë dhe në të njëjtën kohë të angazhojnë nxënësit me përmbajtjen e tematikës, ashtu si dhe për të nxitur të menduarit në lidhje me zhvillimin e bimëve. Këto faqe mund të përdoret si një veprimtari fillestare e zgjeruar.

Thuaju nxënësve të shikojnë fotot dhe fjalët në fillim të faqes. Kërkoju të shikojnë fjalët kyçe dhe thuaju atyre se kuptimin e këtyre fjalëve do ta mësojnë gjatë studimit të kësaj tematike. Bisedo lidhur me objektivat dhe gjithashtu sqaroi ata se gjatë kësaj tematike do të mësojnë në lidhje me kultivimin e bimëve. Tregoju nxënësve se shumë bimë kultivohen për të siguruar ushqime.

Thuaj emrin e një perimeje. Thuaj emrin e një frute.

Kërkoju nxënësve të shikojnë nga afër fotot në faqet e fillimit dhe pastaj kërkoju të përmendin një emër frute dhe një emër perimeje.

Shkruaj në dërrasën e zezë një listë frutash dhe perimesh që krijohet nga përgjigjet e nxënësve.

Përforco idenë se të gjitha frutat dhe perimet janë bimë.

Nëse nxënësit janë të panjohur me emrat e frutave dhe të perimeve të përditshme në gjuhën shqipe, atëherë përdor figurat në faqet e para ose shembuj frutash dhe perimesh të freskëta. Tregoju me gisht çdo frutë dhe perime dhe thuaju nxënësve të thonë me zë emrin e duhur. Ti mund të zgjedhësh të bësh edhe një vizatim të thjeshtë në dërrasën e zezë. Pastaj si një veprimtari përforcimi, kërkoju nxënësve të përmendin çdo frutë apo perime. Një tjetër alternativë përforcimi është që të përdorësh etiketa me figura të frutave dhe perimeve duke u kërkuar nxënësve që t'i emërtojnë ato.

Formim gjuhësor

Një pikë e vlefshme fillestare janë fjalët kyçe. Ti mund të diskutosh dhe të përcaktosh disa prej fjalëve që janë të panjohura për nxënësit. Ti gjithashtu mund të krijosh një "Tabelë fjalësh" për tematikën, në mënyrë që nxënësit t'i shohin fjalët sa më shpesh dhe kështu të bëhen të njohura me ta.

Libri i nxënësit ka një rubrikë për fjalorin, ku nxënësit shtojnë rregullisht përcaktimet e reja, ndërkohë që ato përparojnë në tematikë. Është e vlefshme të fillohet me zhvillimin e fjalorit qysh në mësimin e parë.

Për të rritur familjaritetin me fjalët e reja kërkoju nxënësve që të dëgjojnë, të shprehin, të lexojnë dhe pastaj të shkruajnë fjalët.

Veprimtari plotësuese

1 Kërkoju nxënësve të shikojnë fjalët kyçe dhe të identifikojnë fjalët që ata kanë përdorur në këtë mësim.

2 Kërkoju nxënësve të shkruajnë në fjalorin e tyre një përkufizim të disa prej këtyre fjalëve. Fjalë kyçe për këtë modul janë: "bime", "gjethe", "kërcell", "rrënje", "lule", "farë", "rritet", "dritë", "ujë".

Pjesët e një bime

Emërton pjesët kryesore të një bime, duke pasur përpara bimë të gjalla dhe materiale të tjera konkretizuese.



Njohuri përgatitore

Ky mësim ka të bëjë me emërtimin e pjesëve kryesore të një bime, që janë: kercelli, gjethet, lulja dhe rrënjët. Në hyrje mësimi u jep nxënësve mundësinë për të menduar për pjesët e bimëve që hanë, kur ato janë duke ngrënë një frut apo perime. Ky mësim, kur diskutohen bimët si ushqim, u jep mundësi për të mësuar rreth të ushqyerit të shëndetshëm.

Materiale burimore

Lapsa me ngjyrë - të verdhë, gjelbër dhe kafe; materiale krijuese për të bërë modele apo postera të bimëve; bimë të lulëzuara në një vazo (largo dheun, në mënyrë që të mund t'u tregosh nxënësve rrënjët e bimës).

Fjalë kyçe

lule gjethe rrenje kërcell

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të emërtojnë pjesët kryesore të bimës;
- të ngjyrosin një figurë që tregon pjesët kryesore të bimës;
- të rikujtojnë se edhe ne hamë shumë bimë;
- të njohin se cilat pjesë të bimëve përdorim kur hamë ushqime të caktuara;
- të kuptojnë se ka disa bimë që ne nuk duhet t'i hamë kurrë, pasi do të na sëmurin.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të mësojnë më shumë rreth rritjes së bimëve.

Ngjyros bimën.

Kërkoju nxënësve të shikojnë foton e një bime. Ti mund të vizatosh figurën në dërrasë të zezë.

Kërkoju nxënësve të mblidhen përpara klasës dhe pastaj tregoju një bimë të vërtetë të lulëzuar në një vazo.

Trego dhe emërto rrënjët, kërcellin, gjethet dhe lulen e bimës në vazo.

Kërkoi një nxënësi të tregojë rrënjët në figurë, një tjetri të tregojë një gjethe, një tjetri të tregojë lulen dhe një tjetri të tregojë rrënjët.

Udhëzoi nxënësit të ngjyrosin figurën e një bime duke përdorur ngjyrat e sugjeruara në librin e nxënësit.

Shpjego që fjala "gjethe" është shumësi i fjalës "gjeth".

Lidh me një vijë fjalët me figurat.

Shpjegoju nxënësve që ne mund të hamë pjesë të bimëve. Pastaj kërkoju të shikojnë figurat në libër.

Bëj pyetjet:

- Kur ne hamë sallatë, cilën pjesë të bimës mendoni se jemi duke ngrënë? *Gjethet.*
- Kur ne hamë karrota, cilën pjesë të bimës mendoni se jemi duke ngrënë? *Rrënjët.*
- Kur ne hamë selino, cilën pjesë të bimës mendoni se jemi duke ngrënë? *Kërcellin.*
- Ne përdorim shafran për shije në gatim. Cilën pjesë të bimës mendoni se hamë? *Pjesë të lules*.

Pastaj, kërkoju nxënësve të shikojnë përsëri librin dhe të lidhin me një vijë fjalët me figurat si dhe të plotësojnë fjalitë.

***Përgjigje**: Kur ne hamë sallatë, ne jemi duke ngrënë gjethet.*

Kur ne hamë karrota, ne jemi duke ngrënë rrënjët.

Kur ne hamë selino, ne jemi duke ngrënë kërcellin.

Kur ne hamë shafran, ne jemi dukë ngrënë pjesë të lules.

Trego lidhjen ndërmjet të ngrënit të shumë frutave dhe perimeve me të ushqyerit e shëndetshëm.

Shpjegoju pse frutat dhe perimet janë të mira për ne dhe që ne idealisht duhet të hamë 5 racione me fruta dhe perime në ditë. Fol se çfarë do të thotë dietë e shëndetshme.

Shpjegoju me terma të thjeshtë se frutat bëhen atëherë kur lulja ka përfunduar së lulëzuari.

Disa bimë mund të na sëmurin. Ato nuk janë të mira për t'u ngrënë.

Shpjegoju nxënësve që janë disa bimë që ne nuk duhet t'i hamë kurrë, sepse ato do të na bënin të sëmurë. Nëse ti dëshiron, mund të përmendësh disa bimë helmuese si një paralajmërim për të parandaluar nxënësit që të hanë bimë të panjohura.

Shpjegoju nxënësve që ata duhet të hanë bimët që njohin dhe/ose që dikush ia ka dhënë atyre për t'i ngrënë. Ato kurrë nuk duhet të hanë bimë ose lule që ato nuk njohin.

Vlerësimi i njohurive

E vërtetë apo e gabuar? Qarko përgjigjen.

Vlerësimi formues për këtë mësim është një veprimtari e thjeshtë, e vërtetë / e gabuar.

Për të ndihmuar në formimin gjuhësor ti mund të zgjedhësh që t'i lexosh thëniet. Thuaju nxënësve që mendojnë se thënia është e vertetë të ngrejnë dorën, pastaj thuaju të ngrenë dorën atyre që mendojnë se është e gabuar.

Kërkoju nxënësve të rrethojnë përgjigjen e saktë në librin e nxënësit.

Përgjigje:

1. Disa bimë janë të mira për t'u ngrënë. E vërtetë

2. Të gjitha bimët kanë rrënjë. E vertetë

3. Kur ne hamë karrota, ne jemi duke ngrënë lule. E gabuar

Përsëritje dhe reflektim

Mbylle temën e mësimit duke u kërkuar nxënësve të bëjnë përsëritjen dhe veprimtarinë reflektuese në faqen 30 të librit të nxënësit.

Formim gjuhësor

Sugjerimet për formimin gjuhësor janë të lidhura me hapat e mësimdhënies. Për të ndihmuar më tej në zhvillimin e gjuhës, ti mund të krijosh disa etiketa me emrat e pjesëve kryesore të një bime dhe me emrat e disa frutave dhe perimeve.

Është e rëndësishme që nxënësit të kujtojnë se shumësi i fjalës "gjeth" është "gjethe"; kjo mund të jetë pak e vështirë për disa nxënës që ta kuptojnë se shumësi nuk është bërë duke shtuar një "s".

Veprimtari plotësuese

1 Ti mund t'u kërkosh nxënësve të krijojnë modele apo postera të një bime për të treguar pjesët kryesore të një bime.

2 Ti mund t'u kërkosh nxënësve tu tregojnë çfarë perimesh dhe zarzavatesh hanë; pastaj, t'i pyesësh se cilën pjesë të bimës hanë.

Rritja e bimëve

Zbulon se si farat rriten dhe bëhen bimë të lulëzuara.



Njohuri përgatitore

Ky mësim ka të bëjë me rritjen e bimëve dhe kërkon disa planifikime paraprake. Sigurohu të kesh mjetet dhe pajisjet e nevojshme në dispozicion, në mënyrë që ky mësim të zhvillohet dhe të mësohet në mënyrë efektive. Ky mësim ofron një mundësi për nxënësit që ata të rritin vetë bimët e tyre. Nëse është e mundur, përdor fara luledielli shtatshkurtëra, meqenëse luledielli gjigand mund të bëhet i rëndë dhe kështu vështirësohet marrja në shtëpi e bimëve nga nxënësit. Mësimi nxit nxënësit për t'u kujdesur për bimët që janë në rritje dhe për të zhvilluar një ndjenjë përkujdesjeje për gjallesat. Nxënësit mësojnë se si farat janë të nevojshme për rritjen e bimëve, si dhe kanë mundësi të matin lartësitë e bimëve.

Materiale burimore

Fara luledielli, vazo bimësh, guralecë apo zhavorr që uji të kullojë, dhe me pleh, ujë, mistri, mundësi për larjen e duarve, materiale krijuese.

Disa filizë paraprakisht të siguruar për të zëvendësuar ndonjë që nuk arrin të rritet.

Fjalë kyçe

dritë farë

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të matin lartësinë e luledielllit në figurën e librit;
- të mbjellin fara luledielli;
- të ndjekin udhëzimet për të kryer vëzhgimet;
- të ndajnë dhe të përdorin së bashku me nxënësit e tjerë mjetet dhe pajisjet;
- të dinë se bimët rriten, kur ata mbjellin fara.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë më shumë për rritjen e bimëve.

Çfarë vëren në këto dy bimë?

Kërkoju nxënësve të shikojnë dy fotot e luledielllit në librin e nxënësit. Fillo një diskutim me synim për të bërë dallimet midis dy bimëve. Shpjegoju se bimët janë të të njëjtin lloj bime, bimë luledielli, por që njëra është më shtatlarte se tjetra.

Pyet nxënësit:

- Pse mendoni, se njëra bimë është më shtatlartë se tjetra?

> ***Përgjigje të mundshme:*** *Njëra është rritur më shumë se tjetra. Njëra është një bimë e rritur dhe tjetra është një bimë "bebe".*

Drejtoi nxënësit të shohin vizoren dhe të matin dy bimët. Bëju pyetje për matjet.

Sa është e lartë bima më e vogël?

> ***Përgjigje****: 25 centimetra.*

Sa është e lartë bima më e lartë?

> ***Përgjigje****: 4 metra.*

Kërkoju nxënësve të shikojnë foton e librit që tregon fara të luledielli; pastaj tregoju atyre fara të vërteta. Shpjegoju se bimët e luledielllit që ata shohin në librin e tyre janë rritur nga fara të ngjashme me ato që po u tregon.

Vëzhgim: Si të rritim një bimë luledielli?

Qëllimi i këtij vëzhgimi është që nxënësit të fitojnë njohuritë fillestare se bimët rriten nga farat. Ata gjithashtu mësojnë se, që farat të rriten në bimë të rritura ata duhet të kujdesen për farat.

Çfarë nevojitet: fara luledielli, vazo të vogla lulesh, guralecë të vegjël, pleh, ujë.

Fillo vëzhgimet duke i dhënë nxënësve mundësinë për të bërë një parashikim. Pyeti ata:

- Çfarë mendoni se do të ndodhë kur të mbjellim këto fara? *Ata do të rriten (në bimë).*

Demonstroju nxënësve se si duhen mbjellur farat e luledielit. Ndërkohë që demonstron, shpjegoju çdo hap.

1 Merr një vazo dhe vendos disa guralecë në fund të saj.

- Shpjegoju se guralecët në pjesën e fundme të vazos vendosen për të mos mbetur shumë ujë që e dëmton bimën. Shpjegoju se bimët kanë nevojë për një sasi të caktuar uji; jo shumë dhe jo shumë pak.

2 Mbushe vazon me dhé e pleh. Ujit përzierjen e dheut me pleh.

- Tregoju nxënësve se vazoja duhet lënë rreth 2.5 centimetra pa u mbushur me dhe e pleh.
- Tregoju atyre sasinë e ujit të mjaftueshëm për ujitjen e dheut me pleh.

3 Mbill dy fara luledielli.

- Siguroju që nxënësit ta futin farën në një thellësi rreth 2.5 centimetra (gjatësia e gishtit të madh të nxënësit).
- Udhëzo nxënësit të vendosin vazot e bimëve në një vend të përshtatshëm për rritjen e farave.
- Përpiqu të shmangësh rrezet e drejtpërdrejta të diellit.

Siguroju që nxënësit të shpëlajnë duart, pasi të kenë mbjellur farat.

4 Kontrolloja vazon çdo ditë.

- Kujtoju nxënësve që ata duhet t'i kontrollojnë vazot çdo ditë, për t'u siguruar që dheu me pleh është ende i njomë. Tregoju nxënësve se pas 3-8 ditësh ata duhet të shohin diçka që rritet.
- Është e këshillueshme të kesh disa filizë të parapërgatitur, në mënyrë që, nëse farat e ndonjë nxënësi dështojnë e nuk rriten, t'u ofrosh atyre një alternativë.

Sa ditë kaluan deri ditën që pe filizat?

Udhëzo nxënësit për një mënyrë sa më të thjeshtë për t'i kontrolluar filizat e tyre çdo ditë dhe për të shënuar atë çfarë shohin.

Për shembull, nxënësit mund të ngjitin në vazo një etiketë me emrin e tyre; në etiketë mund të ketë një hapësirë të mjaftueshme për të bërë një shënim çdo ditë që ata kontrollojnë bimën. Ata mund të fillojnë të mbajnë shënim sapo filizat shfaqen dhe të shkruajnë përgjigjen e pyetjes në librit e nxënësit.

Si duhet të kujdesesh për filizat?

Diskuto për pyetjen dhe përzgjidh përgjigjet. Vlerëso nxënësit dhe tregoju çfarë do të bëjnë më pas.

Sapo filizat të jenë shfaqur, kërkoju nxënësve t'i heqin nga dheu dhe t'i mbjellin filizat e vegjël. Shpjegoju atyre se do të rritin vetëm filizat që janë më të mëdhenj (të zhvilluar). Vazot me filizat e zhvilluar vendosi në një dhomë tjetër (dhoma e filizave) për tu rritur.

Formim gjuhësor

Sigurohu që nxënësit të kenë kuptuar idenë e më të madhes dhe më të voglës (më të gjatës dhe më të shkurtës); kërko të dalë një nxënës vullnetar dhe të qëndrojë përkundrejt teje, si dhe të shpjegojë se ti je më i/e madh/e dhe nxënësi/ja është më i/e vogël, dhe se arsyeja për këtë është se ti ke pasur më shumë kohë për t'u rritur. Kjo lidh drejtpërdrejt konceptin më i/e madh/e dhe më i/e vogël të dhënë në veprimtarinë fillestare.

Zhvillimi i mëtejshëm i formimit gjuhësor bëhet duke vendosur dhe treguar objekte së bashku me emërtimin e tyre; më pas nxënësit i përdorin ato, p.sh.: unë jam duke përdorur një mistri (trego mistrinë) për të përzierë plehun (trego përzierjen e dheut me pleh) në vazo bimësh (trego një vazo).

Veprimtari plotësuese

1 Kërkoju nxënësve të regjistrojnë parashikimet e tyre duke bërë një vizatim para dhe pas vëzhgimit.

2 Siguro disa skica të pamjes së luledielit që nxënësit do t'i ngjyrosin.

Rritja e bimëve

Zbulo se si farat rriten dhe bëhen bimë të lulëzuara.



Njohuri përgatitore

Kjo temë është një temë teorike si dhe aplikative; ajo kërkon pak ose nuk kërkon fare planifikim paraprak. Fokusi kryesor i temës është që nxënësit të zbulojnë se si farat rriten në bimë të lulëzuara. Nxënësit mësojnë se ata nuk mund ta shohim se si kjo ndodh, ndaj duhet të mbështeten në vëzhgim dhe në matje për të siguruar informacion në lidhje me rritjen e bimëve. Zhvillimi i aftësive në kuadrin e kësaj teme është parashikuar të arrihet duke bërë matje të sakta, vëzhgim dhe diskutim (flas/tregoj). Gjithashtu nxënësit kanë mundësi të krahasojnë lartësitë e bimëve duke ndjekur rritjen dhe ndryshimin gjatë ciklit të jetës; kjo është arritur duke përdorur ilustrime në librin e nxënësit.

Materiale burimore

Vizore ose metër shirit për të matur lartësinë; lapsa me ngjyrë (të kuqe dhe të gjelbër për të ngjyrosur bimët e domates; duhet të keni në dispozicion edhe ngjyra të tjera për të zgjeruar veprimtarinë).

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të dinë se bimët rriten;
- të kuptojnë pse ne nuk mund ta shohim rritjen e bimëve;
- të matin dhe të krahasojnë lartësitë e bimëve në faza të ndryshme të jetës;
- të matin lartësinë në bimë të ndryshme;
- të shkëmbejnë informacion me nxënës të tjerë.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë më shumë rreth asaj se si bimët për t'u rritur kanë nevojë për dritë.

Çfarë mendon se do të ndodhë, nëse i mbjellin këto fara?

Kërkoju nxënësve të shikojnë fotot në librin e nxënësit. Fillo një diskutim në lidhje me atë se çfarë mendojnë nxënësit se do të ndodhë, kur farat mbillen. Pyet nxënësit nëse ata të gjithë ose ndonjë prej tyre e di, sepse ata mund të kenë mbjellur fara më parë; kërkoju atyre të tregojnë për atë që ka ndodhur. Udhëzoi ata të shkruajnë përgjigjet e tyre në librin e nxënësit.

Përgjigje të mundshme: *Ata do të rritet.*

Thuaj emrin e dy farave që janë të mira për t'u ngrënë.

Pyet nxënësit, nëse njohin ndonjë nga farat që tregohen në foto. Pastaj shtro pyetjen:

- A dini emrin e ndonjërës prej farave në figurë, që është e mirë për t'u ngrënë?

Shkruaj emrat e farave në dërrasën e zezë dhe kërkoju nxënësve të vizatojnë figurat e farave dhe të kopjojnë emrat e tyre pranë vizatimit; më pas shto emrat në klasë tek "Tabela e fjalëve".

Përgjigjet e mundshme: *arrë kokosi, kikirikë, bizele etj.*

Shpjegoju nxënësve se ne nuk mund t'i shohim bimët duke u rritur, sepse ata rriten ngadalë; kështu që e vetmja mënyrë për të mësuar dhe ditur se ato të rriten është duke i matur ato.

Kërkoju nxënësve të kontrollojnë luledielin e tyre, për të parë nëse ka ndonjë shenjë të rritjes (shih mësimin e mëparshëm).

Farat e luledielit të nxënësve duhet të kenë mbirë tashmë dhe nxënësit do të jenë në gjendje të shohin shenjat e para të filizave në rritje. Nxiti nxënësit të flasin për gjetjet e tyre.

Me vizoren në figurë mat lartësitë e bimëve.

Kjo është një veprimtari matëse duke përdorur figurat në librin e nxënësit. Kërkoju nxënësve të shikojnë figurat e bimëve të domates. Trego figurën e vizores pranë bimëve dhe pastaj shtro pyetjen.

Sa është e lartë bima më e vogël?

Përgjigje: *10 centimetra.*

Sa e lartë është bima më e lartë?

Përgjigje*: 50 centimetra.*

Sa e lartë është bimë në mes?

Përgjigje*: 25 centimetra.*

Ti duhet të shpjegosh se figurat nuk tregojnë matjet e vërteta, sepse libri nuk është aq i madh sa të tregojë 50 centimetra. Shpjegoju se madhësitë në libër janë zvogëluar për t'iu përshtatur faqes së librit.

Ngjyrosi bimët.

Kërkoju nxënësve të ngjyrosin figurat e bimëve në librin e nxënësve. Nxiti nxënësit të përdorin ngjyrën e kuqe për domatet dhe ngjyrën e gjelbër për gjethet dhe kërcellin; kështu sigurohet një paraqitje e saktë e bimës së domates.

Formim gjuhësor

Sigurohu që nxënësit janë të sigurtë në përdorimin e gjuhës të përdorur në këtë temë. Për shembull, përdor etiketa për fjalë të panjohura ose shto në klasë fjalë në "Tabelën e fjalëve"; kështu nxënësit shohin fjalët vazhdimisht dhe janë në gjendje t'i përdorin ato në bisedë.

Gjithashtu mund të krijosh dy paketa me etiketa: njëra paketë me fjalë dhe tjetra me figura. Kërkoju nxënësve të lidhin çdo fjalë me figurën përkatëse, p.sh., një figurë e një vizoreje në një etiketë dhe fjala "vizore" në një etiketë tjetër.

Veprimtari plotësuese

1. Kërkoju nxënësve të kontrollojnë çfarë kanë shkruar në fjalor dhe shto çdo përkufizim që ata nuk e kanë shkruar. Ti mund t'i udhëheqësh ata në përcaktimet e sakta duke përdorur etiketat që përputhen, ashtu siç janë përshkruar në rubrikën formim gjuhësor.
2. Nxënësit mund të krijojnë një poster për të treguar se si rriten bimët nga farat. Ata mund të përdorin shembullin e një bime domateje; ato mund të vizatojnë një farë dhe më pas bimë me lartësi të ndryshme, për të treguar rritjen e bimës.

Ose, mund të nxitësh nxënësit të zgjedhin një bimë tjetër, me të cilën ato janë më të njohur. P.sh., disa nxënës mund të pëlqejnë të vizatojnë një luledielli; ato fillojnë me një vizatim të farës, pastaj vizatimin e filizit, pastaj të një bime pjesërisht të rritur dhe në fund një vizatim të luledielllit në rritjen e saj të plotë dhe me një lule.

Çfarë u nevojitet bimëve për tu rritur?

Të dinë që bimëve u nevojitet dritë dhe ujë për t'u rritur.



Njohuri përgatitore

Kjo temë mësimore flet për kushtet e nevojshme për rritjen e bimëve; ajo fokusohet në rëndësinë që ka drita, që bimët të rriten. Mësimi tjetër tregon se si uji është i nevojshëm që bimët të rriten. Kontrollo listën e mjeteve, pajisjeve dhe materialeve burimore për t'u njohur me hollësi lidhur me nevojat në këto dy mësime.

Materiale burimore

Farë fasuleje, farë lakre, vazo të vogla (etiketo njërën vazo "dritë" dhe tjetrën "errësirë'); pambuk, ujë, materiale kreative për të dekoruar vazot, lapsa me ngjyrë.

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

test i drejtë parashikoj

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të kuptojnë se bimët kanë nevojë për dritë që të rriten;
- të mbjellin dhe të rritin farë fasuleje ose lakre, për të vertetuar që bimët kanë nevojë për dritë që të rriten;
- të kuptojnë idenë e një prove (testi) të drejtë.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë më shumë rreth asaj se si bimët kanë nevojë për ujë që të rriten.

Çfarë dallon?

Kërkoju nxënësve të shikojnë figurën në Librin e Nxënësit. Ajo tregon bimë që janë rritur në errësirë. Fillo një diskutim në lidhje me atë çfarë nxënësit mund të shohin. Bëj pyetjet:

- A mendoni se bimët janë të shëndetshme? Pse? *Jo, sepse gjethet e saj janë të verdha.*

Përgjigje e mundshme: *Gjethe të verdha.*

Vëzhgim: A kanë nevojë bimët për dritë që të rriten?

Qëllimi i këtij vëzhgimi, i organizuar si një eksperiment, është që nxënësit të gjejnë nëse bimët kanë nevojë për dritë që të rriten. Përdor fara fasuleje (ose lakre) sepse ato rriten shpejt dhe japin rezultate të mira.

Ti ke nevojë për: fara fasuleje (ose lakre), vazo të vogla që do t'i zbukurosh, ujë, mbajtëse vezësh

1 Zbukuro vazot tuaja.

- Shpjegoju nxënësve se ata do të vëzhgojnë, nëse bimët për tu rritur kanë nevojë për dritë. Pastaj, ndaj vazot e vezëve për secilin nxënës ose në dyshen e nxënësve dhe kërkoju atyre që t'i zbukurojnë; thuaju të shkruajnë emrat e tyre në to.
- Nëse ke organizuar klasën në dyshe, një vazo mund të përdoret për t'i rritur farat në errësirë dhe një levozhgë tjetër mund të përdoret për t'i rritur në dritë.
- Nëse punojnë individualisht, secili nxënës duhet të ketë nga dy vazo. Thuaju nxënësve që duhet të tregohen të kujdeshëm me vazot.

2 Vendos pambuk në fund të çdo lëvozhge.

- Tregoju nxënësve se si të vendosin pak pambuk brenda në vazo.

3 Shto pak ujë dhe vendos farat e fasules përsipër pambukut.

- Tregoju nxënësve duke shtuar pak ujë dhe pastaj se si vendosen farat e fasules përsipër pambukut. Përsërit këtë veprim edhe për vazon e dytë. Vëzhgo nxënësit se si ato përsëritin ato se çfarë bëre.

Si mund t'a bësh vëzhgimin tënd të drejtë?

Ndërsa je duke organizuar provën (eksperimentin), jep idenë e një prove të drejtë duke bërë pyetjen:

- Si mund të sigurohemi se kjo është një provë e drejtë?

Jep të të dhëna rreth farave të fasules, pambukut dhe ujit. Bëj përpjekje të tregosh se parametrat (faktorët) e provës duhet kontrolluar që të jenë të njëjtë: të këtë të njëjtën sasi uji, numër farash dhe sasi pambuku për secilën vazo. Ti mund t'u tregosh nxënësve dy grupe me fara fasulesh, njëri grup me më shumë fara se sa tjetri, dhe të pyesësh nëse kjo do të ishte një provë e drejtë. Pastaj pyet nxënësit:

- Pse mendoni se duhet të përdorni dy vazo për eksperimentin? Për të krahasuar se si rriten bimët.

Paraqitja e idesë pas pyetjes synon të nxjerrë përgjigjen që ne duhet të bëjmë kontrollin e provës që është i lidhur me kontrollin e parametrave (faktorëve). Udhëzo nxënësit drejt përgjigjes duke përforcuar se ata po eksperimentojnë nëse bimët kanë nevojë për dritë që të rriten.

Shpjegoju që provë e drejtë është ajo provë kur përdorim me shumë se një mostër për provë, p.sh. dy vazo. Vazhdo të shpjegosh se ne ndryshojmë vetëm një gjë – një parametër (faktor) apo kusht (dritë dhe errësirë) dhe të tjerët i kontrollojmë të jenë njësoj (secila vazo ka të njëjtat gjëra në të: pambuk, ujë dhe fara).

Përgjigje e mundshme: *Përdorim të njëjtat gjëra për secilën vazo.*

Sigurohu që kesh nga dy vazo për secilin nxënës ose secilën dyshe nxënësish dhe që njëra vazo të vendoset në një vend "me dritë" dhe tjetra të vendoset në një vend "pa dritë" (të errët).

Kujtoju nxënësve që ato janë duke provuar, nëse bimët kanë nevojë për dritë që të rriten. Pyeti ato:

- Çfarë mendoni se ne duhet të bëjmë me farat tani? Duhet të vendosim njërën vazo diku në errësirë. Duhet të vendosim vazon tjetër diku në dritë.

Vendos njërën vazo në një vend me dritë dhe vazon tjetër në një vend pa dritë (të errët).

Kontrollo rritjen e farave çdo ditë dhe shto ujë aq sa nevojitet në sasi të barabartë në çdo vazo. Ti do të shikosh rritjen për 3-5 ditë.

Ngjyros figurat, për të treguar çfarë mendon se do të ndodhë.

Thuaju nxënësve të shikojnë figurat në librin e nxënësit dhe kërkoju atyre të parashikojnë rezultatet e eksperimentit të tyre. Pyeti nxënësit çfarë mendojnë se do t'u ndodhë farave kur të rriten, duke i pyetur:

- Çfarë ngjyre mendoni se do të kenë gjethet në bimën e rritur në dritë? Të gjelbër.
- Çfarë ngjyre mendoni se do të kenë gjethet në bimën e rritur në errësirë? Të verdhë.

Nxënësit kanë në dispozicion një skicë bimësh, të cilën do ta ngjyrosin për të treguar parashikimet e tyre.

Formim gjuhësor

Përdor diskutimet për të folur në lidhje me atë që nxënësit kanë bërë gjatë mësimit dhe atë çfarë kanë mësuar. Nxiti nxënësit të përdorin disa nga fjalët, me te cilat ata u njohën më së shumti, për shëmbull: "provë e drejtë" dhe "krahaso".

Veprimtari plotësuese

1 Kërkoju nxënësve të vizatojnë një figurë para dhe një tjetër pas rezultateve të luledielli të tyre. Udhëzoi nxënësit të lënë vend në fletë, për të shtuar më vonë si rritet luledielli.

Mendo rreth…Kjo pyetje është hartuar për të tërhequr dhe sfiduar nxënësit. Prit përgjigje si:

Po, por ato nuk mund të kenë shije aq të mirë sa bimët e rritura në dritë./ Jo, sepse ato nuk do të kenë shije të mirë./ Nuk jam i/e sigurt.

Prano përgjigjet e nxënësve dhe shpjegoju se bimët e rritura në errësirë nuk do të bëjnë të sëmurë, por ato nuk mund të kenë shije aq të mirë sa bimët e rritura në dritë.

Çfarë u nevojitet bimëve për tu rritur?

Njihet se bimët për t'u rritur, kanë nevojë për dritë dhe ujë.



Njohuri përgatitore

Në këtë temë mësimore nxënësit zbulojnë nëse bimët kanë nevojë për ujë që të rriten. Kjo temë kërkon një planifikim paraprak. Ti duhet të sigurosh bimë që nuk janë ujitur më përpara dhe që janë duke u tharë. P.sh.: bimë mëllage që janë të përshtatshme, me qenë se ato reagojnë shpejt duke u kthyer ne gjendjen e mëparshme. Gjithashtu do t'ju duhen disa degë selinoje: disa duhet të jenë të freskëta dhe disa të vyshkura.

Materiale burimore

Bimë të vyshkura; lagëse plastike të vogla; tri enë me përzierje dhe me pleh – njëra shumë e lagësht, tjetra shumë e thatë, ndërsa ena e trete vetëm me pak lagështirë, me qëllim krahasimi; fidanë selinoje (ose të një perimeje tjetër) të freskëta për t'u ngrënë dhe të vyshkura për krahasim, të cilat nuk duhet të hahen; materiale krijuese; mjete për larjen e duarve.

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të njohin se bimët kanë nevojë për ujë që të rriten;
- të dinë se, nëse bimët nuk do të ujiten, ato do të vyshken dhe pastaj thahen;
- të krahasojnë bimët para dhe pas ujitjes;
- të plotësojnë të dhënat e mbledhura me ato të vëzhgimeve të tjera;
- të përforcojnë të kuptuarit e fjalëve kyçe të tematikës.

Në temën e ardhshme, nxënësit do të rishikojnë dhe do të arsyetojnë për ato që kanë mësuar në këtë tematikë.

Diskuto rreth asaj çfarë shikon në figurë.

Kërkoju nxënësve të shikojnë foton e bimës që është ujitur dhe të bimës tjetër që është e vyshkur.

Nis diskutimin lidhur me atë që nxënësit shohin. Prit përgjigje përshkruese. Nxiti nxënësit të bëjnë krahasimin e dy bimëve.

Paraqit fjalën vyshkje për të përshkruar se çfarë ndodh me një bimë, që nuk është ujitur (vaditur). Shpjegoju se gjethet dhe kërcelli bëhen shumë të butë dhe mund të fillojnë të thahen, nëse ata nuk do të ujiten.

Përgjigje e mundshme: *Një bimë e tharë dhe një bimë e shëndetshme.*

Paraqit para nxënësve fidanë të freskët selinoje; kërkoju atyre të provojnë shijen e saj. Nxirr se selinoja është e thyeshme dhe kërcet në gojë, kur ajo hahet. Pastaj paraqit fidanë të vyshkur të selinosë dhe tregoju se si mund t'i përkulësh degët e vyshkura të saj; por, nuk mund të përkulësh fidanët e freskët të selinosë. Pra, fidanët e vyshkur të selinosë nuk janë për t'u ngrënë.

Pyet nxënësit se çfarë mendojnë ata lidhur me fidanin e selinosë që përkulet. Nxirr përfundimin se fidani nuk është ujitur. Nëse nuk mund të gjesh fidanë selinoje, përdor çdo perime tjetër të freskët, të tillë si sallata etj.

Vëzhgim: A kanë bimët nevojë për ujë, që të rriten?

Qëllimi i këtij vëzhgimi është që nxënësit të krahasojnë se çfarë ndodh me bimën e vyshkur para dhe pas ujitjes dhe të dinë se bimët kanë nevojë për ujë që të rriten.

Nevojiten bimë të vyshkura, enë me ujë.

Fillo vëzhgimin duke pyetur:

- Si mund të kuptojmë nëse bimët kanë nevojë për ujë që të rriten? Duke mos e ujitur një bimë / duke ujitur një bimë të vyshkur për të parë se çfarë ndodh.

1. Merr një bimë që ka nevojë për ujë.

- Jepi çdo dysheje nxënësish një bimë të vyshkur.
- Kërkoju secilës dyshe të bëjnë një etiketë me emrat e tyre dhe ta vendosin tek bima e tyre e zgjedhur.

Vizato bimën në fillim dhe në fund të vëzhgimit.

Kërkoju nxënësve të vizatojnë dhe të ngjyrosin bimën e tyre në kutinë e emërtuar "Në fillim" në librit e nxënësit. Nxiti nxënësit të vizatojnë gjethet e vyshkura.

2. Ujite çdo ditë bimën me pak ujë.

- Tregoju nxënësve tri vazo me dhé e me pleh, që ti ke përgatitur për të ilustruar sasinë e ujit që nevojitet (për t'i ujitur).
- Shpjegoju se dheu me pleh nuk duhet të jetë as shumë i lagësht dhe as shumë i thatë. Merr pak dhe (pleh) të thatë dhe shkërmoqe me duart e tua, duke e lënë të bjerë përsëri në enë. Merr pak nga dheu (me pleh) me lagështirë dhe trego ndryshimin. Pastaj merr një sasi të vogël nga dheu (me pleh) shumë i lagësht dhe shtrydhe atë për të treguar se si rrjedh ujë prej tij.
- Lejoi nxënësit të prekin tri llojet e dheut për të parë se si e ndjejnë.

Sigurohu që nxënësit të lajnë duart pasi të prekin dheun (me pleh).

- Demonstro si duhet të ujitim bimët derisa dheu me pleh bëhet i njomë. Bëje gradualisht këtë veprim duke kontrolluar dheun me pleh, ndërkohë që shton ujin.
- Jepu çdo dysheje nxënësish një enë plastike me ujë dhe tregoju atyre si duhet t'i ujitin bimët e tyre çdo ditë për një javë rresht.

3. Shih çfarë ndodh.

- Thuaju nxënësve të vendosin bimët e tyre të etiketuara diku në dritë, p.sh. në parvazin e një dritareje.
- Në fund të javës kërkoju nxënësve të vizatojnë bimën e tyre në hapësirën "Në fund" në librin e nxënësit.

Pyeti ata:

Çfarë ndryshimi dalloni tani tek bima? Gjethet janë me të gjelbëruara dhe bima ka filluar të rritet përsëri.

Kërkoju nxënësve të kontrollojnë të gjitha vëzhgimet e tyre për të shikuar nëse kanë ndonjë rezultat të ri; puno përkrah tyre për të dhënë çdo informacion që mungon; kërkoju nxënësve ta shtojnë këtë në pjesët përkatëse në librin e nxënësit. Për shembull: farat e fasuleve (lakrave) duhet të jenë rritur tashmë dhe nxënësit mund t'i lidhin vëzhgimet me parashikimet e tyre. Luledielli duket se po merr pamjen e një bime të vogël. Bima e vyshkur duhet të tregojë shenja ringjalljeje. Sigurohu që të gjithë nxënësit janë angazhuar në këtë veprimtari kuptimplote të të mësuarit.

Vlerësimi i njohurive

Plotëso hapësirat me fjalët e dhëna.

Kërkoju nxënësve të plotësojnë fjalët që mungojnë në fjali. Shkruaj fjalitë në dërrasën e zezë dhe thuaj, për shembull: Bimët kanë nevojë për dritë dhe ...? për t'u rritur. Nxiti nxënësit të shikojmë tek fjalët e dhëna për të gjetur fjalët e duhura.

Përgjigjet:

Për t'u rritur, bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë. Nëqoftëse bima nuk rritet në dritë, gjethet bëhen të verdha. Në qoftë se bima nuk ka ujë, gjethet vyshken.

Përsëritje dhe reflektim

Mbylle temën duke u kërkuar nxënësve të përfundojnë veprimtarinë lidhur me përsëritjen dhe reflektimin në faqen 31 në librit e nxënësit.

Formim gjuhësor

Testoi nxënësit se sa i kanë kuptuar fjalët dhe idetë e përfshira në tematikë duke bërë pyetje rrufe.
Për shembull:

- Cili është emri i pajisjes që përdorim për të matur gjërat? *Vizore.*
- Ku mund t'i gjesh rrënjët? *Në fund të një bime.*

Veprimtari plotësuese

Kërkoju nxënësve të rishikojnë fjalorët e tyre dhe të shtojnë ndonjë nga përcaktimet që u mungon, që ka lidhje me fjalët kyçe të kësaj tematike.

Çfarë kemi mësuar rreth bimëve


Çfarë kemi mësuar rreth bimëve

Pjesët e një bime

Qarko fjalët e katër pjesëve të një bime. Lidh me një vijë fjalën me pjesën e bimës.

Dorë, Lule, Gjethe, Kërcell, Qelq, Rrënjë, Zë, Familje

Unë di emrat e katër pjesëve të një bime.

30

Ritja e bimëve

Rrit disa bimë luledielli. Lidh fjalitë me figurat.

1. Merr një vazo. Vendos disa guralecë në të.	2. Mbushe vazon me dhe e pleh. Ujite.	3. Mbill dy fara luledielli.	4. Ujiti filizat.

Unë di që farat rriten. Ato bëhen bimë dhe pemë.

Çfarë u nevojitet bimëve për t'u rritur?

Shiko figurat e bimëve dhe lexo fjalitë. Qarko fjalët e sakta.

a. Kjo bimë ka / nuk ka ujë mjaftueshëm.

b. Kjo bimë ka / nuk ka ujë mjaftueshëm.

c. Kjo bimë është rritur në dritë / në errësirë.

Unë di se bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë, që të rriten mirë.

Bimët

31

Njohuri përgatitore

Qëllimi i kësaj pjesë është të nxitë nxënësit të përsëritin njohuritë e fituara në çdo temë mësimore të kësaj tematikë. Çdo temë ka disa pyetje përforcuese, të cilave nxënësi duhet t'u përgjigjen. Këto janë pyetje që do të vlerësojnë njohuritë e nxënësit si dhe do të tregojnë të kuptuarin e temave nga ana e tij/saj.

Pas çdo grupi pyetjesh përforcuese ka disa formulime për përsëritje dhe reflektim, të cilave nxënësit duhet t'u përgjigjet.

Është e nevojshmë të lexosh formulimet dhe t'i ndihmosh nxënësit të plotësojnë rrethin e vetëvlerësimit, për të parë kështu se sa të sigurt janë ata për njohuritë e fituara në temën mësimore.

Në klasën e parë nxënësit mund të ngjyrosin një fytyrë të qeshur apo të trishtuar për të treguar nivelin e tyre të sigurisë ose mund të vënë një shenjë vlerësimi, si p.sh. shenjën V.

Është e rëndësishme që nxënësit të tregojnë pjesët, në të cilat ata nuk ndjehen të sigurt. Ky informacion është shumë i rëndësishëm për mësuesin dhe mundëson që të ofrosh ndihmën e nevojshme në vlerësimin përmbledhës (rubrika Vlerësimi i përmbledhës) në fund të tematikës.

Përsëritje dhe reflektim

Pjesët e një bime

Qarko fjalët e katër pjesëve të një bime. Lidh me një vijë fjalën me pjesën e bimës.

Kjo veprimtari teston aftësinë e nxënësve për të njohur fjalët kyçe për pjesët e një bime. Lexo çdo fjali dhe pyet nxënësit, për shembull:

- Lule. A është lulja pjesë e një bime? *Po*.
- Dorë. A është dora pjesë e një bime? *Jo.*

Ti mund të shpërndash etiketa dhe nxënësit mund t'i qarkojnë ato. Pastaj kërkoju nxënësve të përdorin një vizore dhe laps për të vizatuar vijat lidhëse për secilën nga katër fjalët e rrethuara me pjesën e duhur të bimës në figurë.

***Përgjigje**: Lule, gjethe, kërcell, rrënjë.*

Nxënësit duhet të vizatojnë vijat për të lidhur secilën prej këtyre fjalëve me pjesën që përputhet me bimën.

Emërto një gjethe që mund të hash.

Emërto një rrënjë që ju mund të hash.

Nxënësit tani aplikojnë njohuritë e tyre për pjesët e ndryshme të një bime, duke dhënë shembuj për pjesët e ngrënshme të saj. Kërkoju nxënësve të sugjerojnë disa përgjigje të mundshme dhe shkruaje ato në dërrasën e zezë, që nxënësit të zgjedhin prej tyre.

Ti gjithashtu mund t'i pyesësh ata për të dhënë shembuj lulesh që mund të hahen si dhe kërcejsh gjithashtu. Siguro shembuj konkretë apo foto gjethesh, kërcejsh, rrënjësh, lulesh dhe frutash të ngrënshme.

Kujtoju nxënësve se jo të gjitha bimët hahen!

***Përgjigjet e mundshme:** Gjethe: marule, spinaq. Rrënjë: karrota.*

Ritja e bimëve

Rrit disa bimë luledielli. Lidh fjalitë me figurat.

Kërkoju nxënësve të kujtojnë se si e rritën ata bimën e luledielli nga fara. Ti mund të kesh pajisjet e nevojshme për të mbjellur farat para klasës dhe ndërkohë t'u kërkosh nxënësve të thonë udhëzimet se çfarë duhet bërë. Për shembull:

- Cila është gjëja e parë që ne bëjmë kur mbjellim fara? Vendosim guralecë në pjesën e poshtme të vazos. Nxit menjëherë nxënësit, nëse është e nevojshme, duke i pyetur, p.sh.:
- A vendosim përzierje plehrash apo guralecë në fillim? Guralecë

Bëj pyetje të mëtejshme dhe ndiq udhëzimet e nxënësve për të përfunduar mbjelljen e farës; pastaj, kërkoju nxënësve të përfundojnë veprimtarinë në librin e nxënësit.

Tregoju nxënësve shembuj farash të ngrënshme (p.sh. thjerrëza, arra kokosi, bizele). Ndaj për gjysëm disa fruta, për t'i treguar nxënësve farat që ndodhen në brendësi të tyre.

Nxënësit mund të sugjerojnë një shumëllojshmëri ushqimesh. Nëse ata nuk sugjerojnë grurë/bukë ose oriz, tregoi atyre përgjigjen. Tregoju se të dyja janë bimë me kërcell. Këto fara jo vetëm rriten dhe bëhen bimë, por sigurojë ushqimin kryesor për gjysmën e botës.

Jep shembuj të farës dhe miellit të grurit si dhe të orizit (farave) dhe tregojua nxënësve; shoqëroje me figura dhe foto bimësh.

Çfarë u nevojitet bimëve për t'u rritur?

Shiko figurat e bimëve dhe lexo fjalitë. Qarko fjalët e sakta.

Bëj një krahasim: çfarë ndodh me bimët kur i sigurojmë ujë dhe dritë kundrejt asaj se çfarë ndodh, nëse nuk u sigurojmë ujë dhe dritë; kjo përforcon pikën kryesore të mësimit për nxënësit.

Pyet nxënësit:

- Çfarë ndodh, nëse bimët nuk do të marrin as ujë dhe as drite? Ato vyshken, bëhen të verdha dhe përfundimisht do të thahen.

Sqaroi nx**ë**n**ë**sit se ne si shkencëtarë nuk dëmtojmë asgjë dhe nuk vrasin asgjë me qëllim. Ne i ringjallim bimët përpara se të jetë shumë vonë.

Thekso nevojën për t'u kujdesur për bimët në shkollë ose në shtëpi, dhe kërkoju nxënësve të kujtojnë se si duhet ta bëjnë. Duke i ujitur bimët dhe vendosur në një vend me shumë dritë, p.sh. në parvazin e një dritareje.

***Përgjigje**:*

a) Kjo bimë nuk ka ujë mjaftueshëm.

b) Kjo bimë ka ujë mjaftueshëm.

c) Kjo bimë është rritur në dritë.

Vlerësimi përmbledhës

Formulimet për përsëritje dhe reflektim në librin e nxënësit janë një pikënisje e përkryer kur diskutohet për përparimin individual të çdo nxënësi. Ky informacion mund të përdoret gjithashtu për të krijuar një raport për çdo nxënës në fund të vitit shkollor.

Ai gjithashtu mund të jetë i dobishëm për të mbajtur një regjistër (vlerësimi) për të gjithë klasën për nivelin e përgjithshëm të sigurisë, duke identifikuar çfarë mund të kenë nevojë të rishikohet më vonë (shih një shembull në tabelën e mëposhtme).

Formulimi për përsëritje dhe reflektim	Shumë i/e sigurt	Jo aq i/e sigurt	Jo i/e sigurt

Kjo analizë (apo ky feedback) mund të përdoret më pas për të formuar një program përmirësimi (program rehabilitimi), i cili do të shërbejë për të ndihmuar nxënësit qe të përmirësohen në të ardhmen.

Thjesht ruaj regjistrimin e të dhënave dhe analizën e vetëvlerësimeve të nxënësve.

Kërkohet një përshtypje e përgjithshme e vetëvlerësimit të klasës, jo një regjistrim i vlerësimit individual të nxënësve (të dhëna individuale). Kjo është gjithçka që të duhet. P.sh.: pesëdhjetë përqind e klasës nuk ishin të sigurt në lidhje me ...

3 Ne njerëzit

Në këtë tematikë nxënësit:

- njohin ngjashmëritë dhe dallimet midis njëri-tjetrit;
- njohin dhe të emërtojnë pjesët kryesore të jashtme të trupit;
- mësojnë se si shqisat njerëzore mundësojnë njerëzit të jenë të vetëdijshëm për botën rreth tyre; po kështu, shqisat i orientojnë kafshët në jetën e tyre.

Njohuri përgatitore

Në këtë tematikë nxënësit do të mësojnë që njerëzit dhe kafshët lëvizin dhe rriten. Gjithashtu ata do të mësojnë për shqisat e tyre dhe sesi mund t'i përdorin ato për të zbuluar botën rreth nesh.

Aftësitë e hulumtimit shkencor

Nxënësve u jepet mundësia për t'iu përgjigjur pyetjeve nga të dhënat e grumbulluara me anë të vëzhgimit. Ata do të kontribuojnë në diskutime dhe do të bëjnë supozime (parashikime) për dukuritë shkencore. Nxënësit do të mësojnë se si duhen sugjeruar idetë, si duhet të ndjekin udhëzimet dhe të regjistrojnë të dhënat. Përveç kësaj nxënësit do të krahasojnë të dhënat dhe do të shohim nëse parashikimet përputhen me rezultatet e tyre. Nxënësit do të modelojnë dhe do të komunikojnë për idetë duke i ndarë ndërmjet tyre, do të shpjegojnë dhe do të zhvillojnë aftësitë e tyre të të menduarit shkencor.

Fjalë kyçe

kafshë	krah	trup	vesh	sy
këmbë	rritet	kokë		dëgjoj
njeri	gju	këmbë	gojë	hundë
kuptim	shpatull	shikim/shoh		aromë
shije	gishti i këmbës	prekje/ndjej		

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

krahaso supozo (parashiko) shiko

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë tematikë janë:

- të përfshihen në objektivat e tematikës;
- të paraqesin rezultatet e të nxënit;
- të angazhojnë nxënësit me përmbajtjen e tematikës;
- të fillojnë temën e parë të mësimit.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë më shumë për pjesët e trupit.

Kërkoju nxënësve të shikojnë fotot në faqen e parë hyrëse. Shpjego objektivat e lëndës me terma të thjeshta; nxënësit do të mendojnë rreth ngjashmërive dhe dallimeve midis njerëzve, do të mësojnë emrat e pjesëve të trupit, do të mësojnë në lidhje me pesë shqisat, dhe të ushqyerit e shëndetshëm.

Çfarë kanë të njëjtë këta njerëz? Çfarë kanë të ndryshme këta njerëz?

Kërkoju nxënësve të shikojnë përsëri fotot në faqen e parë dhe fillo diskutimin rreth ngjashmërive dhe dallimeve që ata mund të shohin midis njerëzve. Kjo veprimtari është ideuar për të zhvilluar aftësitë që lidhen me të krahasuarit e gjërave.

Ti mund t'i udhëzosh nxënësit duke u bërë pyetje të thjeshta. Për shëmbull, drejto gishtin në njërin krah në foto dhe pyet. *Sa krahë ka ky njeri?* Lëri të mendojnë dhe nxiti ata të shikojnë të gjithë njerëzit që janë në figurë; pyet: *A kanë të gjithë dy krahë?*

Shpjegoi që kjo është e njëjtë për të gjithë njerëzit që shohin. Bëj të njëjtën gjë për numrin e syve, të këmbëve etj. Përsërite këtë ushtrim edhe për dallimet.

Për shëmbull, trego një person me flokë të shkurtër dhe pyet: *A kanë të gjithë njer*ëzit *në foto flokë të shkurtër?* Shpjego se të gjithë njerëzit në foto kanë flokë, por ato janë të ndryshëm sepse disa njerëz kanë flokë të shkurtër dhe disa të tjerë kanë flokë të gjatë. Bëj të njejtën gjë për karakteristikat e tjera, si p.sh., për ngjyrën e lëkurës, gjatësinë e trupit dhe ngjyrën e syve.

Përgjigje e mundshme: *Disa njerëz kanë flokë të shkurtër dhe disa njerëz kanë flokë të gjatë.*

Shkruaj mëposhtë se ç'është e përbashkët te këta njerëz.

Këshillohet që fillimisht nxënësit të përgjigjen me gojë, përpara se ata të shohin përgjigjen të shkruar në dërrasë të zezë. Për shëmbull, pyet: A mund të gjeni diçka që kanë të njëjtë këta njerëz?

Në dërrasën e zezë shkruaj një gjë që është e njëjtë për njerëzit në foto dhe kërkoju nxënësve që ta shkruajnë atë në librin e nxënësit.

Përgjigje e mundshme: *Të gjithë këta njerëz kanë flokë.*

Fakt interesant

Referoju faktit interesant. Shpjego me terma të thjeshtë se një mace ka një shqisë shumë të fortë, atë të nuhatjes. Bëj që nxënësit të mendojnë rreth kësaj. Drejto pyetjen:

- Pse mendoni që një mace ka nevojë ta ketë shqisën e nuhatjes kaq të fortë?

Përgjigje e mundshme: *Të kërkojë për ushqim/ t'i marrë erë gjërave/t'i marrë erë ushqimit.*

Udhëzoi nxënësit drejt këtyre përgjigjeve duke i pyetur se çfarë mendojnë ato se hanë macet dhe si e gjejnë ushqimin.

Për shëmbull, pyet: *Çfarë mendoni se u pëlqen maceve të hanë?*

Formim gjuhësor

Si një pikënisje e mirë shërbejnë fjalët kyçe në fund të mësimit. Ti mund të diskutosh dhe të përkufizosh disa nga fjalët që janë të panjohura. Gjithashtu ti mund të krijosh një "Tabelë fjalësh" për mësimin, kështu që nxënësit i shohin fjalët shpesh dhe mund t'i mësojnë. Libri i nxënësit ka një fjalor, ku nxënësit rregullisht shtojnë përkufizime gjatë ecurisë së tematikës. Është e vlefshme të vazhdohet me krijimin e fjalorit.

Për t'i përforcuar më mirë fjalët e reja, kërkoju nxënësve të dëgjojnë, të thonë, të lexojnë dhe pastaj t'i shkruajnë fjalët.

Veprimtari plotësuese

Kërkoju nxënësve të tregojnë ndryshimet dhe ngjashmëritë midis tyre dhe nxënësve të tjerë, p.sh., gjatësia e flokëve apo gjatësia e trupit.

Nxit nxënësit të praktikohen për të bërë krahasime me gojë, në mënyrë që ata të ngulitin në kujtesë strukturat e duhura të fjalisë. Për shëmbull: Flokët e mi janë më të gjatë se sa flokët e tu.

Të njëjtë por të ndryshëm

Njihet me ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet njëri–tjetrit.



Njohuri përgatitore

Në këtë mësim jepet idea që ne jemi të ngjashëm, por kemi edhe dallime që na bëjnë të veçantë dhe të dallueshëm nga njëri-tjetri. Nxënësit vizatojnë fytyrat e tyre dhe mendojnë rreth ngjashmërive dhe dallimeve midis njëri-tjetrit. Idea për të gjetur dallimet është shprehur duke iu referuar zgjedhjes personale si një mënyrë alternative, për të respektuar dallimet ndërmjet njera/i–tjetrës/it.

Materiale burimore

Materiale kreative për vizatimin e fytyrave.

Fjalë kyçe

vesh sy kokë njeri gojë hundë

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

krahaso shiko

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të kuptojnë që njerëzit janë të ngjashëm, por kanë dhe ndryshime;
- të dinë që ne jemi njerëz;
- të vizatojnë një fytyrë dhe të emërtojnë hundën, veshët, sytë, gojën, flokët dhe kokën;
- të mendojnë për karakteristika të ndryshme të njerëzve, si p.sh., çfarë pëlqen secili dhe për veçoritë fizike.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të mësojnë më shumë për emrat e pjesëve të jashtme të trupit.

Veprimtaria e parë mbështetet në punën që nxënësit kanë bërë, ndërkohë që po shikonin dhe po diskutonin për fotot në faqet e para. Kërkoju nxënësve të shikojnë fotot në librin e nxënësit dhe fillo një diskutim.

A janë këta njerëz të njëjtë?

Kërkoju nxënësve të flasin rreth asaj çfarë ata shohin në foto. Kujtoju që ka dallime ndërmjet nesh. Shpjegoju që disa dallime ndodhin gjatë rritjes sonë, p.sh., ne rritemi dhe bëhemi më të gjatë. Diskuto me nxënësit se, kur ishin bebe, ata ishin shumë të vegjël.

Paraqit fjalën "njerëzor" duke shpjeguar që të gjithë njerëzit janë njerëzorë.

Shpjegoju që ne jemi të gjithë njerëz, por që dukemi lehtësisht të ndryshëm dhe kjo është arsyeja pse ne i kujtojmë njerëzit individualisht. Shpjego me terma të thjeshtë që ne të gjithë jemi të veçantë.

Përgjigje e mundshme: *Jo.*

Vizato fytyrën tënde. Përfundo etiketat.

Trego me gishtin e dorës hundën tënde dhe kërkoju nxënësve të bëjnë si ti. Kjo është hunda ime. Bëj që nxënësit ta përsëritin atë pas teje. Bëj të njëjtën gjë për sytë, veshët, gojën, flokët dhe kokën.

Kërkoju nxënësve të vizatojnë dhe etiketojnë fytyrën duke përdorur skicën që jepet në librin e mësuesit. Ata pastaj mund të ngjyrosin flokët e tyre dhe tiparet e fytyrës.

Përgjigje*: Sytë, hunda, veshët, goja, koka, flokët.*

Kur nxënësit të kenë plotësuar fytyrën e tyre, fillo diskutimin duke pyetur:

- Shiko fytyrën që ke vizatuar. Si ndryshon ajo nga të gjitha të tjerat?

Përdor diskutimin për të përforcuar idenë që ne jemi të njejtë, por të ndryshëm. Lëri nxënësit të gjejnë dallimet në fytyrat e tyre, p.sh., flokë të gjatë. Ti mund të përdorësh fytyrën tënde për të bërë krahasimin. Kërkoju nxënësve të tregojnë se sa karakteristika të fytyrës kanë ata; si p.sh.: Sa sy keni? Etj.

Ti duhet që t'i diskutosh këto krahasime me shumë kujdes, sidomos nëse në klasë ka ndonjë nxënës me ndonjë të metë.

Përforco se ne të gjithë kemi karakteristika të fytyrës, por ato janë të gjitha qartësisht të ndryshme, gjë që na bën që ne ta dallojmë njërën/in prej tjetrës/it.

A pëlqejnë të gjithë shokët/shoqet të njëjtat gjëra?

Ndaj nxënësit në grupe ose në dyshe dhe pyeti për gjërat që ata pëlqejnë, p.sh., ushqimi që u pëlqen dhe lojërat që u pëlqejnë. Kjo do të nxitë shumë përgjigje dhe do të përforcojë faktin që ne të gjithë pëlqejmë gjëra të ndryshme, gjë që tregon në një mënyrë tjetër që ne të gjithë jemi të ndryshëm.

Cila është ngjyra që të pëlqen?

Kërkoju nxënësve të thonë përgjigjet e tyre dhe shkruaji ato në dërrasë të zezë. Përdor shkumës me ngjyra për t'i ndihmuar nxënësit të kujtojnë dhe të emërtojnë ngjyrat.

Kërkoju nxënësve të shkruajnë emrin e ngjyrës së tyre të parapëlqyer në librin e nxënësit.

Përgjigje e mundshme: *E kuqe.*

Cila është kafsha më e dashur për ty?

Përsëri shkruaj përgjigjet e nxënësve në dërrasën e zezë dhe vendos emrin e secilës kafshë.

Kërkoju nxënësve të shkruajnë në librin e nxënësit emrin e kafshës së tyre të dashur. Fillo diskutimin duke i pyetur nëse të gjithë pëlqejnë të njëjtën kafshë.

Përgjigje e mundshme: *Qen.*

Vlerësimi i njohurive

Plotëso me fjalët që mungojnë.

Kërkoju nxënësve të plotësojnë fjalët që mungojnë në librin e nxënësit.

Përgjigje*: Ne jemi të gjithë <u>të ndryshëm</u>.*
Ne kemi disa <u>gjëra</u> që janë <u>të njëjta</u>.

Përsëritje dhe reflektim

Mbylle temën e mësimit duke u kërkuar nxënësve të bëjnë përsëritjen dhe ushtrimin në faqen 44 në librin e nxënësit.

Formim gjuhësor

Sugjerimet për formimin gjuhësor janë të lidhura me hapat e mësimdhënies. Për të ndihmuar më tej në formimin gjuhësor, ti mund të mbash etiketa ngjitëse me figurat e tipareve të fytyrës dhe të tjera me emrat e tyre; pastaj kërkoju nxënësve të lidhin figurat me emrat.

Veprimtari plotësuese

1 Kërkoju nxënësve të krijojnë një ekspozitë në klasë me fytyrat e tyre. Jepu atyre një skicë të gjërë fytyre që ta përdorin për të vizatuar secili fytyrën e vet. Pastaj "priti të gjitha fytyrat" dhe përdori për të krijuar një kolazh në mur.

2 Zhvillo një ushtrim ndërkurrikular duke i pyetur nxënësit se sa hundë ndodhen në dhomë, sa sy, veshë etj.

3 Nxënësit plotësojnë fjalorin me fjalët e përdorura në mësim. Ata gjithashtu mund të shtojnë fjalë për pjesët e fytyrës në "Tabelën e fjalëve". Vendos fjalët në thonjëza: "kokë", "sy", "veshë", "hundë" dhe "gojë".

Mendo rreth… Kjo pyetje është hartuar për të zgjeruar të menduarit e nxënësve rreth ndryshimeve midis nesh. Prit përgjigje që shpjegojnë se: edhe pse ne kemi karakteristika të njëjta - sytë, hundën, gojën, etj - ne jemi shumë të ndryshëm.

Trupi ynë

Njihet dhe emërton pjesët kryesore të jashtme të trupit.



Njohuri përgatitore

Kjo temë paraqet para nxënësve trupin e tyre. Në fund të këtij mësimi nxënësit duhet të jenë në gjendje të njohin dhe të emërtojnë pjesët kryesore të jashtme të trupit. Ti duhet ta trajtosh këtë mësim me një shkallë ndjeshmërie, veçanërisht nëse ndonjë nga nxënësit të meta trupore apo aftësi të kufizuara. Mësimi gjithashtu u krijon mundësinë nxënësve për të praktikuar aftësitë e tyre të numërimit. Ti mund t'i argëtosh, duke kënduar një këngë për pjesët e trupit (shih hapat mësimore).

Materiale burimore

Vizore dhe lapsa.

Fjalë kyçe

krah	trup	këmbë	rritje
gju	këmbë	shpatull	gisht

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

supozo (parashiko)

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të përforcojnë dhe të emërtojnë tiparet e fytyrës;
- të njohin dhe të emërtojnë pjesët e jashtme të trupit;
- të lidhin pjesët e trupit me emrin e saktë;
- të këndojnë një këngë në lidhje me pjesët e trupit.

Në temën e ardhshme nxënësit do të mësojnë më shumë për shqisat.

Përfundo etiketat për pjesët e trupit.

Kjo temë ka të bëjë me emërtimin e pjesëve të jashtme të trupit. Kërkoju nxënësve të shikojnë figurën në librin e nxënësit. Figura tregon një model të trupit me pjesët e tij të etiketuara në mënyrë të zbehtë.

Thuaju nxënësve se do të mësojnë rreth pjesëve të trupit. Vendos gishtin në kokën tënde dhe thuaj, kjo është koka ime. Bëj të mundur që nxënësit të të kopjojnë dhe të përsëritin fjalinë. Bëje këtë për secilën nga pjesët e trupit të etiketuar në figurë. Pastaj kërkoju nxënësve të shkruajnë emrat e pjesëve të trupit në librin e nxënësit, duke shkruar përsipër mbi etiketat e zbehta.

***Përgjigje**: Kokë, shpatull, krah, bërryl, dorë, gisht, këmbë, gju, shputë e këmbës, gisht i këmbës.*

Sa krahë ke?

Këto veprimtari me shkrim mund të përdoren, krahas lojës (në mësimdhënie) "Albani thotë" (shih "Të zgjerojmë njohuritë"), për të mësuar emrat e pjesëve te trupit.

Thuaju nxënësve të shkruajnë përgjigjet e tyre në librin e nxënësit.

***Përgjigje**: Dy krahë.*

Sa gishta këmbe ke?

***Përgjigje**: Dhjetë gishtërinj.*

Si një veprimtari përforcimi, kërkoju nxënësve të ulen në formë rrethi në dysheme me këmbët përballë midis tyre. Tregoju atyre se ata kanë për të kënduar një këngë në lidhje me pjesët e trupit, të quajtur "Kokë, supe, gjunjë dhe gishta këmbe". Kërkoju nxënësve të tregojnë secilën pjesë të trupit, ndërsa ato këndojnë për fjalët.

Fillo duke thënë fjalët e këngës dhe bëj që nxënësit t'i përsëritin ato. Përcakto çdo pjesë të trupit tënd gjatë kohës që ti thekson: kokë, supe, gjunjë, gisht këmbe, sytë, veshët, goja, hunda.

Pastaj këndo këngën me zë të lartë.

Koka, shpatullat, gjunjët dhe gishtërinjtë, gjunjët dhe gishtërinjtë (×2) dhe sytë dhe veshët dhe goja dhe hunda.

Koka, supet, gjunjët dhe këmbët, gjunjët dhe gishtat.

Përsërit vargjet duke rritur ritmin çdo herë. Bëje këtë deri në tre herë, duke e përsëritur shpejt e më shpejt.

Lidh secilën pjesë të trupit me fjalën e saktë.

Veprimtaria e ardhshme është një veprimtari përforcuese.

Tregoju se si lidhen emrat me pjesët e trupit.
Për shembull, vizato një krah në tabelë dhe shkruaj fjalën "krah", si dhe përdor një vizore për ta lidhur fjalën me figurën.

Shpjegoju nxënësve se shumësi i fjalës "këmbë" është "këmbët".

***Përgjigje**: a) koka, b) krahu, c) bërryli, d) dora, e) këmba, f) gjuri, g) këmba.*

Ku janë goja, hunda, sytë dhe veshët e tu? Lidh me vijë secilën fjalë me pjesën e saktë të fytyrës.

Kërkoju nxënësve të përfundojne ilustrimin e fytyrës, duke lidhur me një vijë çdo etiketë me pjesën përkatëse të fytyrës.

Veprimtaria përforcon të mësuarit e fjalorit të saktë për sa i përket pjesëve të fytyrës.

***Përgjigje**: Vijëzimet bëhen për të lidhur etiketat me pjesët përkatëse të fytyrës: a) sytë, b) hunda, c) veshët, d) goja, e) flokët.*

Vlerësimi i njohurive

Gjej fjalët.

Përdor veprimtarinë e lojës gjë a gjëzë si veprimtari përforcimi. Kërkoju nxënësve të përdorin lapsa dhe vizore për të gjetur pjesët e trupit.

***Përgjigje**:*

k	r	a	h	k	h	e	e	g
t	o	e	s	k	u	v	r	i
f	k	n	g	e	n	e	j	s
s	o	n	l	e	d	s	o	h
f	k	ë	m	b	ë	h	c	t
d	ë	y	j	h	e	a	d	a
s	h	p	a	t	u	l	l	a
s	h	o	g	j	u	n	j	ë

Përsëritje dhe reflektim

Mbylle temën duke u kërkuar nxënësve të përfundojnë përsëritjen dhe veprimtarinë e reflektimit në faqen 44 në librin e nxënësit.

Formim gjuhësor

Sugjerimet në ndihmë të të folurit jepen në të gjitha hapat e mësimdhënies. Për mbështetje të mëtejshme të zhvillimit gjuhësor ti mund të përdorësh etiketa të ngjyrosura me fjalë dhe foto të pjesëve të trupit. Kërko nga nxënësit të tregojnë çdo pjesë të trupit të tyre, ndërkohë që ti mban etiketat si shenjë treguese.

Veprimtari plotësuese

1 Luaj me nxënësit në mënyrë argëtuese "Albani thotë", për të përforcuar pjesët e trupit. Bëj të mundur që nxënësit të ulen në dysheme në formë rrethi.

Një lojtar është "Albani" (ose një emër tjetër sipas zgjedhjes suaj), ndërsa lojtarët e tjerë duhet të bëjnë çfarë thotë Albani, për aq kohë sa fraza "Albani thotë" vjen para komandës (p.sh. " Albani thotë: prekni hundën"). Nëse Albani nuk thotë shprehjen "Albani thotë" para komandës, lojtarët nuk duhet të ndjekin komandën. Nëse një lojtar ndjek një komandë ende pa thënë shprehjen Albani, atëherë ky lojtar është jashtë loje. Personi i fundit që qëndron në lojë është fitues.

2 Kërkoju nxënësve të shtojnë fjalët që mbulon ky mësim në rubrikën "Tabelë fjalësh": "njerëzor'", "trup", "krah", "sup", "këmbë", "gju", "gishti i këmbës", "sy", "vesh", "gojë", "hundë".

Pesë shqisat

Zbulon se si shqisat mundësojnë që njerëzit të jenë të vetëdijshëm për botën rreth tyre; po kështu shqisat e kafshëve i orientojnë ato në jetën e tyre.



Njohuri përgatitore.

Kjo është njëra nga dy temat që trajton shqisat te njerëzit dhe kafshët. Tema e parë shqyrton shqisat e shikimit dhe të dëgjimit; tema e dytë merr në shqyrtim shqisën e shijes, të prekjes dhe të nuhatjes. Ti mund t'i zgjerosh temat duke përdorur materiale shqisore të tilla, si instrumente muzikore, objekte me ngjyra, lëndë ushqimore me shije të veçantë etj. Sugjerime të mëtejshme janë bërë brenda çdo mësimi.

Materiale burimore

Materiale që nxitin shqisat, të tilla si: instrumente muzikore, p.sh,. kitarë, saze, daulle; objekte me ngjyra, p.sh., lodra, fruta; ylber i madh me ngjyra; materiale krijuese, përfshirë lapsa me ngjyra për çdo ngjyrë të ylberit; vizore dhe lapsa.

Fjalë kyçe

kafshë	dëgjo	dëgjimi
shqisë	shiko	shikimi

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të mësojnë në lidhje me shqisat e shikimit dhe të dëgjimit;
- të njohin se cilat pjesë të trupit përdoren për shikim dhe për dëgjim;
- të krahasojnë shikimin e një njeriu me atë të një maceje;
- të dinë se çfarë gjërash bëjnë zhurmë çdo ditë dhe çfarë nuk bëjnë.

Në temën e ardhshëm nxënësit do të mësojnë më shumë për shijen, prekjen dhe nuhatjen.

Ku janë veshët e maces? Po sytë, hunda dhe goja?

Veprimtaria fillestare organizohet për të shqyrtuar tiparet e fytyrës, por këtë herë duke përdorur foton e një koteleje. Kjo veprimtari është paracaktuar për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë se kafshët kanë karakteristika të ngjashme me njerëzit.

Kërkoju nxënësve të shikojnë nga afër foton e fytyrës së koteles. Mundëso që ato të përdorin vizoret dhe lapsat e tyre për të lidhur etiketat me tiparet e fytyrës së koteles: me veshët, sytë, gojën dhe hundën.

***Përgjigje**: Vijat bëhen për të lidhur etiketat me pjesët përkatëse të fytyrës së koteles: a) veshët, b) sytë, c) hunda, d) goja.*

Për çfarë na shërbejnë sytë?

Shpjegoju nxënësve se njerëzit dhe kafshët përdorin shqisat për të eksploruar dhe për të mësuar rreth botës. Kërkoju nxënësve të shikojnë figurën e syve.

Shkruaj përgjigjen në dërrasën e zezë dhe kërkoju nxënësve ta kopjojnë atë në librin e nxënësit. Tregoju atyre se sa e rëndësishme është shqisa e shikimit dhe zgjidh disa shembuj për të treguar se për çfarë na shërben; p.sh., për të lëvizur në mënyrë të sigurtë, për të lexuar etj.

***Përgjigje e mundshme:** Shikimi.*

A mendon se macet mund të shikojnë më mirë se ne?

Kërkoju nxënësve të shikojnë fotot e shikimit në largësi nga një njeri dhe nga një mace. Fillo diskutimin në lidhje me atë se çfarë mund të shikojnë, duke i pyetur:

- A mendoni se macet mund të shikojnë më mirë se ne?

Për të zgjeruar të menduarit e nxënësve mund t'u thuash atyre se macet e ndjekin shumë mirë lëvizjen. Macet mund të shikojnë hijet e gjelbra

dhe blu, por ata nuk mund t'a dallojnë të kuqen. Krahasuar me njerëzit, ato shohin rreth gjashtë herë më turbullt në dritë. Ato gjuajnë në muzg, sepse kjo është koha e ditës kur sytë e tyre janë të programuar të punojnë më mirë.

Shpjegoju nxënësve se ne mund të shohim një larmi ngjyrash të ndryshme. Bëj krahasimin e kësaj me faktin që macja nuk mund të dallojë një larmi të tillë; p.sh., me fjalë të thjeshta: *Macet nuk mund të shohin të njëjtat ngjyra, ashtu siç mundemi ne.*

Përgjigjet e mundshme: *Ato mund të shohin më mirë se ne gjatë natës. / Ato shohin qartë gjatë natës. / Gjatë ditës ato shohin pak ngjyra. / Ngjyrat janë të ndryshme.*

Ngjyros ylberin.

Tregoju nxënësve figurën e ylberit. Kërkoju atyre të ngjyrosin ylberin në librin e nxënësit duke përdorur foton si udhëzuese.

Nxënësit ndihmohen me emrin e çdo ngjyre në skicën e dhënë.

Për çfarë na shërbejnë veshët?

Kur nxënësit të kenë përfunduar me ngjyrosjen e ylberit, kërkoju atyre të shikojnë në foton tjetër në librin e nxënësit dhe të mendojnë se për çfarë na shërbejnë veshët.

Shkruaj përgjigjet në dërrasën e zezë dhe kërkoju atyre ta kopjojnë atë në librin e tyre.

Përgjigje të mundshme: *Për të dëgjuar / për të dëgjuar.*

Shiko figurat. Qarko sendet që prodhojnë tinguj.

Bëj në dërrasë të zezë një tabelë, ku të jenë të shkruar këto dy tituj "Këto gjëra prodhojnë një tingull" dhe "Këto gjëra nuk **prodhojnë** tingull".

Kërkoju nxënësve të shikojnë foton në librin e nxënësit dhe të qarkojnë objektet që **prodhojnë** tingull dhe ato që nuk **prodhojnë**. Shkruaj përgjigjet në dërrasën e zezë.

Për të përforcuar njohjen me fjalë të reja, kërko nga nxënësit që të dëgjojnë, të thonë, të lexojnë dhe pastaj të shkruajnë fjalët.

Pasi të kesh bërë një listë të plotë të objekteve, kërkoju nxënësve të qarkojnë ato objekte që prodhojnë një tingull.

Përgjigje*: Gjërat që prodhojnë tingull: daulle, radio, gojë.*

Gjërat që nuk prodhojnë tingull: tortë, tavolinë, libër.

Formim gjuhësor

Për të mbështetur zhvillimin gjuhësor përdor disa nga sugjerimet e dhëna në hapat e mësimdhënies.

Përveç kësaj ti mund të përdorësh një larmi të madhe materialesh që nxitin shqisat për të zhvilluar të shqiptuarit; p.sh., merr një nga objektet dhe emërtoje, trego ngjyrën e tij. Pastaj merr një objekt tjetër dhe pyet:

Si quhet kjo? Çfarë ngjyre ka?

Veprimtari plotësuese

1. Përdor materialet e lidhura me shqisat për të përforcuar emrat e objekteve dhe ngjyrat, siç përshkruhet më lart tek formimi gjuhësor.
2. Përdor instrumentat muzikorë për të treguar dallimin midis tingullit të lartë dhe atij të ulët, p.sh., duke goditur një daulle shumë rëndë dhe shumë lehtë.
3. Mundësoi nxënësit të bëjnë postera objektesh shqisore (të lidhura me shqisat) me temë "Unë mund ta shoh këtë" dhe "Unë mund ta dëgjoj këtë".

Pesë shqisat

Zbulon se si shqisat mundësojnë që njerëzit të jenë të vetëdijshëm për botën rreth tyre; po kështu shqisat e kafshëve i orientojnë ato në jetën e tyre.


Pesë shqisat

Mëso rreth shqisave tona.

Ideja kryesore

Neve na pëlqen të hamë gjëra që kanë aromë të mirë dhe shije të këndshme.

Shija

Cili është ushqimi juaj i parapëlqyer?

Disa ushqime kanë **shije** të kripur, kurse disa ushqime të tjera, shije të ëmbël.

Me anë të gjuhës ne dallojmë ndryshimin ndërmjet së kripurës dhe së ëmbëlës.

Cili prej ushqimeve ka shije të kripur dhe cili prej tyre ka shije të ëmbël?

i/e kripur i/e ëmbël

e ëmbël

Nuhatja

Për disa gjëra përdoret **nuhatja**.

Thuaj një gjë që për ty ka aromë të mirë.

Disa kafshë përdorin shqisën e tyre shumë të ndjeshme të nuhatjes për të gjetur ushqimin.

Disa gjëra nuk kanë aromë të këndshme. A mund të mendosh për ndonjë gjë që nuk ka aromë të këndshme?

Disa lule kanë aromë të mirë.

Prekja

Shiko figurat.

Cilat gjëra janë të buta, kur i prek? Cilat gjëra janë të rrezikshme, kur i prek?

Ne njerëzit

Plotëso fjalët që mungojnë. Ndiq shembullin.

-pesë- e shijes e nuhatjes

Ne kemi p e s ë shqisa.

Ato janë: shqisa e shikimit, e dëgjimit, ... , e prekjes dhe ... .

Shko në faqe 45 për të kontrolluar se çfarë di.

40

41

Njohuri përgatitore

Kjo është tema e dytë që i kushtohet trajtimit të shqisave dhe fokusohet te shqisa e shijes, e prekjes dhe e nuhatjes. Lidhjet ndërmjet ushqimit që ka aromë të mirë dhe atij që ka shije të mirë bëhen me fjalë shumë të thjeshta. Duke ofruar për shqyrtim një larmi të madhe materialesh që nxitin shqisat, te nxënësit do të rritësh në masë të madhe të mësuarit e tyre (shqisave) në këtë temë.

Fjalë kyçe

aromë nuhatja shije
prekja shqisë

Materiale burimore

Një shumëllojshmëri materialesh që nxitin shqisat: artikuj ushqimorë që janë të ëmbël dhe të kripur; sende me aroma të ndryshme, si p.sh. lule, bukë e freskët, kokrra kafeje; pëlhura të ndryshme, si p.sh., kadife, saten, mëndafsh, pëlhurë kërpi për çanta, pambuk; "çanta" që përmbajnë sende të ndryshme për t'u identifikuar nga nxënësit me anë të prekjes.

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të mësojnë në lidhje me shijen, prekjen dhe nuhatjen;
- të përdorin materiale ndijore për të zbuluar rolin e shqisave të tyre;
- të njohin se ka disa gjëra që ne nuk duhet as t'i hamë dhe as t'i prekim.

Në temën e ardhshme nxënësit do të mësojnë për të ushqyerit e shëndetshëm.

Cili është ushqimi juaj i parapëlqyer?

Fillo temën duke u kërkuar nxënësve të shikojnë personin që po shijon një vakt të shijshëm dhe duke i pyetur ato se çfarë ushqimi u pëlqen të hanë. Shkruaj përgjigjet e nxënësve në dërrasën e zezë, pastaj kërkoju të shkruajnë përgjigjet e tyre në librin e nxënësit.

Përgjigjet e mundshme: *Mollë, djathë, pica etj.*

Cili prej ushqimeve ka shije të kripur dhe cili prej tyre ka shije të ëmbël?

Shpjego se disa ushqime kanë shije të kripur dhe disa ushqime kanë shije të ëmbël. Shpjego me terma të thjeshta që ne kemi sytha të shijes në gjuhën tonë, të cilat mundësojnë dallimin ndërmjet ushqimeve të kripura dhe të ëmbla.

Tregoju nxënësve disa ushqime të ëmbla dhe të kripura dhe kërko prej tyre të shijojnë ushqimet. Pyet se cili ushqim është i kripur dhe se cili është i ëmbël.

Mos përdor fara të kripura, në rast se ndonjë nga nxënësit ka alergji prej tyre.

Përzgjidh ushqime të ëmbla dhe të kripura që nxënësit pëlqejnë. Diskuto me to gjatë kohës që hanë, duke pyetur se kush e gatuan apo e blen atë. Kjo mund të jetë një detyrë grupi në dyshe, ku ata i tregojnë njëri tjetrit se çfarë u pëlqen. Ata gjithashtu mund të diskutojnë dhe vendosin se cili në dyshen e nxënësve ha më shumë të ëmbla / dhe cili të kripura.

Nëse nuk dëshiron të organizosh një veprimtari të provës shijes, thjesht mund t'u kërkosh nxënësve të klasifikojnë artikujt ushqimorë në artikuj të ëmbël dhe të kripur.

Kërkoju nxënësve të shikojnë në fotot e librit të nxënësit. Vendosi ato të punojnë në dyshe për të marrë një vendim, nëse ushqimet janë të ëmbla apo të kripura.

Kërkoju nxënësve të shkruajnë fjalën "ëmbël" ose "kripur" në çdo kuti në figurë.

***Përgjigje**: a) Çokollatë - e ëmbël, b) Djathë - i kripur, c) Picë - e kripur, d) tortë - e ëmbël, e) Bukë - e kripur, f) Fruta thata – të ëmbla.*

Thuaj një gjë që për ty ka aromë të mirë.

Kërkoju nxënësve të shikojnë foton e vajzës që po i merr erë një luleje; pastaj, paraqit disa materiale me aromë. Kërkoju atyre t'i marrin erë sendeve dhe pyeti se cila ka aromë të këndshme dhe cila nuk ka aromë të këndshme. Ti mund të marrësh përgjigje të ndryshme, sepse njerëzit pëlqejnë aroma të ndryshme midis tyre. Kërkoju nxënësve të emërtojnë aromën e tyre që u pëlqen. Shkruaj përgjigjet e tyre në dërrasën e zezë dhe pastaj kërkoju të shkruajnë përgjigjen e tyre në librin e nxënësit.

Shpjego rëndësinë e nuhatjes dhe diskuto për disa nga përdorimet e saj. Bëj lidhjen me atë çfarë është thënë më lart përsa i përket aftësisë nuhatëse të një maceje (siç është diskutuar në faqet e fillimit) dhe shpjego, pse disa kafshë përdorin shqisën e tyre të fortë të nuhatjes për të gjetur ushqim për të ngrënë.

***Përgjigje të mundshme:** Lule, bukë sapo e pjekur etj.*

Disa gjëra nuk kanë aromë të këndshme. A mund të mendosh për ndonjë gjë, që nuk ka aromë të këndshme.

Fillo diskutimin lidhur me gjërat që nuk kanë aromë të këndshme.

***Përgjigje të mundshme:** Vezë të prishura etj.*

Cilat gjëra janë të buta kur i prek? Cilat gjëra janë të rrezikshme kur i prek?

Shpjego se prekja është një ndjesi shumë e rëndësishme dhe se ka disa gjëra që ne mund t'i prekim dhe disa gjëra që ne kurrë nuk duhet t'i prekim. Paraqitu nxënësve "çantat e tyre" që ke përgatitur dhe pyeti se çfarë e ndjejnë mirë (e dallojnë) me të prekur dhe çfarë jo.

***Përgjigje të mundshme:** Jo e rrezikshme për tu prekur: "lepur", top futbolli.*
E rrezikshme për tu prekur: Kaktus etj.

Kërkoju nxënësve të shikojnë figurat në librin e nxënësit. Thuaj emrat e sendeve për të mbështetur zhvillimin gjuhësor, dhe pastaj pyet se cilat gjëra mund t'i prekin dhe se cilat gjëra nuk duhet t'i prekin.

Vlerësimi i njohurive

Plotëso fjalët që mungojnë. Ndiq shembullin.

Kërkoju nxënësve të përfundojnë veprimtarinë lidhur me fjalët që mungojnë.

***Përgjigje:** Ne kemi <u>pesë</u> shqisa.*
Ato janë shqisa e shikimit, e dëgjimit, <u>e shijes</u>, e prekjes dhe <u>e nuhatjes</u>.

Përsëritje dhe reflektim

Mbylle temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë veprimtarinë e përsëritjes dhe reflektimit në faqen 45 në librin e nxënësit.

Formim gjuhësor

Ti mund të përdorësh etiketa të ngjyrosura, duke treguar foto të një hunde, një goje, të veshëve dhe syve; kërkoju nxënësve të bëjnë lidhjen e secilës prej tyre me shqisën përkatëse. Zgjero të menduarit e tyre duke i pyetur, p.sh., se cila pjesë e trupit është e lidhur me prekjen. Ti mund të krijosh një "Tabelë fjalësh" me fjalët e përdorura në mësim.

Veprimtari plotësuese

1. Kërkoju nxënësve të krijojnë një poster ku të emërtohen dhe të ilustrohen të gjitha shqisat.
2. Kërkoju nxënësve të bëjnë një poemë apo një këngë në lidhje me shqisat.

Të ushqyerit e shëndetshëm

Mëson për nevojën e një diete të shëndetshme, që përfshin lloje të caktuara ushqimi dhe ujin.



Njohuri përgatitore

Kjo temë trajton se nga çfarë përbëhet një dietë e shëndetshme. Tema nuk trajton me shumë hollësi faktin që shumë ushqime janë jo të shëndetshme. Ajo na tregon për ushqime që janë të mira apo të këqija për ne. Nxënësit mësojnë pse ne kemi nevojë për një dietë të shëndetshme dhe se çfarë ndodh, nëse dietat janë jo të shëndetshme.

Materiale burimore

Pako boshe ushqimesh, të tilla si pako të patatinave, pako orizi, pako ushqimesh të parapërgatitura; plastelinë; fruta të freskëta dhe perime apo modele të tyre, si dhe figura dhe foto bimësh, prej të cilave vijnë këto ushqime; tabakë letre.

Fjalë kyçe

fermë

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

kërko klasifiko

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të njohin se çfarë nënkuptohet me një dietë të shëndetshme;
- të dinë disa prej përbërësve të një diete të shëndetshme;
- të dinë se ne kemi nevojë për një dietë të shëndetshme për të pasur shëndet të mirë;
- të kuptojnë se dietat e gabuara mund të çojnë në probleme shëndetësore.

Në temën e ardhshme nxënësit do të rishikojnë dhe do të arsyetojnë mbi atë që kanë mësuar në këtë tematikë.

Çfarë ke ngrënë mbrëmë?

Veprimtaria fillestare është një seancë diskutimi ku nxënësit flasin për një vakt tipik. Kërkoju nxënësve të punojnë në dyshe dhe t'i tregojnë njëri-tjetrit se çfarë kanë ngrënë një natë më parë.

Shkruaj se çfarë ke ngrënë mbrëmë.

Kërkoju nxënësve të shkruajnë atë që kanë ngrënë mbrëmjen e kaluar. Shëno të gjitha llojet e ushqimeve që nxënësit kishin ngrënë mbrëmjen e kaluar dhe paraqiti me anë të një tabele në dërrasë të zezë.

Kërkoju nxënësve të vëzhgojnë nga afër pamjen e pjatës së ushqimit. Shpjegoju nxënësve se ajo tregon një dietë të shëndetshme. Ajo ka baraspeshën e duhur të pesë llojeve kryesore të ushqimit:

1 bukë dhe drithëra, 33%;

2 fruta dhe perime, 33%;

3 qumësht dhe nënproduktet e tij, 15%;

4 mish dhe peshk ose produkte alternative me proteinë të lartë, 12%;

5 ushqime me yndyrë dhe sheqerna, 7%.

Shpjegoju nxënësve se ne kemi nevojë më shumë për llojet e ushqimeve 1 dhe 2 pastaj kemi nevojë për llojet e ushqimit 3 dhe 4, dhe vetëm pak prej 5. Thekso që ne na duhet të ushqehemi me pesë llojet e ushqimit dhe në baraspeshën e duhur midis tyre. Trego se çfarë ndodh, nëse ne nuk e zbatojmë këtë mënyrë të ushqyeri.

Diskuto kuptimin e fjalës "baraspeshë" dhe thuaju ta shtojnë në "Tabelë fjalësh".

Kërkoju nxënësve të thonë një ushqim nga njëri prej pesë llojeve që ata hanë në shtëpi. Kjo do të të sigurojë që ata i kuptojnë llojet e ndryshme të ushqimeve, për të cilët ke folur. Shpjegoju se ne kemi nevojë për një dietë të shëndetshme, në mënyrë që trupi ynë të mund të rritet dhe të riparojë veten.

Shpjegoju se dieta jonë është ajo që ne hamë çdo ditë.

Shiko figurën e pjatës me ushqime. Krijo një vakt të shëndetshëm.

Kërkoju nxënësve të punojnë në dyshe për të bërë një model të një vakti të shëndetshëm duke përdorur modelime plastike. Kjo veprimtari estetike mundëson nxënësit të krijojnë "fizikisht" përmasat e një vakti të shëndetshëm. Pastaj drejto këto pyetje.

- A mendon se ushqimi që ke ngrënë mbrëmë ishte i shëndetshëm apo i dëmshëm?
- Si mund ta bëjmë dietën tonë më të shëndetshme?

Përgjigje të mundshme: *Duke ngrënë më shumë fruta dhe perime, duke ngrënë pak çokollata.*

- Nëse njerëzit nuk hanë një dietë të shëndetshme, çfarë mendon se mund të ndodhë?

Përgjigje të mundshme: *Ata mund të sëmuren, të shëndoshen në peshë, ose te dobësohen shumë.*

- Pse është e rëndësishme të pijmë diçka?

Përgjigje të mundshme: *Për të ndaluar etjen; ne kemi nevojë për ujë për të jetuar.*

Shpjegoju se të gjitha gjallesat kanë nevoje për ujë për të jetuar. Përforco se të gjitha qeniet e gjalla kanë nevojë si për ushqim ashtu dhe për ujë për t'u mbajtur të shëndetshme.

Vëzhgim: Cilat ushqime janë të shëndetshme?

Qëllimi i këtij vëzhgimi është që nxënësit të identifikojnë ushqimet e shëndetshme dhe ato jo të shëndetshme. Përdor aftësitë kërkimore shkencore të krahasimit, të vëzhgimit, të përvojës dhe parashtro pyetje. Ty do të duhet paketa ushqimesh. Zgjidh një shumëllojshmëri të lartë ushqimesh që janë të shëndetshme dhe të tjera që janë jo të shëndetshme; p.sh., paketa orizi, paketa patatinash, pije me gaz, çokollatë e ambalazhuar, bukë, fruta etj.

1 Vendos një tabak letre ku shkruhet emërtimi "Shëndetshme", "Jo të shëndetshme" dhe "Nuk jam i sigurt'".

2 Kërkoju nxënësve të punojnë në dyshe për të shikuar paketat e ushqimit.

3 Pastaj kërkoju nxënësve të klasifikojnë paketat ushqimore në tri kategori.

4 Nxiti nxënësit për të të pyetur dhe kërkuar këshilla në lidhje me ushqimet, për të cilat nuk janë të sigurtë. Kur të pyesin, shpjegoju nxënësve se cilat kategori bien poshtë dhe pse.

Vlerësimi i njohurive

Pse na duhet një dietë e shëndetshme?

Kërkoju nxënësve të plotësojnë fjalitë për dietën e shëndetshme duke përdorur fjalët e dhëna.

Përgjigje*: Neve na duhet një dietë të shëndetshme për t'u rritur. Që të jemi të shëndetshëm ne duhet të pimë shumë ujë.*

Qarko përgjigjet. Ato mund të jenë më shumë se një.

Kërkoju nxënësve të qarkojnë figurat e duhura. Ata mund të shikojnë një përgjigje model për t'u udhëzuar.

Përgjigje*: Nxënësit duhet të qarkojnë figurat e ushqimeve të renditura më poshtë:*
Një dietë e shëndetshme
ka shumë fruta, perime, bukë, oriz;
ka disa ushqime, si: peshk, mish, qumësht;
ka shumë pak yndyrë.

Përsëritje dhe reflektim

Mbylle temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë veprimtarinë në rubrikën përsëritje dhe reflektim "Çfarë mësuam për njerëzit" në faqen 45 në librit e nxënësit.

Formim gjuhësor

Krijo një ekran të dukshëm, ku të paraqesësh përbërësit e një diete të shëndetshme. Siguro etiketa në ekran, në mënyre që nxënësit të familjarizohen me fjalët.

Veprimtari plotësuese

Organizo një vizitë në një fermë lokale, në mënyrë që nxënësit të mund të shohin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ku vjen ushqimi.

Çfarë kemi mësuar rreth njeriut


Çfarë kemi mësuar rreth njeriut

Të njëjtë, por të ndryshëm

Qarko përgjigjen që mendon se është e vërtetë.

1. A dukesh njëlloj si vëllai ose motra jote? Po Jo
2. A dukesh njëlloj si shoku ose shoqja e klasës? Po Jo
3. Me cilin ngjan më shumë?

me shokun ose shoqen time | me vëllain tim | me motrën time

Unë kuptoj që ne të gjithë jemi të njëjtë, por dhe të gjithë të ndryshëm.

Trupi ynë

Plotëso me fjalët e sakta.

dorën këmbën krahun shputën shpatullën gjuri

Gishtat e dorës sime janë të lidhur me d_____ time.
Dora ime është e lidhur me k_____ tim.
Krahu im është i lidhur me s h_____ time .
Gishtat e këmbës sime janë të lidhur me s h_____ time.
Shputa ime është e lidhur me k_____ time.
Këmba ime përthyhet te g j____ im.

Unë mund të them gjashtë pjesë të trupit.

Pesë shqisat

Përgjigjju pyetjeve. Zgjidh një nga shqisat e dhëna.

e shikimit e dëgjimit e prekjes e shijes e nuhatjes

1. Cilat janë dy shqisat që përdor më shumë për të gjetur rrugën për në shkollë?
_ SH _____ dhe _ _____
2. Cilat janë tri shqisat që të tregojnë se ushqimi është i keq dhe jo i sigurt për t'u ngrënë?
_ _____, _ _____ dhe _ _____

Unë mund t'i përmend të pesë shqisat.

Të ushqyerit e shëndetshëm

Cilat nga këto ushqime dhe pije janë shumë të nevojshme për dietën tonë? Qarko figurat e sakta.

Unë mund të përmend disa ushqime që përbëjnë një dietë të shëndetshme.

44 Ne njerëzit 45

Njohuri përgatitore

Qëllimi i kësaj pjesë është të nxitë nxënësit të përsëritin njohuritë e fituara në çdo temë mësimore të këaj tematikë. Çdo temë ka disa pyetje përforcuese, të cilave nxënësi duhet t'u përgjigjen. Këto janë pyetje që do të vlerësojnë njohuritë e nxënësit si dhe do të tregojnë të kuptuarin e temave nga ana e tij/saj.

Pas çdo grupi pyetjesh përforcuese ka disa formulime për përsëritje dhe reflektim, të cilave nxënësit duhet t'u përgjigjet.

Është e nevojshmë të lexosh formulimet dhe t'i ndihmosh nxënësit të plotësojnë rrethin e vetëvlerësimit, për të parë kështu se sa të sigurtë janë ata për njohuritë e fituara në temën mësimore.

Në klasën e parë nxënësit mund të ngjyrosin një fytyrë të qeshur apo të trishtuar për të treguar nivelin e tyre të sigurisë ose mund të vënë një shenjë vlerësimi, si p.sh. shenjën V.

Është e rëndësishme që nxënësit të tregojnë pjesët, në të cilat ata nuk ndjehen të sigurtë. Ky informacion është shumë i rëndësishëm për mësuesin dhe mundëson që të ofrosh ndihmën e nevojshme në vlerësimin përmbledhës (rubrika Vlerësimi i përmbledhës) në fund të tematikës.

Përsëritje dhe reflektim

Të njëjtë, por të ndryshëm

Qarko përgjigjen që mendon se është e vërtetë.

Disa nxënës mund të mos kenë motra dhe vellezër. Kërkoju atyre t'u përgjigjen pyetjeve 2 dhe 3 për një mik apo kushëri, i cili ka vëllezër dhe motra.

Merr përgjigjet nga klasa: kërkoju nxënësve të ngrenë dorën lart nëse ata i përgjigjen "shok" pyetjes 3. Pastaj bëj të njëjtën gjë për "vëlla" dhe për "motër".

> ***Përgjigje**:*
> *1. Po ose jo*
> *2. Po ose jo*
> *3. Vëllai im/motra ime.*

Përdor përgjigjet e nxënësve për të treguar me fjalë të thjeshta çfarë ne shohim më të ngjashme tek pjestarët e familjes dhe që ngjashmëritë rriten duke u rritur afërsia e marrëdhënie familjare.

Pyet nxënësit nëse ka binjakë në klasë ose në shkollë. Bëj pyetje për të dalë tek fakti se edhe binjakët identikë janë pak të ndryshëm.

Udhëzo nxënësit të nxjerrin përfundimin: *Ne të gjithë kemi të njëjtat karakteristika, por askush nuk është egzaktësisht i njëjtë me dikë tjetër.*

Trupi ynë

Plotëso me fjalët e sakta.

Shkruaj fjalët kyçe në tabelë (gisht, dorë, krah, shpatull, gishtat e këmbës, shputa e këmbës, këmbë, gjuri) që nxënësit të plotësojnë fjalitë.

Lexo fjalitë me nxënësit. Duke lexuar, thekso çdo fjalë kyçe dhe pjesët e trupit tek vetja yte. Kërkoju nxënësve të shkruajnë përgjigjet e tyre në librin e nxënësit.

Si një strofë, këndoi fjalitë me nxënësit me një tonalitet të ulët. Përsërite këtë disa herë. "Bëni qejf".

> ***Përgjigje**: Gishtat e dorës sime janë të lidhur me <u>dorën</u> time.*
> *Dora ime është e lidhur me <u>krahun</u> tim.*
> *Krahu im është i lidhur me <u>shpatullën</u> time.*
> *Gishtat e këmbës sime janë të lidhur me <u>shputën</u> time.*
> *Shputa e këmbës sime është e lidhur me <u>këmbën</u> time.*
> *Këmba ime përthyhet tek <u>gjuri</u> im.*

Pesë shqisat

Përgjigju pyetjeve. Zgjidh një nga shqisat e dhëna.

Kërkoju nxënësve të imagjinojnë sikur janë duke shkuar në shkollë. Pyeti ata se cilat shqisa i ndihmojnë për të gjetur rrugën e duhur. Nxiti ata të mendojnë rreth asaj që dëgjojnë dhe shikojnë rrugës për në shkollë.

Pastaj, kërkoju nxënësve të imagjinojnë një pjatë me ushqim të shijshëm përpara tyre. Pyeti ata:

- Si ju duket ushqimi? Çfarë arome ka? Çfarë shije ka?

Pastaj kërkoju atyre që të imagjinojnë sikur ushqimi është i keq; bëj të njëjtat pyetje.

Bini dakort me të gjitha përgjigjet e pyetjeve dhe kërkoju nxënësve t'i shkruajnë përgjigjet e tyre në librin e nxënësit.

***Përgjigje**:*

1. Shqisa e shikimit dhe e dëgjimit.

2. Shqisa e shikimit, e nuhatjes dhe e shijes.

Zgjero me tej të mësuarit e nxënësve duke u treguar atyre që qindra vjet me parë të jetuarit ishte shumë më problematike se sa është sot. Pyet nxënësit:

- Si i kanë ndihmuar shqisat më përpara njerëzit për tu mbajtur gjallë?

***Përgjigje e mundshme:** Duke dëgjuar kafshët e rrezikshme. Duke parë kafshë për t'i gjuajtur më pas për ushqim. Duke njohur ushqimet me anë të shijimit.*

Tregonju që shqisat nuk ishin vetëm për të eksploruar botën, por për t'u mbajtur gjallë.

Të ushqyerite shëndetshëm

Cilat nga këto ushqime dhe pije janë të nevojshme për dietën tonë? Qarko figurat e sakta.

Sqaro fëmijët për nevojat ushqimore që ka njeriu. Pyeti ata për ushqimet me të cilat ushqehen, çfarë këshillash u japin prindërit. Nxirr në pah ushqimet e nevojshme për rritje, për energji etj.

Kërkoju nxënësve të qarkojnë figurat e duhura.

Vlerësimi përmbledhës

Formulimet për përsëritje dhe reflektim në librin e nxënësit janë një pikënisje e përkryer kur diskutohet për përparimin individual të çdo nxënësi. Ky informacion mund të përdoret gjithashtu për të krijuar një raport për çdo nxënës në fund të vitit shkollor.

Ai gjithashtu mund të jetë i dobishëm për të mbajtur një regjistër (vlerësimi) për të gjithë klasën për nivelin e përgjithshëm të sigurisë duke identifikuar çfarë mund të kenë nevojë të rishikohet më vonë (shih një shembull në tabelën e mëposhtme).

Formulimi për përsëritje dhe reflektim	Shumë i/e sigurt	Jo aq i/e sigurt	Jo i/e sigurt

Kjo analizë (apo ky feedback) mund të përdoret më pas për të formuar një program përmirësimi (program rehabilitimi), i cili do të shërbejë për të ndihmuar nxënësit që të përmirësohen në të ardhmen.

Thjesht mbaj dhe ruaj regjistrimin e të dhënave dhe analizën e vetëvlerësimeve të nxënësve.

Kërkohet një përshtypje e përgjithshme e vetëvlerësimit të klasës, jo një regjistrim i vlerësimit individual të nxënësve (të dhëna individuale).
Kjo është gjithçka që të duhet. P.sh.: pesëdhjetë përqind e klasës nuk ishin të sigurtë në lidhje me ...

4 Larmia e materialeve

Në këtë tematikë nxënësit:

- Përdorin shqisat për të eksploruar dhe biseduar rreth materialeve të ndryshme;
- Identifikojnë karakteristikat e materialeve të ndryshme;
- Njohin dhe emërtojnë materialet që ndeshin në jetën e përditshme;
- Ndajnë sendet në grupe bazuar në vetitë e materialeve të tyre .

Njohuri përgatitore

Qëllimi i kësa tematike është që nxënësit të njihen me materialet: çfarë janë dhe si përdoren ato. Nxënësit krijojnë mendimin në lidhje se me çfarë materialesh përbëhen sendet (mund të përdorim edhe fjalën trup). Ata parashikojnë me anë të prekjes se çfarë sendesh janë si dhe përbërësit e tyre. Më tej gjykojnë se sendet që përdoren për të njëjtin qëllim mund të përbehen nga materiale të ndryshme. Vetitë e materialeve janë paraqitur thjeshtë me anë të fjalëve, figurave dhe vëzhgimeve. Nxënësit mësojnë të ndajnë materialet në grupe me anë të të prekurit ose të parit. Ata japin mendimin se pse i kanë grupuar sendet në atë mënyrë. Nxënësit shqyrtojnë karakteristikat e materialeve të ndryshme duke përdorur shqisat e tyre pamore dhe të të prekurit. Ata mësojnë lidhur me vetitë e materialeve, të tilla si e fortë, e butë, e ashpër apo e lëmuar, mësojnë të identifikojë vetitë e sendeve të ndryshme. Ata mendojnë se pse janë përdorur materiale me veti të veçanta për qëllime të ndryshme. Nxënësit vëzhgojnë materialet më të mira të papërshkueshme nga uji. Për të filluar njohjen, ata parashikojnë se çfarë do të ndodhë kur fusin materialet në ujë. Ata bëjnë vëzhgime në intervale kohe prej pesë minutash. Nxënësit nxiten të njohin dhe të emërtojnë materiale që ndeshin ne jetën e përditshme. Metalet janë paraqitur si materiale tepër të rëndësishme. Nxënësit listojnë disa nga përdorimet e shumta të metaleve dhe i lidhin ato me vetitë të tyre. Ata demostrojnë njohuritë e tyre se si i njohin metalet duke identifikuar të gjitha sendet metalike që ndodhen në dhomë. Ata gjithashtu nxiten që të identifikojnë emrin e secilit send dhe se si përdoret sendi metalik. Jo metalet paraqiten si çdo material që nuk është metal. Nxënësit krahasojnë vetitë e metaleve dhe jo-metaleve. Ata pastaj mund të kryejnë një studim të sendeve që ndodhen përrreth shkollës, duke krahasuar materialet e tyre kampion me sendet e tjera. Në temën e fundit nxënësit mësojnë të grupojnë sende të ndryshme sipas vetive të materialeve prej të cilëve ato përbëhen.

Aftësitë e hulumtimit shkencor

Gjatë të gjithë kësaj tematike nxënësit do të kenë mundësi të kryejnë vëzhgime me qëllim që të grupojnë materialet dhe t'i provojnë vetitë e tyre. Nxënësit nxiten të kryejnë dhe të regjistrojnë vëzhgime kur studiojnë një llojshmëri materialesh dhe të bëjnë krahasimin e metaleve dhe jo-metaleve. Ata gjithashtu duhet të zbatojnë këto njohuri që të bëjnë lidhjen ndërmjet vetive të metaleve me përdorimet e tyre.

Materiale burimore

Fletë letre A4, shirit ngjitës ose ngjitës, libra të rëndë (ose materiale të tjera që përdorni me nxënësit).

Fjalë kyçe

beze	qelq	metal
fije elastike	letër	gomë plastike
fije jo-elastike		material druri

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

përzgjedh gjej thuaj
trego shkëmbe informacion më të tjerët

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- Të përdorin shqisat për të zbuluar më tepër rreth materialeve;
- Të gjejnë si duken dhe ndjehen materialet;
- Të jenë të aftë të emërtojnë disa materiale;
- Të jenë në gjendje të grupojë materialet në grupe të ndryshme;
- Të fillojnë të njohin fjalët kyçe në tabelën e fjalëve.

Kërkoju nxënësve të shikojnë figurat e sendeve në faqet hyrëse dhe pyet: Sa sende mund të përdorësh? Për çfarë përdoren sendet? A mund të emërtosh ndonjë nga materialet në figurë? Përdor pyetje për të filluar një diskutim në lidhje me materialet.

Fakt nteresant

Referoju faktit interesant. Thuaju nxënësve që ata të përpiqen ta provojnë vetë. Kërkoju nxënësve të punojnë në grupe të vogla dhe jepu secilit grup 12 fletë letre format A4. Tregoju nxënësve se si të mbështjellin një fletë letre dhe sesi ta kapin atë që të ruajnë formën. Tregoju si të grupojnë rulonët që të bëjnë një bllok solid. Pastaj ata provojnë qëndrueshmërinë e kështjellës duke vendosur libra të rëndë mbi të.

Përfytyro sikur po mban në dorë këtë lodër. Çfarë ndjesie të jep lodra?

Përdor këto pyetje dhe të tjera për të gjetur fjalë të ndryshme që përshkruajnë trupin. Shto fjalë të reja në "Tabelën e fjalëve" të varur në mur.

Përgjigje të mundshme: *lodër e butë, e fortë , e lëmuar, me qime, poroze.*

Përshkruaj këtë lodër. Çfarë ndjesie të jep ajo?

Përgjigje të mundshme: *makinë - lodër, e fortë, e lëmuar, rrethore.*

Shiko filxhanët. A mund të dallosh ndonjë ndryshim?

Kërkoju nxënësve të shikojnë tri fotot e filxhanëve. Diskuto faktin që sendet që kryejnë të njëjtën funksion kur i shikon apo i prek me dorë mund të duken apo ndihen ndryshe.

Përgjigje të mundshme: *Njëra shkëlqen dhe ngjan si metal. Njëra është e vjetër dhe tjetra duket si filxhan i ri normal.*

Formim gjuhësor

Fillo me fjalët e reja dhe krijo një "Tabelë"; vare në mur me qëllim që të gjithë nxënësit ta shikojnë dhe të familjarizohen me to; kur është e mundur vendos figura në Tabelë pranë emrave. Në këtë fazë ti mund të bësh të njohur materialet kryesore dhe të tregosh me shembuj vetitë e tyre. Kontrollo nëse nxënësit i kuptojnë ndryshimet midis "e lëmuar" me "e ashpër" dhe "i ndritshëm" me "pak i ndritshëm". Demonstro këto veti duke ekspozuar modele materialesh që i kanë këto veti dhe shto këto fjalë në "Tabelën e fjalëve" të varur në mur. Libri i nxënësit gjithashtu ka një rubrikë "Shkruani fjalorin" ku nxënësit duhet rregullisht të hedhin përkufizimet e reja, ndërkohë që përparojnë me njohuritë e reja të lëndës. Për të përforcuar familiaritetin me fjalët e reja, kërkoju nxënësve t'i thonë fjalët më zë, pastaj t'i shkruajnë ato.

Veprimtari plotësuese

Ky mësim hyrës mund të zgjerohet duke i pyetur nxënësit si janë ndërtuar sendet e tjera që ndeshim në jetën e përditshme.

1. Kërkoju nxënësve të studiojnë historinë e ndërtimit të lodrës, si kanë ndryshuar materialet me kalimin e kohës?
2. Kërkoju nxënësve të listojnë disa nga materialet e tjera që përdoren për të ndërtuar lodra.

Materiale të ndryshme

Përdor shqisat për të njohur dhe biseduar rreth materialeve të ndryshme.



Njohuri përgatitore

Nxënësit rrisin nivelin paraprak duke kaluar në diskutime rreth asaj se si ato mund të identifikojnë sendet e forta dhe të buta duke përdorur ndjesinë e të prekurit. Ata diskutojnë se si mund të identifikojnë një mollë nga një grumbull sendesh të të njëjtit lloj dhe ta vëzhgojnë këtë duke përdorur ndjesinë e prekjes në një çantë mbushur me sende (trupa) të ndryshme. Ndërsa plotësojnë detyrat në rubrikën "përfundimi i temës" nxënësit rishqyrtojnë njohuritë e tyre për vetitë e materialeve .

Materiale burimore

Çantë e mbushur me sende të të njëjtit lloj, mbulesë për ndalimin e të parit, lloje të ndryshme sendesh të lëmuara dhe të ashpra.

Fjalë kyçe

materiale

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

zgjedh krahaso vëzhgo

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- Të përdorin shqisat për të identifikuar sendet;
- Të studiojnë materiale të ndryshme.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të mësojnë rreth vetive të materialeve të ndryshme.

Diskuto që duke përdorur shqisat ne zbulojmë se si janë trupat. Përfshi nxënësit në një diskutim ku ata të shprehin mendimet e tyre se çfarë janë shqisat. Përdor fotot e një syri dhe të një veshi që ndodhen në librin i nxënësit. Drejto pyetje për t'i ndihmuar nxënësit të kuptojnë se shqisat e të parit (pamore) dhe të dëgjuarit (dëgjimore) janë dy shqisa që ne përdorim për të zbuluar se si janë materialet.

Vështro figurat e mëposhtme. Sa sende shikon?

Kërkoju nxënësve të punojnë në grupe dyshe dhe të shikojnë figurat e trupave të ndryshëm të përbërë nga materiale të ngurta dhe të buta.

***Përgjigje**: Shtatë sende.*

Kontrollo nëse të gjithë nxënësit iu përgjigjen pyetjes saktë.

Përfytyro sikur ndodhesh në një dhomë të errët. Si mund ta kuptosh që je duke prekur mollën dhe jo tullumbacën?

Nëpërmjet diskutimit me nxënësit nxirr që ne i zbulojmë sendet duke i parë dhe i ndjerë ato. Pastaj pyet:

- A mund të shikosh sendet në një dhomë të errët? *Jo.*
- Çfarë shqisash të tjera përdorim për të zbuluar mollën? *Prekjen/ nuhatjen (duke marrë aromë).*

Nëpërmjet diskutimit me nxënësit nxirr që kur i prekim sendet disa janë të fortë dhe disa të butë.

***Përgjigje e mundshme:** Përdor shqisën e të prekurit.*

Shiko përsëri figurat. Qarko përgjigjen e saktë.

Kërkoju nxënësve të shikojnë përsëri figurat dhe të mendojnë se çfarë ndjesie ka secili nga sendet. Diskuto më nxënësit përgjigjet e pyetjeve në librin e nxënësit, përpara se të qarkosh përgjigjet e tyre.

Cilat sende ndihen të butë?

***Përgjigje**: Lëmshi i pambukut, tullumbaci.*

Cilat sende ndihen të fortë?

***Përgjigje**: luga e drurit, molla, guri, qiriu.*

Cilat sende ndihen të butë dhe të fortë?

***Përgjigje**: Furça e lyerjes me bojë.*

Vëzhgim: Çfarë materialesh mund të zbulosh?

Qëllimi i këtij vëzhgimi është t'i lejosh nxënësit që të identifikojnë materiale të ndryshme me anë të prekjes. Kjo do t'i ndihmojë ata të praktikojnë aftësitë shkencore të kërkimit për identifikim, duke përdorur një veti të veçantë të përcaktuar. Do të duhen: një çantë që përmban sende të përbëra nga materiale të ndryshme (mund të përdorni një çantë prej leckë), p.sh. mprehëse lapsi, fshirëse gome, lapsa, lodra me makina, lodra të buta, monedhë leku, gur apo sfungjer). Shpjego që sendet përbëhen nga materiale të ndryshme, disa janë të butë, të tjerët janë të fortë. Disa materiale janë të lëmuara. Disa janë të ashpra.

Ndërkohë që shpreh vetitë, për të mbështetur formimin gjuhësor shoqëroi me shembuj.

1 Fut dorën brenda në çantën me sende të ndryshme.

- Organizo klasën në grupe me nga 3-4 nxënës dhe jepu secilit grup nga një çantë me sende të përbëra nga materiale të ndryshme.
- Një nga nxënësit duhet t'i mbajë sytë mbyllur. Të tjerë do të udhëzojnë dorën e nxënësit që të ndjejë materialet që ndodhen në çantë.

Disa nxënësve nuk u pëlqen errësira ose t'ua lidhësh sytë me shami. Këta nxënës mund të marrin pjesë në këtë veprimtari duke u kërkuar të mbajnë sytë të mbyllur.

2 Mos shiko brenda; vetëm prek; ndieji sendet.

- Shpjegoju që ke vendosur disa sende në çantë. Nxënësit duhet të jenë vetë zbulues. Kërkoju atyre t'i emërtojnë sendet e gjetura.
- Thuaju që nxënësit e secilin grup do ta provojnë me radhë. Ata do të vazhdojnë ushtrimin deri kur të arrijnë të zbulojnë secilin send në çantë.
- Kërkoi nxënësit të parë të fusë dorën në çantë dhe të prekë një send. Ai/ajo duhet ta prekë lehtë atë dhe "me gishta" ta përshkruajë.

Çfarë mund të gjesh?

Thuaju nxënësve të përdorin pyetjet e mëposhtme që i ndihmojnë ata për të vendosur se çfarë është:

- A është i fortë apo i butë?
- A është i lëmuar apo i ashpër?

Nxënësit duhet t'i tregojnë grupit të tyre se çfarë sendi mendojnë se është dhe pastaj ta nxjerrin ata nga çanta. Grupi vendos nëse përcaktimi është i saktë. Shpjegoi klasës se ata kanë përdorur një nga shqisat e tyre, prekjen. Kjo shqisë i ndihmon të zbulojnë se cilat materiale janë të fortë dhe cilat janë të lëmuar.

Përgjigje të mundshme: *qiri, tabaka, gurë, hapse vrimash, tullumbac, lugë druri, furçë boje, mollë, mbulesë tavoline prej beze etj.*

Vlerësimi i njohurive

Qarko fjalën e saktë.

Përdor pyetjen në rubrikën në fund të mësimit për të përforcuar temën dhe për të vlerësuar njohuritë e nxënësve për mësimin.

Përgjigje*: Kjo lodër është e butë.*

Përsëritje dhe përforcim njohurish

Mbylle temën duke u kërkuar të plotësojnë veprimtarinë rishiko dhe reflekto në faqen 56 të librit të nxënësit.

Formim gjuhësor

Përdor pamje kur thua fjalë të reja të rëndësishme. Vëzhgimet në mësimin pasardhës do të ndihmojë të përforcosh njohuritë e nxënësit rreth fjalëve kyçe. Reforoju përsëri rubrikës "Fjalë kyçe" dhe pamjeve gjatë të gjithë procesit të mësimit dhe nxënies në vijim. Fjalët më të rëndësishme në këtë temë janë emrat e materialeve që nxënësit do të shqyrtojnë. Në përgatitjen për mësimin në vijim, kur u tregon fjalë kyçe, të tilla si letër, qelq etj., shpjegoju që të gjitha këto janë materiale.

Vetitë e materialeve?

Zbulon se si duken dhe si ndihen disa materiale.



Njohuri përgatitore

Në këtë mësim për të zbuluar materialet nxënësit përdorin shqisat e të prekurit dhe të parit. Nxënësit mësojnë rreth vetive të materialeve, të tilla si e fortë, e butë, e lëmuar dhe e ashpër. Ata vëzhgojnë një varg sendesh duke bërë identifikimin e secilës veti. Nxënësit fillojnë të mendojnë pse materiale me vlera të veçanta përdoren për qëllime të ndryshme.

Materiale burimore

Një llojshmëri sendesh të vogla që demonstrojnë materiale të ndryshme dhe vetitë e tyre, një tabelë rezultatesh.

Fjalë kyçe

qelq metal

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

Zbulo

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- Të kuptojnë që materialet kanë vlera të ndryshme;
- Të zbulojnë çfarë vetish kanë disa sende.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë më shumë veti të materialeve të ndryshme.

Fillo mësimin me një lojë, Përgatit një tabaka më rreth 12 sende të të forta dhe të buta dhe mbuloi me një mbulesë. Hiq mbulesën dhe jepu nxënësve 30 sekonda kohë të vëzhgojnë sendet, pastaj vendose përsëri mbulesën. Skuadrat shkruajnë dy lista (të forta dhe të buta). Fiton skuadra që shkruan listën më të gjatë të sendeve.

Lidh secilën tullumbace me sendin përkatës.

Shpjego që vetitë tregojnë se si duken apo ndihen materialet. Thekso që materialet kanë shume veti të ndryshme. Kërkoju nxënësve të shikojnë vetitë në figurën-tullumbace dhe të bëjnë përputhjen e secilës veti me sendin e duhur.

Kushto kujdes të veçantë fjalës "transparente". Fjala e duhur është "e tejdukshme", por transparente është më e lehtë për këtë grup moshe. Tregoju me gisht xhamin në dritare apo sende të tjera prej qelqi që ta ilustrosh këtë praktikisht.

Përgjigje:

a) = (kukull) e butë

b) = (shkallë) e fortë

c) = (bllok shënimesh) e ashpër

d) = (guralecë) i lëmuar

e) = (gur i çmuar) i shndritshëm

f) = (kuti kartoni) jo e lëmuar

g) = (dritare) e tejdukshme

h)= (urë) e fortë.

Lexo me nxënësit tekstin në krye të faqes 50 për të rishikuar se çfarë është vetia.

Vëzhgim: Si është sendi?

Qëllimi i kësaj veprimtarie është të nxisë nxënësit t'i grupojnë materialet sipas vetive të tyre. Ata do të praktikojnë shprehitë e vëzhgimit dhe të klasifikimit /grupimit për të realizuar veprimtarinë kërkimore shkencore.

Të nevojiten: një sërë trupash të tillë si mprehëse lapsash, gomë, lapsa, gurë, sfungjer, vizore plastike, monedha, makinë - lodër, lodra të buta dhe qese plastmasi.

1 Gjej objekte të ndryshme në klasë.

- Shpjegoju nxënësve që ato do të veprojnë si gjurmues (agjent) dhe do të vëzhgojnë disa materiale. Ata do të punojnë në grupe me tre ose katër nxënës.

2 Klasifikoji ato në grupe.

Si është secili prej objekteve?

Kërkoju nxënësve të shikojnë me vëmendje secilin send. Pyeti:

- A është i fortë apo i butë?
- A ju duket i ashpër apo i lëmuar?
- A është e përthyeshme?

Përgjigje e mundshme: *Guri është i fortë.*

3 Mbaj shënim në fletore çfarë gjen.

- Vizato një tabelë në dërrasën e zezë dhe tregoju nxënësve si ta plotësojnë atë duke përdorur shenjat X dhe V.
- Kërkoju nxënësve të kopjojnë tabelën dhe ta plotësojnë atë për secilin trup që vëzhguan.

Trupi	I fortë	I butë	Me shkëlqim	I ashpër	I përkulshëm	I tejdukshëm
Vizore plastike	✓	✘	✓	✘	✓	✘

A mund të futet ndonjë nga sendet në më shumë se një grup?

Thekso që materialet mund të kenë më shumë se një veti, p.sh. një material mund të jetë me shkëlqim edhe i butë.

Përgjigje e mundshme: *Po.*

Cili send është më i fortë?

Cili send është më me shkëlqim?

Cili send është më i butë?

Kërkoju nxënësve t'u përgjigjen këtyre pyetjeve në librin e nxënësit.

Fakt interesant

Referoju fatit interesant për të theksuar më tej që materialet, si diamanti, kanë disa veti.

Vlerësimi i njohurive

Plotëso hapsirat boshe me fjalët e dhëna.

Përdor këtë veprimtari për të përforcuar temën dhe për të matur rezultatet e të nxënit.

Përgjigje: *Disa materiale mund të kenë më shumë se një veti. Një material mund të jetë me shkëlqim dhe i fortë.*

Përsëritje dhe përforcim njohurish

Realizo temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë rubrikën për veprimtari të përsëritjes dhe reflektimit në faqen 56 të librit të nxënësit. Shiko gjithashtu shënimet e mësuesit.

Formim gjuhësor

Përdor "tullumbacet" si fjalë në faqen 50 për të ilustruar kuptimet e fjalëve. Vazhdo të shtosh fjalët dhe figurat në "Tabelën e fjalëve". Referoju vazhdimisht figurave formuese për të përforcuar kuptimet dhe drejto pyetje "për kontrollin e koncepteve". Përdor rubrikën "Shkruaj fjalët e reja" për të gjetur përkufizimet e fjalëve dhe për të bërë lidhjen e tyre me figurat.

Printo emra vetish në letra ose karton me format A4. Vendosi ato përmbys mbi tryezën e mësuesit. Ndaje klasën në dy skuadra. Një nxënës e merr kartën dhe përpiqet t'ua bëjë shpjegimin e saj pjesëtarëve të tjerë të skuadrës, pa përdorur fjalën përkatëse. Nëse skuadra nxjerr kuptimin e fjalës ata marrin një pikë. Pastaj e ka radhën skuadra tjetër. Vazhdo deri kur të përfundojnë të gjitha fjalët.

Veprimtari plotësuese

1. Kërkoju nxënësve të shikojnë rezultatet që kanë shënuar nga vëzhgimi. Pyeti ata:

- Çfarë materiali do të përdorësh për të bërë një lodër për një fëmijë?

Përgjigjet e mundshme: *të butë, të përthyeshëm, të papërshkueshme nga uji.*

- Çfarë materiali do të përdorësh për të bërë shkallët e një ndërtese të re?

Përgjigjet e mundshme: *të fortë, të ashpër.*

Përdorimi i materialeve

Zbulon për çfarë mund të përdoren materialet.



Njohuri përgatitore

Mësimi fillon duke i paraqitur nxënësve sende të përbëra nga materiale të papërshkueshme nga uji, si një veti e këtyre materialeve. Pastaj ata vëzhgojnë materialet më të mira të papërshkueshme të ujit. Fillimisht ata hamendësojnë se çfarë do të ndodhë kur ata fusin materiale të ndryshme në ujë. Ata kryejnë vëzhgime në intervale kohe pesë minutëshe.

Materiale burimore

Modele materialesh të papërshkueshme nga uji; pambuk; çanta plastike boshe, karton, letër, rroba, matës kohe, shirit ad'hesive/ngjitës dekorativ.

Fjalë kyçe

Letër plastmas

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

përzgjedh hamendëso parashiko

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- Të flasin rreth vlerave të ndryshme të materialeve;
- Të vëzhgojnë se cilat materiale janë të papërshkueshme nga uji.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të mësojnë që disa materiale janë elastikë.

Çfarë materiali ke në shtëpi që është i papërshkueshëm nga uji?

Kërkoju nxënësve të shikojnë në figurë dhe etiketë. Kërkoju të diskutojnë se si njeriu nuk laget nga shiu. A mund të mendojnë për disa materiale të përshtatshme për të ndërtuar një tendë? Pyeti ata për disa materiale që nuk janë të përshtatshme.

Përgjigje të mundshme: *çadër, pelerinë / xhakete kundër shiut, çizme, legen plastik etj.*

Vëzhgim: Cili është materiali më i mirë për të mbajtur pambukun e thatë?

Qëllimi i këtij vëzhgimi është që nxënësit t'i provojnë materialet se cili është më i papërshkueshëm nga uji. Kjo do t'i ndihmojë nxënësit të praktikojnë aftësitë shkencore të kërkimit për të kryer një vëzhgim, të vëzhgojnë rezultatet dhe të përzgjedhin materialin më të mirë.

Ju duhet të keni: pambuk, një legen të madh me ujë, qese plastmasi, karton, letër, pëlhurë, shirit ngjitës dekorativ, kronometër ose orë. Shpjego që nxënësit do t'i vëzhgojnë vetë materialet e papërshkueshme nga uji.

1 Mbështill pambuk me materiale të ndyshme.

- Ndaji nxënësit në dyshe. Shpjegoju që do të mbështjellin pambuk në materiale të ndryshme: qese plastmasi, karton, letër, dhe copë pëlhure. Pastaj do t'i futin në ujë për të provuar se cilat materiale janë të papërshkueshme nga uji. Trego praktikisht se si ta mbështjellin pambukun.
- Jepu secilit grup materialet që u duhen për të kryer vëzhgimin.
- Krijo një tabelë në dërrasë të zezë ku nxënësit të shënojnë rezultatet (shih shembullin në librin e nxënësit ose tabelën e plotësuar në faqen tjetër). Nxënësit duhet të kopjojnë tabelën nga dërrasa dhe ta plotësojnë atë, ndërsa kryejnë vëzhgimin. Përndryshe jepua të gatshme.

2 Pastaj fut secilin material në ujë.

Udhëzoi nxënësit të kenë kujdes kur të përdorin ujin. Kujtoju që të mos vijnë vërdallë se mund të rrëshqasin në ujin e derdhur në dysheme.

Shpjego që fillimisht nxënësit duhet të thonë se çfarë mendojnë se mund të ndodhë. Kërkoju atyre të diskutojnë me prindërit se cili material mund të jetë i papërshkueshëm nga uji. Shpjegoju që kjo quhet të bërit një parashikim.

Shëno materialin që mendon se është më i papërshkueshëm.

Kërkoju nxënësve ta plotësojnë këtë veprimtari në librin e nxënësit përpara së të fillojnë me kryerjen e vëzhgimit.

Përgjigje e mundshme: *Plastmasi.*

Cili material e mban pambukut të thatë për një kohë më të gjatë?

Diskuto pyetjen me nxënësit. Kërkoju grupeve të nxënësve ta kontrollojnë pambukun pas 5 minutave, 10 minutave dhe pastaj pas 15 minutave. Tregoju atyre si ta masin kohën. Ose të mund të caktosh një kohë për kontroll. Kjo proçedurë do t'u tregojë nxënësve se cili material e mbajti për një kohë më të gjatë të thatë lëmshin e pambukut.

Përgjigje e mundshme: *Plastmasi.*

Kopjo dhe plotëso tabelën. Përdor fletoren e shënimeve.

Kërkoju nxënësve të plotësojnë tabelën e rezultateve në fletoren e shënimeve për punën kërkimore. Për secilin material ata vendosin shenjën V nëse lëmshi i pambukut është i thatë dhe X nëse është i lagur pas 5, 10 dhe 15 minutave. Drejtoi të punojnë në grupe dyshe për të regjistruar të dhënat. Ti duhet ta mbështetësh këtë veprimtari duke kontrolluar secilin grup. Nëse dëshiron, bëj sistemimin e rezultateve si një veprimtari e tërë klasës dhe shëno rezultatet në dërrasën e zezë. Të gjithë nxënësit pastaj duhet ta kopjojnë tabelën në fletoren pune për Veprimtari Kërkimore.

Përgjigje*:*

A është pambuku i thatë?				
Koha	**Letër**	**Karton**	**Plastmas**	**Rrobë**
5 minuta	✘	✓	✓	✘
10 minuta	✘	✓	✓	✘
15 minuta	✘	✘	✓	✘

Çfarë zbulove? Plotëso vendet bosh.

Në fund të vëzhgimit kërkoju nxënësve të plotësojnë fjalitë duke përdorur fjalët e dhëna. Kjo do t' i ndihmojë ata të konsolidojnë çfarë ata kanë mësuar nga vëzhgimet. Realizimi i përmbledhjes së një pune kërkimore është një aftësi e mirë e kërkimit shkencor dhe do të mbështesë fazën e nxjerrjes së përfundimeve nga vëzhgimet.

Përgjigje*: Përdora materiale të ndryshme për të mbështjellë pambukun. Gjithçka tjetër ishte e njëjtë. Zbulova se qesja plastike ishte materiali më i papërshkueshëm nga uji.*

Formim gjuhësor

Vazhdo të bësh lidhjen e fjalëve me figurat, duke përdorur "Tabelën e fjalëve" dhe shembuj trupash të papërshkueshëm nga uji.

Gjithashtu kërkoju nxënësve të plotësojnë fjalorin me fjalët kyçe dhe përkufizimet e tyre. Bëj lojëra me përputhje të figurave dhe fjalëve që të ndihmosh në përforcimin e njohurive të nxëna nga nxënësit. Ti mund t'u japësh karta letre me figura dhe me fjalë dhe ta fshehësh letrën përputhëse në vende të ndryshme brenda klasës. Nxënësit mund të kërkojnë për fjalën ose figurën që përputhet me atë që kanë në dorë.

Veprimtari plotësuese

Nxënësit mund t**ë** kërkojnë për përdorimet e materialeve të papërshkueshme nga uji, p.sh. në çanta, çadra ose tenda.

Klasifikimi i materialeve

Emërton materiale të zakonshme.



Njohuri përgatitore

Në këtë mësim nxënësit fillojnë duke bërë përsëritje të punës nga mësimi i fundit; ata japin shembuj se për çfarë i kanë përdorur sendet metalike. Pastaj trajto jometalet, të paraqitura si çfarëdo materiali që nuk është një metal. Nxënësit bëjnë krahasimin e jometaleve me metalet. Ata mund kryejnë një studim të godinës se shkollës, duke përputhur materialet e tyre provë/model me materialet e tjera të ngjashme që gjejnë në mjedisin e shkollës.

Materiale burimore

Mostra të vogla të një larmie materialesh, duke përfshirë materiale plastike, metalike, qelqi (jo të mprehtë), druri dhe pëlhure.

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- Të shqyrtojnë se si disa materiale janë metale dhe disa janë jometale;
- grupojnë materialet në metale dhe jometale.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të rishikojnë dhe do të arsyetojnë mbi atë që kanë mësuar në këtë tematikë, se si disa materiale janë të përshtatshme për përdorime të caktuara.

Kërkojuni nxënësve të shikojnë fotot e materialeve të ndryshme në librin e nxënësit dhe të lexojnë tekstin së bashku.

Shpjegoju nxënësve se, nëse një material nuk është një metal ne e quajmë atë një jometal. Disa jometale të zakonshme janë plastika, druri, qelqi, argjila, goma, guri dhe pëlhura. Drejto situata ndihmëse për të nxjerrë këtë fjalor nga nxënësit duke u treguar atyre sende të punuara nga këto materiale. Pas diskutimit shto fjalët në "Tabelën e fjalëve".

Për të renditur se çfarë nxënësit kanë mësuar tashmë në këtë mësim, pyeti ata:

- Si e bëjmë dallimin në mes të materialeve metalike dhe jometalike? Ne shikojmë vetitë e materialit.

Afisho tabelën më poshtë për klasën. Ajo liston vetitë e metaleve dhe jometaleve. Nxënësit do ta përdorin këtë informacion për të identifikuar metalet dhe jometalet. Informacioni është i thjeshtë për t'u përdorur nga nxënësit e vegjël, por vetitë e listuara duhet të konkretizohen për shumicën e metaleve ose jo-metaleve.

Metale	**Jometale**
Shumica janë të rëndë	Shumica janë të lehtë
Janë të fortë	Shumica janë të fortë
Capëzat e holla janë të përthyeshme	Copëzat e holla këputen lehtë
Mund të zgjaten në fije	Nuk mund të zgjaten në fije
Mund të farkëtohen	Thyhen nëse farkëtohen
Bëjnë tingull këmbues kur goditen	Nuk bëjnë tingull këmbues kur goditen

Tabela duket e komplikuar, por nëse ti i ndihmon nxënësit ta përdorin atë, ata do ta kuptojnë që është e dobishme. Kalo çdo rresht me kujdes.

Vëzhgim: Është metal apo jometal?

Qëllimi i këtij vëzhgimi është që nxënësit të aplikojnë njohuritë për materialet dhe vetitë e tyre për të identifikuar disa materiale brenda ndërtesës dhe oborrit të shkollës.

Kjo do t'i ndihmojë ata të praktikojnë aftësitë e veprimtarisë shkencore, vëzhgimit, identifikimit dhe klasifikimit.

Të duhen: mostra të vogla prej druri, plastike, qelqi (jo të mprehtë), metali, pëlhure.

Udhëzo nxënësit të kryejnë një punë kërkimore për materialet që mund të gjenden në mjedisin e jashtëm (oborr) të godinës së shkollës. Thuaju që ata duhet të kërkojnë disa materiale, ndërkohë që bëjnë një shëtitje rreth e rrotull godinës së shkollës. Mos harro të informosh edhe mësuesit e tjerë që po kryen një studim në mjedisin e jashtëm të shkollës.

1 Shiko sendin që të jep mësuesi.

- Organizo nxënësit në grupe dyshe dhe jepi çdo nxënësi një mostër të vogël të materialit.
- Sigurohu që t'u tregosh nxënësve se mostrat që kanë janë të përbëra nga materiale të zakonshme, kështu që nxënësit do të kenë më shumë mundësi për të gjetur më lehtë më shumë gjëra gjatë shëtitjes përreth godinës së shkollës.

A është metal apo jometal?

Dretoju nxënësve pyetje, si:

- Nëse materiali që keni gjetur është jometal, a është i përbërë nga material druri apo plastmasi?
- Cilat janë vetitë e tij? A është i fortë? A është i butë? A është i rëndë? Etj.

2 Tani kërko për sende që u gjenden përreth shkollës.

- Kërkoju nxënësve të përpiqen të gjejnë sa më shumë mostra të këtij materiali në mjedisin e jashtëm të godinës së shkollës.

3 Harto një listë me sendet që shikon.

- Kërkoju nxënësve të shënojnë sendet në fletore për veprimtari kërkimore. Ata mund të shënojnë emrin e secilit trup dhe vendin ku e kanë gjetur atë. Nëse e gjykon të arritshme, nxënësit mund ta bëjnë këtë në formë vizatimi, në vend që ta shkruajnë.
- Diskuto tabelën e vetive të metaleve dhe jometaleve. Ndihmo nxënësit të dallojnë se cilat përshkrime në tabelë përputhen me sendet që ata kanë gjetur.

Tregojua mësuesit dhe nxënësve në klasë rezultatet e tua.

Në fund të kërkimit kërkoju secilit grup që të tregojnë me radhë materialet që kanë gjetur.

Formim gjuhësor

Përdor tabelën e vetive të metaleve dhe jometaleve së bashku me figurat e jometaleve. Vazhdo t'u referohesh pamjeve dhe fjalëve në "Tabelën e fjalëve" ose përdor: Çfarë keni mësuar nga ky mësim. Përdor "Fjalorin shpjegues" për t'iu referuar përkufizimeve.

Shpjegoju nxënësve që në gjuhën shqipe fjala "jo" vëndoset para fjalës për të treguar të kundërtën e saj ose për ta mohuar atë.

Veprimtari plotësuese

1 Pyet nxënësit se cili material përdoret më shumë në botë (betoni). Nëse nuk e dinë, kërkoju të përpiqen që ta gjejnë. Përdorimi i internetit mund të jetë një burim për të gjetur përgjigjen e kërkuar, sidoqë mund të kërkohen edhe shume burime jo kryesore. Ti mund të përgatitësh disa burime të tilla të përshtatshme me qëllim që t'i mbështetësh nxënësit në realizimin e kësaj detyre (p.sh. tabela ose diagrame të thjeshta).

2 Kërkoju nxënësve që vëzhgojnë të gjithë materialet që ata ndeshin gjatë veprimtarisë së tyre ditore. Pyeti ata: Cilin material e keni ndeshur më shumë gjatë ditës? A ju bëri përshtypje? A ishte i njëjtë më materialin më të përdorshëm?

Mendo rreth… Kërkoju nxënësve të diskutojnë pyetjen me partnerin tjetër në grup (dyshe). Nxiti ata të përdorin vetitë e materialeve, për të cilat ata mësuan në këtë mësim, për të bërë krahasimin midis sendeve të përbërë nga materiale druri me ato plastike. Një përgjigje e pritshme nga nxënësit shpjegon që: druri ka vija të drejta dhe është më pak i lëmuar se sa plastika.

Çfarë kemi mësuar rreth larmisë së materialeve



Njohuri përgatitore

Qëllimi i kësaj pjesë është të nxitë nxënësit të përsëritin njohuritë e fituara në çdo temë mësimore të këaj tematikë. Çdo temë ka disa pyetje përforcuese, të cilave nxënësi duhet t'u përgjigjen. Këto janë pyetje që do të vlerësojnë njohuritë e nxënësit si dhe do të tregojnë të kuptuarin e temave nga ana e tij/saj.

Pas çdo grupi pyetjesh përforcuese ka disa formulime për përsëritje dhe reflektim, të cilave nxënësit duhet t'u përgjigjet.

Është e nevojshmë të lexosh formulimet dhe t'i ndihmosh nxënësit të plotësojnë rrethin e vetëvlerësimit, për të parë kështu se sa të sigurtë janë ata për njohuritë e fituara në temën mësimore.

Në klasën e parë nxënësit mund të ngjyrosin një fytyrë të qeshur apo të trishtuar për të treguar nivelin e tyre të sigurisë ose mund të vënë një shenjë vlerësimi, si p.sh. shenjën V.

Është e rëndësishme që nxënësit të tregojnë pjesët, në të cilat ata nuk ndjehen të sigurtë.
Ky informacion është shumë i rëndësishëm për mësuesin dhe mundëson që të ofrosh ndihmën e nevojshme në vlerësimin përmbledhës (rubrika Vlerësimi i përmbledhës) në fund të tematikës.

Përmbledhje përsëritje dhe arsyetim

Materiale të ndryshme

Shkruaj fjalët për të plotësuar fjalitë.

Pyet nxënësit:

- Cila është e kundërta e "nxehtë"? Ftohtë.

Përdor shembullin "nxehtë", dhe "ftohtë" për të prezantuar një rishqyrtim të çifteve të tjera të kundërta që përdoren për të përshkruar materialet: e fortë dhe e butë, e lëmuar dhe e ashpër. Tregoju nxënësve shembuj praktik të trupave në figura. Kërkoju që të përdorin shqisat e tyre për të përshkruar ato.

> ***Përgjigje:*** *Lodrat mund të jenë <u>të forta</u> ose <u>të buta</u>.*

Unë mund të përshkruaj materialet duke i shikuar ose duke i prekur ato.

Vetitë e materialeve?

Shkruaj fjalët për të plotësuar fjalitë.

Rishiko fjalët që janë përdorur për të përshkruar vetitë e materialeve që nxënësit kanë mësuar në këtë temë, duke përdorur veprimtarinë e përputhjes të plotësuar në faqen 50 dhe duke përdoruar shembuj praktik të materialeve me vlera të ndryshme. Nxit nxënësit të bëjnë krahasimin e materialeve duke drejtuar pyetje të tilla si: Cili material shkëlqen më shumë se të tjerat? Cili material është më i fortë se të tjerat. Etj.

> ***Përgjigje****: Disa sende duken <u>të rënda</u> disa <u>me shkëlqim</u>.*

Shto materialet dhe etiketat që përshkruajnë ato në tabelën e paraqitjes së mjeteve dhe materialeve. Krijo një ekspozitë në mur më titullin "Vetitë" me etiketa përshkruese, p.sh. "fortë", "shkëlqim", "pa shkëlqim", "përthyeshme" etj. Nxënësit mund të gjejnë apo të vizatojnë pikturat për të paraqitur secilën veti.

Përdorimi i materialeve

Kur bie shi unë vesh... Qarko figurën e saktë.

Kërkoju nxënësve që të rrethojnë figurën e duhur.

Klasifikimi i materialeve

Shiko këto materiale. Qarko ato që nuk janë metale.

Kujtoju nxënësve vëprimtarinë kërkimore që bënë në grup gjatë këtij mësimi. Pyeti ata:

- Çfarë mund të përdorni për ti ndarë këto trupa në grupe? *Me qarkim.*

Trego më gisht figurat në këtë veprimtari dhë kërkoju nxënësve që të emërtojnë sendet e treguara. Pyet ata se nga çfarë materiali është bërë secili trup, dhe se çfarë vetish i bëjnë këta materiale të përshtatshme për qëllimin që shërbejnë.

***Përgjigje**: Gomë: fasheta gome, çizme gome, top gome, dorashka gome.*
Pëlhurë: këmishë, perde, kavo rimorkimi etj.

Vlerësim përmbledhës

Formulimet për përsëritje dhe reflektim në librin e nxënësit janë një pikënisje e përkryer kur diskutohet për përparimin individual të çdo nxënësi. Ky informacion mund të përdoret gjithashtu për të krijuar një raport për çdo nxënës në fund të vitit shkollor.

Ai gjithashtu mund të jetë i dobishëm për të mbajtur një regjistër (vlerësimi) për të gjithë klasën për nivelin e përgjithshëm të sigurisë duke identifikuar çfarë mund të kenë nevojë të rishikohet më vonë (shih një shembull në tabelën e mëposhtme).

Formulimi për përsëritje dhe reflektim	Shumë i/e sigurt	Jo aq i/e sigurt	Jo i/e sigurt

Kjo analizë (apo ky feedback) mund të përdoret më pas për të formuar një program përmirësimi (program rehabilitimi), i cili do të shërbejë për të ndihmuar nxënësit që të përmirësohen në të ardhmen.

Thjesht mbaj dhe ruaj regjistrimin e të dhënave dhe analizën e vetëvlerësimeve të nxënësve.

Kërkohet një përshtypje e përgjithshme e vetëvlerësimit të klasës, jo një regjistrim i vlerësimit individual të nxënësve (të dhëna individuale). Kjo është gjithçka që të duhet. P.sh.: pesëdhjetë përqind e klasës nuk ishin të sigurtë në lidhje me ...

5 Shtytje dhe tërheqje

Në këtë tematikë nxënësit:

- Shqyrtojnë , bisedojnë dhe përshkruajnë lëvizjen e sendeve që ato njohin;
- Dallojnë që shtytja dhe tërheqja janë të dyja forca;
- Kuptojnë që ka një shkak kur sendet përshpejtohen, ngadalësohen apo ndryshojnë drejtimin.

Njohuri përgatitore

Ky është moduli i parë rreth forcave, të cilat do të shtjellohen më tej në klasën 3, "Njohja me Forcat". Forcat gjithashtu do të trajtohen në klasën 5, "Lëvizjet e Tokës". Kjo tematikë përqëndrohet kryesisht në forcat e tërheqjes dhe të shtytjes, dhe në atë se si këta ndikojnë në lëvizjen e trupeve përsa i përket rritjes së shpejtësisë, zvogëlimit të shpejtësisë apo ndryshimit të drejtimit.

Mësimi hyrës të ndihmon të nxitësh nxënësit të kujtojnë njohuritë që kanë rreth forcave të shtytjes dhe të tërheqjes. Gjithashtu në mësim përfshihen pamje që nxisin mendimin e nxënësve në lidhje me këto forca. Gjithashtu mësimi përfshin pyetje për diskutim dhe fakte mbresëlënëse me qëllim që të ndihmojë nxënësit të bëjnë lidhjen me temën dhe të nxitin përfshirjen e tyre.

Aftësitë e hulumtimit shkencor

Nxënësve u jepet mundësia për të bërë parashikime për mënyrën se si forcat do të ndikojnë në lëvizjen e trupave. Ata do të mësojnë si të sugjerojnë ide, si të ndjekin udhëzimet dhe shënojnë të dhënat. Gjithashtu ata do të aftësohen të bëjnë krahasimin e fakteve lidhur me shtytjet dhe tërheqjet. Ata do të aftësohen si të bëjnë modelimin dhe si të shkëmbejnë idetë e tyre, në mënyrë që të jenë në gjendje të përcjellin dhe zhvillojnë aftësitë e mendimit shkencor.

Fjalë kyçe

shpejt lëviz ngadalë ndalo
lëkundje kthehu

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

gjej fol rretho vëzhgo shkruaj

Përshkrimi i mësimit

Njohuritë më kryesore të nxënësit në këtë mësim janë:

- Të diskutojë se çfarë i bën sendet të lëvizin;
- Të mendojë për mënyrën si ndalojnë sendet.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të mësojnë për lëvizjen e sendeve të njohura si dhe do t'i përshkruajnë ato.

Pyetjet në faqet hyrëse synojnë ti nxisin nxënësit të diskutojnë për lëvizjen e sendeve. Ata ndoshta nuk mund ta kuptojnë lëvizjen, por do të jenë të aftë të japin disa shembuj. Pyetjet parashtrojnë lloje të ndryshme lëvizjesh. Forcat kryesore që do të diskutohen janë shtytja dhe tërheqja, dhe nxënësit do të jenë të aftë të indentifikojnë trupat që lëvizin. Llojet kryesore të lëvizjes janë ecja, lëkundja, rrëshqitja, kërcimi së gjati, kërcimi së larti, rrotullimi.

Pse topi rrokulliset teposhtë kodrinës?

Kërkoju nxënësve të diskutojnë me shokun rreth pyetjes. Në këtë pikë të mësimit ti duhet të nxitësh nxënësin të mendojë pse topi lëviz. Në mësimin e ardhshëm nxënësi do të përdorë një top, me qëllim që ta bëjë vetë vëzhgimin e lëvizjes.

Përgjigje e mundshme: *Një nga nxënësit shtyn topin për nga maja e kodrës.*

Si do të ndalojë topi?

Kërkoju nxënësve ta diskutojnë këtë dukuri në grupe dyshe. Pastaj kërkoju secilit grup të shkëmbejë idetë e tyre me klasën. Shpjegoju që nëse trupi është në lëvizje, atëherë duhet diçka që ta ndryshojë lëvizjen. Nxënësit do të mësojnë në lidhje me ligjet e lëvizjes dhe forcat kundërvepruese në mësimet e ardhëshme, megjithatë ky mësim ofron një mundësi për t'u njohur me konceptin.

Përgjigje e mundshme: *Diçka do ta ndalojë atë. Për ta ndaluar topin ti duhet ta pengosh atë nga drejtimi i kundërt.*

Si po lëviz shilarësi?

Kërkoju nxënësve të shikojnë foton e shilarëses në libër dhe të diskutojnë me shokun/shoqen në krah se si lëviz ajo. Shilarësja lëviz para dha pastaj prapa. Shpjegoju që gruaja e shtyn shilarësen përpara.

Nuk ka nevojë të diskutohet në këtë fazë rreth rëndesës; nëse nxënësit shprehin interes, shpjegoju se ka një forcë tjetër të padukshme që quhet forcë e rëndesës, e cila bën që çdo gjë të bjerë në Tokë. Sapo nxënësi të hipë në shilarëse, nxite atë të mendojë për këtë dukuri. Drejto pyetjen:

- A kishte ndonjë lëvizje kur ti hipe në shilarëse? *Jo*.

Shilarësja nuk lëviz derisa një forcë ta vërë në lëvizje. Shpjego që gruaja po e shtyn shilarësen përpara.

Përgjigje e mundshme: *Përpara dhe prapa.*

Fakt interesant

Sill shembull faktin interesant. Ti mund të shfaqësh video klipin e një makine që lëviz me shpejtësi mbi pistë. Gjithashtu ti mund të demostrosh lëvizjen rrotulluese duke shfaqur një video të një patinatori. Tregoju nxënësve që patinatori mund të rrotullohet me një shpejtësi mbi 308 rrotullime për 1 minutë.

Formim gjuhësor

Diskuto kuptimet e falëve kyçe për këtë tematikë; fillo me fjalët që ata kanë ndeshur në faqet hyrëse. Në këtë fazë ata mund të shtojnë pamje të lëvizjes të shoqëruara me fjali të thjeshta. Ata mund të shtojnë pamje të shtyrjes së një topi dhe shtyrjes së një shilarseje nën etiketën "Shtytje". Në mësimet e mëpasme të kësaj tematike ata do të jenë të aftë të ilustrojnë me shembuj "Shtytjen". Ndërkohë nxit nxënësit të plotësojnë "Fjalorin shpjegues" në libër më qëllim që të aftësohen të përcaktojnë fjalët kyçe me përkufizimet e tyre.

Veprimtari plotësuese

1. Nëse nxënësit shkojnë në parkun e lodrave, kërkoju atyre të identifikojnë gjatë gjithë kohës pajisjet që ata shtyjnë për t'i vënë në lëvizje. Për shembull, ata mund të shtyjnë një shilarëse me qëllim që ajo të lëkundet apo një rrotulluese me qëllim që ajo të rrotullohet etj.
2. Kërkoju nxënësve të regjistrojnë të gjitha rastet që ata përdorin 'shtytje' ose 'tërheqje' gjatë një ore të caktuar të ditës. Ata mund t'i shënojnë nën titujt 'shtytje' dhe 'tërheqje' në tabelën për regjistrimin e të dhënave. Demonstroju nxënësve si bëhet një tabelë për regjistrimin e të dhënave.

Si lëvizin trupat

Zbulon, diskuton dhe përshkruan si lëvizin sendet e njohura.


Si lëvizin trupat

Zbulo për shtytjen dhe tërheqjen.

Ideja kryesore

Shtytja dhe tërheqja janë forca.

Çfarë është lëvizja?

Ne nuk mund t'i shikojmë forcat, por ato i bëjnë trupat të lëvizin.

Vëzhgim: Si mund ta bëni një top të lëvizë?

Si do ta lëvizje një top që është në prehje?

Tërhiqe topin drejt vetes. Çfarë ndodh me të?

Topin duhet ta shtysh, që ai të lëvizë përpara.

Shtytja është një forcë që i bën trupat të lëvizin.

Po ashtu edhe tërheqja është një forcë që i bën trupat të lëvizin.

Forcat i detyrojnë trupat të lëvizin gjatë gjithë kohës.

Si mund ta provosh këtë?

Vëzhgim: Gjej trupa në lëvizje në mjedisin e shkollës.

Bëj një vëzhgim në mjedisin e shkollës.

1. **Zgjidh** një mjedis ku ka trupa që lëvizin.
2. Shëno çfarë vrojtove, në një tabelë si kjo më poshtë.

Trupi që lëviz	Përshkrimi i lëvizjes
Topi që rrokulliset	Topi po rrokulliset teposhtë kodrinës.

60

Disa nga makinat që shihni në figurë, janë në lëvizje.

Disa makina kanë ndaluar.

Forcat mund t'i bëjnë trupat të lëvizin.

Forcat mund t'i ndalin trupat.

A mund ta kuptosh që flamujt po lëvizin?

Çfarë i bën flamujt të lëvizin?

Çfarë lloj lëvizjeje bëjnë ata?

Flamujt nuk shkojnë nga një vend në një vend tjetër.

Ata janë mbërthyer në shtizë dhe po lëvizin para-prapa nën veprimin e erës.

Mendo rreth...

Pse disa trupa lëvizin, kurse të tjerë jo?

Shtytje dhe tërheqje

61

Njohuri përgatitore

Ky mësim vëzhgon dhe shqyrton pse lëvizin sendet që njohim. Shtytjet dhe tërheqjet janë forca që i bëjnë sendet të lëvizin. Nxënësit kryejnë një studim për lëvizjen e sendeve. Ata përshkruajnë si lëvizin sendet rreth shkollës. Lëvizja e automjeteve është marrë si shembull për të treguar se sendet lëvizin me shpejtësi, ngadalë, ndalojnë dhe ndryshojnë drejtim. Për të shmangur keqkuptimin se lëvizja nuk është vetëm të shkosh nga një vend në një vend tjetër, nxënësit shikojnë si lëviz flamuri nga era.

Materiale burimore

Topa të vegjël, p.sh. top tenisi, tabelë rezultatesh, flamur.

Fjalë kyçe

Shpejtësi lëvizje ngadalë ndalim (prehje)

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

gjej diskuto përshkruaj

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- Të zbulojnë si lëvizin sendet;
- Të përshkruajnë mënyrën e lëvizjes së sendeve të njohura.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të shqyrtojnë për lëvizjen e trupit tonë.

Çfarë është lëvizja?

Nxit nxënësit të diskutojnë në grupe të vogla çfarë mendojnë se është lëvizja. Shpjegoju se forcat janë të padukshme, por ne mund të shohim rezultatin e tyre. Forca i bën sendet të lëvizin.

Përgjigje e mundshme: *lëvizja është të shkosh nga një vend në një vend tjetër.*

Vëzhgim: Si mund ta bëni një top të lëvizë?

Qëllimi i këtij vëzhgimi është të nxitë nxënësit të mendojnë se si forcat i bëjnë trupat të lëvizin. Do t'i ndihmojë të përdorin fjalët kyçe të veprimtarisë shkencore, të aftësohen, të kërkojnë dhe të diskutojnë se si forcat veprojnë mbi topin.

Të nevojiten topa tenisi ose të ngjashëm me to.

- Organizo nxënësit në dyshe.
- Jepu çdo dysheje nga një top dhe kërkoju të studiojnë ndikimin e forcave.
- Pyeti si do të fillojë lëvizja e topit në tryezë.

Si do ta lëvizje një top që është në prehje?

Kërkoju nxënësve të diskutojnë me shokun/shoqen.

Përgjigje e mundshme: *Unë duhet ta shtyj topin që të lëvizë përpara. Forca shtytëse i bën trupat të lëvizin.*

Pasi nxënësi të ketë provuar të shtyjë topin, shpjegoi të gjithë klasës se është forca shtytëse që i bën sendet (trupat) të lëvizin.

Tërhiqe topin drejt vetes. Çfarë ndodh me të?

Kërkoju atyre të përpiqen ta bëjnë topin të kthehet drejt tyre. Nxiti të diskutojnë me shokun/shoqen:

- Çfarë ndodh me topin?

Shpjegoju të gjithë klasës se edhe tërheqja është një forcë që i bën trupat të lëvizin.

Përgjigje e mundshme: *Topi lëviz drejt meje.*

Tregoju nxënësve se forcat janë rreth nesh gjatë gjithë kohës dhe i bëjnë sendet të lëvizin. Thuaju se në vëzhgimin tjetër do të mësojmë më shumë rreth tyre.

Vëzhgim: Gjej trupa në lëvizje në mjedisin e shkollës.

Qëllimi i këtij vëzhgimi është që nxënësit të provojnë se forcat janë rreth nesh. Kjo do t'i ndihmojë nxënësit të praktikojnë fjalët kyçe të veprimtarisë shkencore, do t'i aftësojë për të kërkuar dhe zbuluar.

Të nevojiten; tabelë rezultatesh, lapsa.

- Sigurohu se e ke njoftuar personelin e shkollës se do të përdorësh fushat për këtë vëzhgim. Kujdesu të gjesh një vend sa më të mirë që të vëzhgosh lëvizjen. Organizo nxënësit në grupe treshe ose katërshe.
- Sigurohu që të gjithë nxënësit të kenë tabelën në fletore para se të fillojë vëzhgimi.

1 Zgjidh një mjedis ku ka trupa që lëvizin.

- Udhëzo nxënësit të mbajnë shënime për çdo send që ata mund të shohin duke lëvizur.

2 Shëno çfarë vrojtove në një tabelë si kjo më poshtë. A ishte kjo ajo çfarë pret?

Trupa në lëvizje	Përshkrimi i lëvizjes
Topi rrokulliset	Topi rrokulliset poshtë kodrës.

- Vizato tabelën e dhënë si shembull në dërrasën e zezë. Diskuto për tabelën që nxënësit të dinë për çfarë janë duke kërkuar.
- Puno me nxënësit për të plotësuar tabelën dhe paraqit rezultatet e tyre të gjitha së bashku në dërrasën e zezë.

Çfarë mendoni se ndodh me forcën e shtytjes kur një makinë ngadalëson?

Përpiqu të gjesh një vend të sigurt për të vëzhguar lëvizjen e makinave. Nxënësit do të mësojnë më vonë rreth forcave kundërvepruese. Për të shmangur keqkuptimet mund të shpjegosh se forca shtytëse mund të mbetet e njëjtë. Makina ngadalëson sepse kundërvepron një forcë. Shpjego se një forcë tjetër mund të fillojë të veprojë mbi makinën dhe forca shtytëse mund të mos jetë mjaft e madhe për ta kundërshtuar atë.

Nëse kjo nuk është e mundur, përdor fotot në libër ose video të lëvizjes në trafik. Nxit nxënësit të diskutojnë për lëvizjen e automjeteve.

- A lëvizin të gjithë makinat me të njëjtën shpejtësi? Jo disa makina lëvizin më shpejt. Disa kanë ndaluar (janë në prehje), makinat e tjera po lëvizin ngadalë në radhët e trafikut.

Nxit nxënësit të diskutojnë se çfarë ndodh me forcën që e bën makinën të ngadalësojë.

Përgjigje e mundshme: *shtytja është më e vogël.*

A mund ta kuptosh që flamujt po lëvizin?

Çfarë e bën flamurin të lëvizë?

Në çfarë mënyre po lëvizin ata?

Kërkoju nxënësve të shikojnë foton dhe të diskutojnë rreth pyetjes. Flamujt në foto lëvizin nga era. Flamujt lëvizin në drejtimin e erës. Nëse era është e vrullshme flamujt lëvizin para dhe prapa.

Përgjigje e mundshme: *Flamujt lëvizin nga era. Flamujt lëvizin një herë në njërin drejtim pastaj në drejtimin tjetër.*

Formim gjuhësor

Fjalët kyçe për këtë mësim janë "lëvizje", "veprim" dhe "lëviz". Paraqiti këto fjalë në kontekst për ta përforcuar kuptimin.

Veprimtari plotësuese

1 Nxënësit mund të kryejnë një studim për forcat gjatë rrugës për në shtëpitë e tyre.

Mendo rreth… kjo është një mundësi për të treguar se lëvizja jo gjithmonë bën që një trup të shkojë nga një vend në një vend tjetër. Nxënësit e nxjerrin këtë përfundim se shtiza e flamurit qëndron në të njëjtin vend, por flamuri lëviz. Përdor pyetje që i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë se jo çdo gjë ka nevojë të lëvizë .

Prit një përgjigje e cila shpjegon se: disa sende janë shumë të mëdha të lëvizin nga era ose të shtyhen nga ne. Makinat dhe makineritë janë bërë të lëvizin. Ndërtesat janë bërë për të qëndruar aty ku janë ndërtuar.

Si lëvizin trupat

Zbulon, diskuton dhe përshkruan si lëvizin sendet e njohura.


Si lëvizin trupat

Zbulo për shtytjen dhe tërheqjen.

Ideja kryesore

Ti mund ta lëvizësh trupin tënd.

Në sa mënyra mund ta lëvizësh trupin tënd?

Trupin mund ta lëvizësh në mënyra të ndryshme. Të marrim si shembull ecjen. Si lëvizin këmbët? Disa njerëz i **lëkundin** krahët, kur ecin.

Vëzhgim: Çfarë ndodh kur lëkundni krahët?

Provo të ecësh duke lëkundur krahët.

A mund t'i lëkundësh krahët më shpejt?

A mund t'i lëkundësh krahët më ngadalë?

Çfarë ndodh me shpejtësinë e ecjes sate, kur krahët e ngadalësojnë lëvizjen?

Cila forcë e bën krahun të lëvizë përpara?

Cila forcë e bën krahun të lëvizë prapa?

Shtytja dhe tërheqja janë forca. Forcat shfaqen në çdo veprimtari që bëjmë.

Çfarë **force** do të përdorësh për të ngritur lart një laps?

62

Vëzhgim: Lojëra me shtytje dhe tërheqje.

1. Mendo për lëvizjet e ndryshme që ke bërë në këtë mësim.
2. Zgjidh disa lojëra që të pëlqejnë.
3. Sigurohu që lojërat të jenë me shtytje dhe tërheqje.

Në figurë shikojmë disa fëmijë duke luajtur. Emërto te secili prej tyre llojin e forcës.

shtytje tërheqje

a.

d.

b.

c.

Shko në faqe 72 për të kontrolluar se çfarë di.

Shtytje dhe tërheqje

63

Njohuri përgatitore

Ky mësim vëzhgon lëvizjet e trupit. Gjatë gjithë mësimit duhet të merren parasysh ndjenjat e nxënësve. Ti mund ta zhvillosh këtë mësim të lidhur me edukimin fizik. Nxënësit kanë parasysh se në lëvizje përfshihet ecja dhe veprimtari të tjera. Në përfundim të vëzhgimit për lëvizjet e trupit ti mund të zhvillosh një olimpiadë të vogël.

Materiale burimore

Një hapësirë e lirë; pajisje sportive, çanta, litarë dhe stola apo trarë.

Aftësitë e hulumtimit shkencor

Nxënësit vëzhgojnë shumë mënyra të lëvizjes së trupit tonë dhe identifikjonë cilat forca bëjnë të mundur lëvizjet.

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

vrapo ec kërce hidhu kthehu rrotullohu

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- Të zbulojë mënyrat se si lëviz trupi;
- Të planifikojë lëvizjen.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të përdorin "shtytjet" dhe "tërheqjet" për të vënë në lëvizje një makinë - lodër.

Në sa mënyra mund ta lëvizësh trupin tënd?

Kërkoju nxënësve të diskutojnë rreth pyetjes. Shpjegoju që ne mund të vëmë në lëvizje trupin tonë në mënyra të ndryshme. Pyet nxënësit:

- Kur ju ecni, si lëvizin këmbët tuaja? *Përpara dhe Prapa.*

Përgjigje e mundshme: *Ecja, vrapimi, kërcimi, hedhja, lëkundja, rrotullimi.*

Vëzhgim: Çfarë ndodh kur lëkundni krahët?

Qëllimi i këtij vëzhgimi është që nxënësi të zbulojë se si trupi përdor forcat për tu vënë në lëvizje. Ky vëzhgim do t'i ndihmojë nxënësit të praktikojnë fjalët kyçe të veprimtarisë shkencore dhe të aftësohen të parashikojnë rezultatin e ushtrimit të lëkundjes së krahëve.

- Pyet nxënësit çfarë ndodh kur ata lëkundin krahët.

Shpjegoju që të lëkundësh do të thotë të lëvizësh diçka para ose prapa. Demostroje me lëkundjen e krahëve të tu.

- Krijo një hapësirë të lirë në klasë ose dil jashtë. Kërkoju nxënësve të ecin në formë rrethore duke lëkundur krahët.

A mund t'i lëkundësht krahët më shpejt?

Thuaju nxënësve të lëkundin më shpejt krahët. Disa nxënës do të fillojnë natyrshëm të rrisin shpejtësinë.

Përgjigje *: Po*

A mund t'i lëkundësh krahët më ngadalë?

Thuaju nxënësve të lëkundin krahët më ngadalë.

Përgjigje *: Po*

Për të përforcuar njohuritë e mësimit dhe natyrisht, për t'u zbavitur përsërit komandën "përshpejto" dhe "ngadalëso" duke u siguruar që të gjithë nxënësit kanë hapësirë të mjaftueshme për këtë.

Çfarë ndodh më shpejtësinë e ecjes sate kur krahët e ngadalësojnë lëkundjen?

Zakonisht kur ne lëkundim krahët ngadalë, ecim më ngadalë. Zhvillo një diskutim në grupe me qëllim që nxënësit të shkëmbejnë përvojat e tyre lidhur me atë që vëzhguan për lëvizjen.

Përgjigje e mundshme: *Kur krahët e mi lëkunden ngadalë, gjithashtu ecja ime ngadalësohet.*

Kërkoju nxënësve të përgjigjen për dy pyetjet e tjera në libër.

Cila forcë e bën krahun të lëvizë përpara?

Përgjigje*: Shtytja.*

Cila forcë e bën krahun të lëvizë prapa?

Përgjigje*: Tërheqja.*

Çfarë force do të përdorësh për të ngritur lart një laps?

Shëno përgjigjet e nxënësve në tabelë dhe nënvizo poshtë fjalëve 'Shtytje' dhe 'Tërheqje'. Pastaj kërkoju që ta provojnë duke ngritur një laps nga tryeza. A ndodh ajo që ti pret?

Përgjigje*: Tërheqje.*

Vëzhgim: Lojëra me shtytje dhe tërheqje.

Qëllim i këtij vëzhgimi është që nxënësit t'i përdorin të gjitha forcat që kanë njohur gjatë këtij mësimi. Nxënësit kujtojnë se cilat forca janë përdorur në veprime të ndryshme.

Ty të nevojiten: pajisje të ndryshme sportive.

Thuaju nxënësve: Ju do të organizoni një lojë ku do të trajtoni "forcat".

1 Mendo për lëvizjet e ndryshme që ke bërë në këtë mësim.
- Nxiti nxënësit të mendojnë për lëvizje të tjera, përveç atyre të njohura gjatë mësimit.
- Shkruaj lëvizjet e sugjeruara nga nxënësit në dërrasë dhe kërkoju t'i emërtojnë ato sipas rastit, forcë "shtytje" ose "tërheqje". P.sh, për të hedhur topin përdoret forcë shtytëse.

2 Zgjidh disa lojëra që të pëlqejnë.
- Ndaje klasën në skuadra dhe kërkoju atyre ide.

3. Sigurohu që lojërat të jenë me shtytje dhe tërheqje.
   - Nxit nxënësit të përcaktojnë se cilat lojëra janë me shtytje dhe cilat me tërheqje, p.sh. tërheqja e litarit është lojë me tërheqje.
   - Nxënësit shënojnë idetë e tyre në tabelën më poshtë.

Loja	Shtytje	Tërheqje
Futboll	✓	

Vlerësimi i njohurive

SNë figurë shikojmë disa fëmijë duke luajtur. Emërto te secili prej tyre llojin e forcës.

Kërkoju nxënësve që ta zhvillojnë veprimtarinë në grupe dyshe.

Përgjigje*: a) (tërheqje litari) tërheqje,*
b) (hedhje topi në kosh) shtytje,
c) (gjuajtja e topit me këmbë) shtytje,
d) (gjuajtje me hark) tërheqje.

Përsëritje dhe përforcim njohurish

Mbyll temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë faqen 72 në librin e nxënësit.

Formim gjuhësor

Në këtë mësim janë përdorur shumë fjalë kyçe. Lejo nxënësit të përdorin "Fjalorin shpjegues" për disa nga fjalët. Kjo është një temë krijuese me qëllim që nxënësit të jenë në gjendje të provojnë veprimet e forcave. Emërtimi i veprimeve "shtytje" ose "tërheqje" do të përforcojë më tej kuptimet e këtyre forcave.

Veprimtari plotësuese

1 Kërkoju nxënësve të vëzhgojnë lojëra të tjera sportive në shkollë apo TV. Kërkoju të identifikojnë forcat që vërejnë.

T'i bëjmë trupat të lëvizin më shpejt ose më ngadalë

Kupton se shtytja dhe tërheqja janë forca.


T'i bëjmë trupat të lëvizin më shpejt ose më ngadalë

Kupto se shtytja dhe tërheqja janë forca.

Ideja kryesore

Forcat mund t'i ndalin trupat që lëvizin.

Disa makina lëvizin **më ngadalë** se të tjerat.

Disa makina lëvizin **më shpejt** se të tjerat.

Çfarë ndodh me forcat, kur makinat lëvizin më shpejt?

Shiko makinën-lodër.

Vëzhgim: Çfarë e bën makinën të lëvizë?

1. Bashkëpuno me shokun e bankës.
2. Bëj që makina-lodër të lëvizë.

Si do ta lëvizje makinën-lodër drejt vetes?

Si do ta largoje makinën-lodër nga vetja?

Për ta vënë në lëvizje makinën-lodër duhet ta shtysh apo ta tërheqësh?

64

3. Bëj që makina-lodër të lëvizë më shpejt.

Si e bëre këtë?

Si mund të veprosh që makina-lodër të lëvizë **më ngadalë**?

Si mund ta ndalësh makinën-lodër?

Vëzhgim: Si mund ta ndalësh një makinë-lodër që është në lëvizje?

1. Bashkëpuno me shokun e bankës.

Zbulo si duhet vepruar, për ta **ndalur** makinën-lodër në lëvizje.

2. Shtyje makinën-lodër.

Mos e shty fort, sepse mund të godasësh nxënësit e tjerë.

3. Dikush duhet ta ndalojë makinën-lodër.

Si e ndalove makinën-lodër që po lëvizte?

Mendo rreth...

Cila forcë e bën rosën-lodër të lëvizë? Nga cila anë po vjen ajo?

Shtytje dhe tërheqje

65

Njohuri përgatitore

Në këtë mësim nxënësit fillojnë të njohin shtytjen dhe tërheqjen si forca. Mësimi përqëndrohet në lëvizjen e makinave lodër dhe lëvizjen e lodrave të tjera. Nxënësit provojnë si lëvizin lodrat kur shtytja ose tërheqja është më e madhe ose më e vogël. Gjithashtu vëzhgojnë si mund ta detyrojnë një lodër të ndalojë menjëherë ndërsa ajo ndodhet në lëvizje.

Materiale burimore

Lodra lëvizëse të përzgjedhura, karroca lodër.

Fjalë kyçe

kthehu

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- Të vënë makinat lodër në lëvizje me anë të shtytjes dhe tërheqjes;
- Të mësojnë se shtytja dhe tërheqja janë forca.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të përdorin njohuritë e tyre të lëvizjes për të krijuar, ndërtuar dhe provuar një lodër lëvizëse.

Çfarë ndodh me forcat kur makinat lëvizin më shpejt?

Kërkoju nxënësve të mendojnë se si mund ta vënë makinën në lëvizje më shpejt. Bëju të qartë idenë se për të lëvizur më shpejt ata duhet të ushtrojnë më shumë forcë ose ta tërheqin më fort atë.

Vëzhgim: Çfarë e bën makinën të lëvizë?

Qëllimi i këtij vëzhgimi është që nxënësit të zbulojnë si veprojnë forcat mbi makinën. Nxënësit do të praktikojnë aftësitë kërkimore shkencore duke vëzhguar se si lëviz makina kur ushtrohet shtytje.

Ty të nevojiten: sipërfaqe e lëmuar (p.sh. banga), makina- lodër.

1 Bashkëpuno me shokun/shoqen e klasës.

- Përcakto rregullat përpara se t'i përdorin makinat.

Nxënësit nuk duhet të shtyjnë shumë makinat, se mund të dëmtojnë dikë tjetër.

2 Bëj që makinëa lodër të lëvizë.

- Jepi çdo grupi nga një makinë.
- Kërkoju nxënësve të mendojnë se çfarë force duhet të ushtrojnë për ta lëvizur makinën: shtytje apo tërheqje? Sigurohu që secili anëtar i grupit të marrë pjesë në procesin e vëzhgimit dhe veprimit.
- Diskuto pyetjet në librin e nxënësit përpara se ata të plotësojnë përgjigjet e tyre.

Si do ta lëvizje makinën-lodër drejt vetes?

***Përgjigje**: Tërheq makinën.*

Si do ta largoje makinën-lodër nga vetja?

***Përgjigje**: Shtyj makinën.*

Për ta vënë në lëvizje makinën-lodër duhet ta shtysh apo ta tërheqësh?

Vëzhgimi demonstron se shtytja dhe tërheqja shkaktojnë lëvizje. Qartësoje përgjigjen nga nxënësit.

***Përgjigje**: Ju mund të tërhiqni ose shtyni. Varet se në çfarë drejtimi kërkoni të lëvizni makinën.*

3 Bëj që makina-lodër të lëvizë më shpejt.

- Kërkoju nxënësve ta lëvizin makinën më shpejt.
- Thuaju nxënësve ta shkruajnë në fletore si e bënë.

Si e bëre këtë?

***Përgjigje**: shtytje ose tërheqje më e madhe/ përdora më shumë forcë.*

Si mund të veprosh që makina-lodër të lëvizë më ngadalë?

Kërkoju nxënësve të mendojnë se si mund ta lëvizin makinën më ngadalë.

Përgjigje e mundshme: *Përdor më pak forcë ose ndaloj lëvizjen.*

Bëj me klasën një kontroll të përgjigjeve të dhëna. Dhe vazhdo me shpjegimin e tekstit në libër. Thuaju nxënësve (ose drejtoju me situata ndihmëse që nxënësit ta nxjerrin vetë përgjigjet): Që makina ose ndonjë trup tjetër të vihet në lëvizje, kërkohet të ushtrohet një forcë. Që makina të lëvizë më shpejt në duhet të ushtrojmë më shume forcë. Që makina të lëvizë më ngadalë ne nuk ushtrojmë aq shumë forcë.

Si mund ta ndalësh makinën-lodër?

Kërkoju nxënësve të kujtojnë se si e detyruan makinën të lëvizte më shpejt. Qartëso se për të ndaluar makinën duhet të ndodhë e kundërta. Forca që e bën makinën të lëvizë duhet të zvogëlohet dhe madje të mos veprojë më. Kërkoju të mendojnë se si mund të arrihet kjo gjë. Në këtë fazë nuk është e domosdoshme të diskutohen forcat kundërvepruese, të tilla si frenimi.

Përgjigje e mundshme: *Duhet që forca shtytëse të mos veprojë më.*

Vëzhgim: Si mund ta ndalësh një makinë-lodër që është në lëvizje?

Nxënësit vëzhgojnë ndalimin e forcave që detyrojnë makinën lodër të lëvizë. Ata mund ta bëjnë këtë duke ndaluar me dorë një makinë apo trup tjetër në lëvizje, p.sh. një makinë tjetër lodër.

Ty të nevojiten: sipërfaqe të sheshta (p.sh. banga), dhe makina-lodër.

1. Bashkëpuno me shokun/shoqen e bankës.

- Thuaju nxënësve se ata do të studiojnë si ta ndalojnë forcën shtytëse mbi një makinë - lodër.

2. Shtyje makinën-lodër

- Kërkoi një nxënësi ta shtyjë makinën.

Sigurohu që nxënësit janë të vetëdijshëm për rrezikun nëse e shtyjnë shumë fort makinën-lodër.

3. Dikush duhet ta ndalojë makinën lodër.

Shpjego se nxënësi tjetër ka për të ndaluar makinën me dorën e tij ose me një trup tjetër.

Nxënësit sipas rradhës shtyjnë dhe ndalojnë makinën.

Si mund ta ndalësh makinën-lodër?

Nxënësit duhet të ushtrojnë forcë ose të mos ushtrojnë aq shumë force shtytëse që të jenë në gjëndje ta ndalojnë atë.

Përgjigje e mundshme: *Ndaloj duke vendosur dorën/ ose duke vendosur një makinë tjetër lodër përpara makinës që është në lëvizje.*

Formim gjuhësor

Kërkoju nxënësve të japin një përkufizim për termat "parashiko" dhe "hamendëso" që janë përdorur në këtë mësim. Kërkoju nxënësve të shkruajnë një përkufizim në "Fjalorin shpjegues" dhe në "Tabelën e fjalëve". Nxënësit më të aftë mund t'i pyetësh për ndryshimin ndërmjet "parashiko" dhe "hamendëso". Shpjegoju nxënësve me një fjalor të thjeshtë, se "parashiko" tregon mendim paraprak të cilin ne duhet ta provojmë. Ndërsa "hamendëso" është diçka rreth së cilës ka më pak dijeni.

Veprimtari plotësuese

1. Nxënësit zbatojnë njohuritë e tyre bazuar në vëzhgimet që mund të kryejnë me lodra të tjera lëvizëse. Kërkoju nxënësve të diskutojnë në grupe dyshe se si mund ta detyrojnë të lëvizë secilën lodër. Pyeti ato:

- A mund të parashikoni si mund të përshpejtohet ose ngadalësohet lëvizja?
- Si mund ta ndaloni lëvizjen e një lodre?

2. Pyeti nxënësit, si mendoni se ngadalësojnë makinat e vërteta? Çfarë përdorin ato? Çfarë force ndryshon?

Mendo rreth ... kjo pyetje ndihmon nxënësit të kuptojnë që duhet të ketë një burim për ushtrimin e forcës mbi trup, e cila (forca) si pasojë shkakton lëvizjen e tij (trupit). Prit përgjigjje që shpjegojnë se: duke tërhequr fijen rosa-lodër lëviz përpara. Forca vjen nga personi që tërheq fijen.

T'i bëjmë trupat të lëvizin më shpejt ose më ngadalë

Kupton se shtytja dhe tërheqja janë forca.


T'i bëjmë trupat të lëvizin më shpejt ose më ngadalë

Kupto se shtytja dhe tërheqja janë forca.

Ideja kryesore

Mund të ndërtosh lodra lëvizëse.

Me sa mënyra mund të lëvizin lodrat?

Vëzhgim: Të bëjmë një lodër lëvizëse.

1. Puno me një grup të vogël.
2. Bëj një lodër lëvizëse prej kartoni ose druri.

Mendo si të bësh një lodër lëvizëse.
Për këtë të duhen disa rrota.

Ndërto një makinë-lodër me tullumbace.

- Lidh një tullumbace te makina që ndërtove.
- Fut një gyp tek tullumbacja.
- Mbaje fundin e tullumbaces me dy gishta.
- Fryje ngadalë tullumbacen.
- Kur ajri çlirohet, tullumbacja e shtyn makinën përpara.

Si mund ta lëvizësh makinën-lodër?

Çfarë force e lëviz makinën-lodër?

66

Bëj një lodër kërcyese

Të duhet një sustë.

- Bëj një kukull-lodër me plastelinë dhe ngjite me sustën.
- Ngjishe sustën dhe pastaj lëshoje.

Cila forcë e hedh lodrën lart?

Disa lodra kanë një çelës që e hedh lodrën lart.

Çfarë force do të përdorësh për ta **rrotulluar** çelësin?

Rretho forcën që po e lëviz trupin në figurë.

1. Që të hedhësh një qese fasulesh, duhet të veprosh me forcë shtytëse / tërheqëse.

2. Për të ngritur një libër duhet forcë shtytëse / tërheqëse.

3. Për të hapur derën drejt vetes ti përdor një forcë shtytëse / tërheqëse.

Shko në faqe 72 për të kontrolluar se çfarë di.

Shtytje dhe tërheqje

67

Njohuri përgatitore

Në këtë mësim nxënësit projektojnë dhe krijojnë një lodër lëvizëse. Jepen dy shembuj në librin e nxënësit; makina balonë/tullumbacë punon shumë mirë.

Materiale burimore

Letër, karton, duke përfshirë kuti kartoni me valëzime; dru për modelim; shirit; ngjitëse; trupa të llojeve të ndryshme për të bërë rrota, p.sh. disa CD të vjetra, kapakë shishesh plastike; kunja druri; thumba druri; kashtë; sustë elastike; tullumbace; susta.

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

trego

Aftësitë e hulumtimit shkencor

Në këtë mësim nxënësit praktikojnë mënyra të parashikuara për të ndërtuar një lodër që lëviz dhe përdorin aftësitë e të menduarit për të vendosur se cilën lodër të ndërtojnë.

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- Të përdorin njohuritë për lëvizjen për të projektuar, ndërtuar dhe provuar një makinë;
- Të punojnë si një skuadër në marrjen e vendimeve për lodrën.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të mësojnë se ka një shkak kur sendet lëvizin shpejt, ngadalë ose ndryshojnë drejtim.

Me sa mënyra mund të lëvizin lodrat?

Përdor pyetje për kontroll dhe rifreskim të njohurive që kanë mësuar më parë. Kërkoju të diskutojnë në grupe:

- A ju kujtohen mënyrat e ndryshme si lëviznin lodrat?

Kujtoju atyre nëse është e nevojshme, që disa lodra nuk lëvizin pa ushtruar forcë shtytëse ose tërheqëse.

Përgjigje e mundshme: *shtytje, tërheqje, kurdis, susta.*

Vëzhgim: Të bëjmë një lodër lëvizëse.

Qëllimi i këtij vëzhgimi është që nxënësit të ndërtojnë një makinë lodër që të demonstrojnë forcat e shtytjes dhe tërheqjes; do t'i ndihmojë nxënësit të ushtrojnë aftësitë shkencore të krahasimit.

Ty do të nevojiten: materiale artizanale dhe rrangullina të hedhura (shih listën e materialeve).

Tregoju nxënësve figurën e makinës-lodër në libër që të nxitësh mendimin e tyre krijues.

Kujtoju që është zgjedhje e lirë dhe jo domosdoshmërisht duhet të ndërtojnë këtë makinë lodër; mund të ndërtojnë çdo lodër tjetër që lëviz.

1 Puno me një grup të vogël.

- Thuaju nxënësve të projektojnë dhe të ndërtojnë një lodër lëvizëse.
- Organizo nxënësit në grupe prej tre ose katër vetash në mënyrë që të ndihmojnë njëri-tjetrin në detyra të vështira. Caktoi çdo nxënësi rolin, p.sh. grumbulluesi i materialeve, projektuesi, prezantuesi etj.

2 Bëj një lodër lëvizëse prej kartoni ose druri.

- Nëse kanë kohë mund të ndërtojnë më shumë se një lodër. E rëndësishme është që ata të mendojnë rreth hapave që kërkohen për ndërtimin e lodrës lëvizëse.
- Nxiti ata të mendojnë së bashku për projektimin e lodrës lëvizëse, p.sh. vendosjen e rrotave.
- Ata mund të përdorin kartona të valëzuar për trupin, mund të përdorin kunja druri ose thumba për vendosjen e rrotave.
- Vendos tapat e shisheve plastike në anët fundore të secilit kunj.

Ndërto një lodër makinë me tullumbace

Makina tullumbace funksionon shumë mirë dhe është shumë e lehtë për t'u ndërtuar.

- Fut një kallam (pipë) në tullumbace.
- Siguro pipën me një fasho plastike.
- Mbështill një fije spango rreth shiritit elastik dhe kaloje spangon e përdredhur nëpërmjet trupit të makinës.
- Lidhe spangon fort në anën e poshtme.
- Përdor pipën për të fryrë tollumbacen.
- Përpara se makina të vihet në një vend të përshtatshëm për lëvizje, sigurohu të jetë lidhur fundi i pipës që të mos ketë rrjedhje ajri.
- Vendose makinën në një vend të përshtatshëm dhe vëre në lëvizje.

Ti mund të organizoni një garë 'Formula1'.

Si mund ta lëvizësh makinën-lodër?

Tregoju nxënësve se si rrotat duhet të lëvizin lirshëm dhe të mos bllokohen. Tregoju se si duhet t'i mbajnë rrotat për të kontrolluar drejtimin e lëvizjes.

Çfarë force e lëviz makinën-lodër?

Diskuto me nxënësit për mënyra të ndryshme të vënies në lëvizje të makinave lodër dhe se si funksionon secila metodë. Disa nga metodat përfshijnë:

- Përdorimin e çelësit për lodrat me kurdisje.
- Përdorimi i një fasheje elastike për të ruajtur energjinë.
- Tërheqjen e makinës me spango.

Lëri nxënësit të vendosin lodrat në një sipërfaqe të rrafshët. Kërkoju mos ta prekin makinën dhe të vëzhgojnë se si qëndron ajo. Disa ndoshta e dinë që mund të përdorin forcën shtytëse për të detyruar makinën të lëvizë.

Bëj një lodër kërcyese

Nxënësit mund ta ndërtojnë këtë në mungesë të mundësisë për të patur një makinë-lodër. Jepu nxënësve materialet që duhen për të projektuar dhe krijuar një lodër zbavitëse.

- Lidh sëbashku me fasho elastike secilën pjesë të trupit për të lejuar më shumë lëvizje.
- Sytë që luhaten janë tërheqëse dhe gjithashtu zbavitëse.
- Lidhe trupin e lodrës me sustë duke përdorur ngjitëse ose shirit ngjitës.
- Tërhiqe sustën që të mundësohet lëvizja e lodrës.

Cila forcë e hedh lodrën lart?

***Përgjigje**: Një forcë shtytëse ose tërheqëse.*

Çfarë force do të përdorësh për ta rrotulluar çelësin?

Thuaju nxënësve të shikojnë në libër foton e lodrës me kurdisje. Drejtoju pyetje dhe nxiti të përgjigjen përpara se ta shkruajnë atë.

***Përgjigje**: Forcë shtytëse.*

Vlerësimi i njohurive

Rretho forcën që po lëviz trupin në figurë.

Përdor ushtrimet në fund të temës për vlerësimin e të nxënit për dy mësimet e fundit.

***Përgjigje** :*

1. *Që të hedhësh një qese fasulesh, duhet të veprosh me forcë shtytëse.*
2. *Për të ngritur një libër duhet forcë tërheqëse.*
3. *Për të hapur derën drejt vetes ti përdor forcë tërheqëse.*

Përsëritje dhe përforcim njohurish

Mbylle temën duke pyetur nxënësit për të rishikuar dhe reflektuar mbi veprimtarinë në faqen 72 të librit. Shiko gjithashtu shënimet në fund.

Formim gjuhësor

Fjalët kyçe "shpejt", "më shpejt" dhe "më e shpejta" nuk ndeshen në këtë mësim. Demonstro konceptet me makinat lodër dhe thuaj makina A është më e shpejtë se makina B, por makina C është më e shpejtë se makina A. Kështu që makina C është më e shpejta.

Veprimtari plotësuese

Lëri nxënësit të ndërtojnë një shilarëse. Mund të përdorin fije kashte dhe spango për ta ndërtuar atë. Kërkoju nxënësve të diskutojnë pyetjen:

- Si mund ta bësh shilarësen të fillojë lëvizjen?
  Ta shtysh atë.

Vëzhgim mbi trupat që lëvizin

Mëson çfarë i bën trupat të përshpejtohen apo të ngadalësohen ose të ndryshojnë drejtim.


Vëzhgim mbi trupat që lëvizin

Mëso çfarë i bëjnë trupat të përshpejtohen, të ngadalësohen ose të ndryshojnë drejtim.

Ideja kryesore

Disa trupa lëvizin nga era.

Shiko në figurë.

Pse rëra lëviz në këtë mënyrë?

Era e shpërndan rërën larg dorës.

Era

Era bën që gjethet e pemës të lëvizin.

Era bën që varkat të lëvizin.

Ajo bën që helikat e mullinjve të lëvizin.

Vëzhgim: Ndërto një helikë prej letre.

1. Puno me shokun/shoqen e bankës dhe ndihmoni njëri-tjetrin.
2. Seciliën nga skajet e letrës e përkulim në qendër. Për këtë ndihmoni njëri-tjetrin.
3. Fikso katër skajet në qendër me anën e një gjilpëre.
4. Ngule gjilpërën e letrës në një shkop.
5. Tani fryji helikës që ndërtove.

Plotëso fjalitë që përshkruajnë se si lëviz helika.

lëviz ~~më shpejt~~ më ngadalë vend

Kur i fryj fort, helika lëviz më shpejt.

Kur i fryj ngadalë, helika lëviz _____.

Helika _____ duke u rrotulluar, por nuk shkon në një _____ tjetër.

Shtyje dhe tërheqje

68

69

Njohuri përgatitore

Në këtë mësim nxënësit vëzhgojnë rreth mënyrës se si lëvizin sendet dhe se çfarë e shkakton lëvizjen. Mësimi fillon duke vëzhguar se si era lëviz rërën që lëshojmë. Nxënësit ndërtojnë një mulli me erë dhe shqyrtojnë se si mund ta ndryshojnë drejtimin lëvizjes së tij me anë të fryrjes.

Materiale burimore

Karton i hollë, ngjitëse letre; tubet ngjitës; shirit ngjitës, gjilpërë me kokë.

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- Të shqyrtojnë se si era i vë sendet në lëvizje;
- Të ndërtojnë një mulli me erë dhe ta provojnë atë.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë më shume se si uji dhe era i vënë në lëvizje trupat.

Pse rëra lëviz në këtë mënyrë?

Kërkoju nxënësve të shikojnë foton e rërës që shpërndahet nga era. Kërkoju atyre të diskutojnë se si lëviz rëra dhe ta përshkruajnë atë. Bëju të ditur që është era që e largon rërën përtej dorës.

Qartësoi që nëse era ndalon, rëra do të lëvizë në një mënyrë tjetër:

Pyeti nxënësit:

- A mund të merrni me mend se si do lëvizë nëse nuk do kishte fare erë? Rëra do të bjerë poshtë drejt në tokë.

Përgjigje e mundshme: *Rëra po bie poshtë nga e majta. Era shtyn rërën.*

Kalo në veprimtarinë përgatitore duke pyetur nxënësit:

- Çfarë ndodh me gjethet në pemë kur fryn erë? Era i vë gjethet në lëvizje.

Tregoju nxënësve fotot në libër; të varkës me vela dhe mullirit me erë. Ti gjithashtu mund t'u shfaqësh video klipe nga interneti. Nxirr nga vetë nxënësit që është era që vë në lëvizje varkën me vela dhe mullirin me erë.

Vëzhgim: Ndërto një helikë prej letre.

Qëllimi i këtij vëzhgimi është të zbulojnë që era është një forcë që i vë trupat në lëvizje. Kjo do t'i ndihmojë të praktikojnë aftësitë kërkimore se si të vënë në lëvizje freskoren dhe pastaj ta provojnë atë.

Ty do të nevojiten: copa kartoni të parapërgatitura (shiko udhëzimin më poshtë), gjilpëra me kokë, kapse letrash, kunja bashkues, shkop druri, ngjitëse ose shirit ngjitës.

Ti duhet të përgatitësh një copë kartoni për secilën dyshe si më poshtë:

A palos nje fletë katrore përgjysëm sipas diagonales. (nëse përdor fletë A4, kur ta palosësh sipas diagonales, do të mbetet një pjesë. Prite ketë pjesë.)

B Palose atë prapë sipas diagonales.

C Shpalose kartonin. Të katër diagonalet shënohen me shenjë. Fillo prerjen nga secili kënd përgjatë secilës diagonale, deri në gjysmë largësi nga qendra.

D Bëji një vrimë në qendër të kartonit dhe në secilën kënd të katrorit, me qëllim që nxënësit të fusin një gjilpërë me kokë.

Mbaj të shfaqur figurën e helikës me erë gjatë gjithë detyrës, sepse nxënësit do ta kenë më të lehtë kur kanë përpara prodhimin përfundimtar.

1 Punoni me shokun/shoqen e bankës dhe ndihmoni njëri-tjetrin .

- Organizo nxënësit në grupe dyshe sepse kjo është një detyrë delikate. Ata duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin për të ndërtuar nga një freskore për secilin.

Kërkoju nxënësve që të të ndjekin hap pas hapi ndërkohë që ti modelon helikën. Shoqëro çdo veprim me fjalë, pra thuaj udhëzimet me zë të lartë dhe kërkoju nxënësve që ta përsërisin. P.sh. thuaj: Çfarë thashë unë, Beni? Ku e vendosim secilin kënd?

2 Secilin nga skajet e letrës e përkulim në qendër. Për këtë ndihmoni njëri-tjetrin.

- Nxënësit palosin secilin skaj nga poshtë në drejtim të qendrës së kartonit, dhe ndërsa punojnë e mbajnë atë pezull. Njëri e mban atë, ndërsa tjetri bën palosjen.
- Pastaj kërkoju atyre të vendosin një shkop në qendër të helikës, me qëllim që ajo të mbajë katër fletët e përthyera në pozicion.

3 Fikso katër skajet në qendër me anën e një gjilpëre.

- Një nxënës mund të marrë një gjilpërë me kokë, ta fusë atë në qendër dhe ta nxjerrë nga prapa helikës.

4 Ngule gjilpërën e letrës në një shkop.

5 Tani fryji helikës që ndërtove.

- Nxënësit ngulin gjilpërën në një shkop
- Tani nxënësit mund t'i fryjnë helikës.

Kërkoju nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve në libër.

Plotëso fjalitë që përshkruajnë si lëviz helika.

Lëri nxënësit të vëzhgojnë se si sasia e ajrit që fryjnë në helikë ndikon në lëvizjen e saj. Kërkoju atyre të fryjnë pak, pastaj më shumë dhe përfundimisht sa më shumë që të munden. Diskuto vëzhgimet e tyre si grup duke i nxitur të krahasojnë çfarë ndodhi; kërkoja të bëjnë lidhjen ndërmjet fryerjes me pak ajër dhe lëvizjes më të ngadaltë.

Fjalia e fundit është përfshirë për të përforcuar idenë që lëvizja nuk ka të bëjë gjithmonë me lëvizjen nga një vend në një vend tjetër. Pyeti nxënësit:

- A lëviz helika drejt një vendi tjetër kur ti i fryn asaj? *Jo.*
- A mund të përshkruash si lëviz helika? *Ajo lëviz rreth e rrotull (rrotullohet).*

***Përgjigje**:*
Kur i fryj fort, helika lëviz <u>më shpejt</u>.
Kur i fryj ngadalë, helika lëviz <u>më ngadalë</u>.
Helika <u>lëviz</u> duke u rrotulluar, por nuk shkon në një <u>vend</u> tjetër.

Formim gjuhësor

Përdor demostrimin hap pas hapi se si ndërtuat helikën për të përforcuar fjalët kyçe dhe nxitur përsëritjen. Kërkoju nxënësve të shkruajnë sendet që lëvizin nga era në tabelën e fjalëve. Ata mund të përfshijnë fjalë ose fjali të thjeshta për të përshkruar lëvizjen e secilit trup, p.sh. Era shtyn fletët e helikës rreth e rrotull. Era shtyn anijen me vela matanë detit etj.

Veprimtari plotësuese

1. *Helikat mund të ndërtohen në të gjitha format dhe madhësitë.*

Nëse ka kohë të mjaftueshme dhe mjete të nevojshme, klasa mund të ndërtojë një helikë më të madhe.

2. *Kërkoju nxënësve të krahasojnë dy helikat:*

- Si lëviz helika e madhe? *Era vë në lëvizje helikën e tij.*
- A është lëvizja e ndryshme nga ajo e helikës së vogël? *Jo, ajo është e njëjtë.*
- A është më e vështirë ta vësh atë në lëvizje? Është më e vështirë të vësh në lëvizje helikën e madhe. Era duhet të jetë shumë më e fortë që ta vërë atë në lëvizje.

Vëzhgim mbi trupat që lëvizin

Mëson çfarë i bën trupat të përshpejtohen apo të ngadalësohen ose të ndryshojnë drejtim.


Vëzhgim mbi trupat që lëvizin

Mëso çfarë i bën trupat të përshpejtohen, të ngadalësohen ose të ndryshojnë drejtim.

Ideja kryesore

Uji dhe era mund t'i bëjnë trupat të lëvizin.

Uji

Ky djalë po hedh ujë mbi një helikë-lodër.

A mund ta përshkruash se si uji e bën helikën të lëvizë?

Çfarë ndodh kur djali ndalon derdhjen e ujit?

Parashiko se çfarë ndodh kur djali lëshon shumë ujë.

Kur uji bie mbi helikë, e bën atë që të lëvizë.

Uji e shtyn helikën.

70

Vëzhgim: Si do të lëvizin flluskat nga era?

Përgatit pak lëng sapuni dhe një kallam për të fryrë flluska.

Çfarë i bën flluskat të lëvizin në këtë mënyrë?

Pse flluskat ndryshojnë drejtim?

Kur do të lëvizin më shpejt ato?

Kur do të lëvizin më ngadalë ato?

Era i bën flluskat të ndryshojnë shpejtësinë dhe drejtimin e lëvizjes.

Shkruaj çfarë ke përdorur për t'i bërë trupat që të lëvizin.

Çfarë e bën helikën e erës të lëvizë?

Çfarë e bën helikën e ujit të lëvizë?

Shko në faqe 73 për të kontrolluar se çfarë di.

Shtyje dhe tërhiqe

71

Njohuri përgatitore

Në këtë mësim nxënësit vëzhgojnë mënyrat si lëvizin sendet dhe shkakun e lëvizjes. Ata nxiten të përshkruajnë mënyrën sesi uji vë në lëvizje fletët e helikës. Ky mësim tregon se uji dhe era i bëjnë sendet të lëvizin. Nxënësit diskutojnë si dhe pse flluskat ndryshojnë shpejtësinë dhe drejtimin.

Materiale burimore

Rërë pajisje për lodra me ujë, lëng me sapun.

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

hamendëso parashiko

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- Të shqyrtojnë se si era dhe uji i bëjnë sendet të lëvizin.
- Të vëzhgojnë sesi lëvizin flluskat nga era.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të përsërisin dhe reflektojnë çfarë ata kanë mësuar në këtë tematikë.

A mund ta përshkruash se si uji e bën helikën të lëvizë?

Shpjegoju nxënësve se ata mund t'i vënë sendet në lëvizje me anë të ujit. Kërkoju nxënësve të shikojnë foton e djalit që po hedh ujë në helikën e ujit. Kërkoju atyre të diskutojnë dhe përshkruajnë si e vë uji në lëvizje helikën.

Përgjigjje e mundshme: *Uji vë në lëvizje helikën. Uji vë në lëvizje fletën e parë pastaj bie mbi fletën e dytë dhe kështu vë në lëvizje helikën.*

Çfarë ndodh kur djali ndalon derdhjen e ujit?

Kërkoju nxënësve që t'u përgjigjen pyetjeve në libër për të vlerësuar sa kanë kuptuar ato.

Ti mund ta mbështetësh këtë veprimtari duke i nxitur nxënësit të japin përgjigje. Shkruaj një fjali model në tabelë dhe thuaju atyre ta kopjojnë në fletoren e tyre.

Përgjigje*: Ndalon lëvizja e helikës.*

Parashiko se çfarë ndodh kur djali lëshon shumë ujë.

Përdore këtë pyetje për të diskutuar dhe për të zgjeruar njohuritë për mësimin.

Përgjigje e mundshme: *Helikat lëvizin më shpejt.*

Nxirr nga nxënësit se uji shtyn fletët e helikës dhe i bën ato të rrotullohen. Kërkoju nxënësve të diskutojnë se çfarë i bën fletët e helikës të lëvizin më shpejt apo më ngadalë. Pyeti si mund t'i ndalojmë, ndërsa ato lëvizin.

Shpjegoju nxënësve se një helikë e vërtetë uji punon në të njëjtën mënyrë si ajo e erës. Pyeti se si mendojnë ata; se për çfarë mund të përdoret një helikë e tillë. Helika e ujit mund ta transferojë energjinë e ujit te një makineri ose të prodhojë energji elektrike.

Vëzhgim: Si do të lëvizin flluskat nga era?

Qëllimi i këtij vëzhgimi është që nxënësit të shqyrtojnë si lëvizin flluskat nga era dhe të zbulojnë cila forcë i vë në lëvizje (shtytja). Nxënësit do të praktikojnë fjalët kyçe dhe përmes arsyetimit deduktiv dhe diskutimit do të tregojnë sesi era ndryshon drejtimin e flluskave.

Ty të nevojiten: flluska sapuni, shkop.

- Jepi çdo nxënësi mjetet e nevojshme.

Tregoju nxënësve se lëngu i sapunit nuk është i rrezikshëm, por duhet ta shmangni, sepse mund të të djegin sytë.

- Nxirrni nxënësit jashtë klase kështu, ata mund të shqyrtojnë sesi lëvizin flluskat nga era.

Kërkoju nxënësve të diskutojnë pyetjet në libër rreth asaj që ato vëzhguan.

Çfarë i bën flluskat të lëvizin në këtë mënyrë?

***Përgjigje**: Era*

Pse flluskat ndryshojnë drejtim?

***Përgjigje**: Sepse era i fryn ato në drejtime të ndryshme.*

Kur do të lëvizin më shpejt ato?

***Përgjigje**: Ato lëvizin më shpejt kur era i fryn më fort.*

Kur do të lëvizin më ngadalë ato?

***Përgjigje**: Ato lëvizin më ngadalë kur era fryn më lehtë.*

Nëse nxënësit nuk janë të gatshëm për këtë, shpjegoju se era është ajo që ndryshon shpejtësinë dhe drejtimin e flluskave.

Vlerësimi i njohurive

Përdore këtë veprimtari për të matur se sa nxënësit e kanë kuptuar temën.

Shkruaj çfarë ke përdorur për t'i bërë trupat të lëvizin.

***Përgjigje**: Uji, era.*

Çfarë e bën helikën e erës të lëvizë?

***Përgjigje**: Era ose fryma.*

Çfarë e bën helikën e ujit të lëvizë?

Thekso idenë se helikat e ujit i lëviz forca e ujit. Kërkoju nxënësve të sjellin ndërmend si e bënë lodrën të lëvizë. Ata do ta kujtojnë se ishte e nevojshme ta shtynin dhe tërhiqnin lodrën. Pyet nëse shtytja apo tërheqja veprojnë në helikën e ujit.

***Përgjigje**: Uji e shtyn atë.*

Përsëritje dhe përforcim njohurish

Mbylle temën duke u kërkuar nxënësve të përfundojnë përsëritjen në faqen 73 në libër. Shiko gjithashtu shënimin në fund.

Formim gjuhësor

Kërkoju nxënësve të përfundojnë përkufizimet për fjalët kyçe të përdorura në këtë tematikë në fjalorin e tyre, nëse ende nuk e kanë përfunduar. Ti mund t'i ndihmosh ata duke shkruar një shembull në tabelë për përdorimin e fjalës. Referoju "Tabelës së fjalëve" dhe përdor çdo mundësi që t'i rikthehesh mësimit.

Veprimtari plotësuese

Shpjego se duhet t'i fryjnë që trupi të lëvizë.

1. Demonstro se për të bërë një flluskë të madhe duhet të përdorim një shkop më të madh.
2. Lëre nxënësin të shqyrtojë lodrën më rërë në mënyrë që të zbulojë se rëra është një trup tjetër që mund të shkaktojë lëvizjen e helikës. Rëra është e përshtatshme për këtë veprimtari. Ajo punon në mënyrë të ngjashme si uji në helikën e ujit dhe demonstron të njëjtat parime.

Çfarë kemi mësuar rreth shtytjes dhe tërheqjes


Çfarë kemi mësuar rreth shtytjes dhe tërheqjes

Si lëvizin trupat

Trupin tonë e lëvizim duke e shtyrë ose duke e tërhequr.

Në figurë tregohen disa mënyra se si mund ta lëvizësh trupin.

A mund të shoqërosh çdo figurë me fjalën e saktë?

ecja | rrotullimi | kërcimi | lëkundja

Unë di se shtytja dhe tërheqja i bëjnë trupat të lëvizin.

T'i bëjmë trupat të lëvizin më shpejt ose më ngadalë

Si mund t'i lëvizësh këta trupa? Përdorni fjalët e mëposhtme.

të shtyj | të tërheq | të rrotulloj | të fryj

Unë mund ___ ___ ___ ose ___ ___ ___ makinën-lodër.

Unë mund ___ ___ ___ rosën-lodër.

Unë mund ___ ___ ___ robotin-lodër.

Unë mund ___ tullumbacen, që ta lëviz makinën-lodër.

72

Rretho fjalën e saktë:

Sa më shumë t'i shtysh, aq më shpejt / më ngadalë lëvizin trupat.

Unë di si ta përshpejtoj ose ta ngadalësoj lëvizjen e një trupi.

Vëzhgim mbi trupat që lëvizin

Çfarë i lëviz trupat në figurat e mëposhtme?

Shkruaj fjalën e saktë për çdo figurë.

era | uji

Unë di se, kur një trup lëviz , një shtytje ose tërheqje e ka vënë atë në lëvizje.

Shtytje dhe tërheqje

73

Njohuri përgatitore

Qëllimi i kësaj pjesë është të nxitë nxënësit të përsëritin njohuritë e fituara në çdo temë mësimore të këaj tematikë. Çdo temë ka disa pyetje përforcuese, të cilave nxënësi duhet t'u përgjigjen. Këto janë pyetje që do të vlerësojnë njohuritë e nxënësit si dhe do të tregojnë të kuptuarin e temave nga ana e tij/saj.

Pas çdo grupi pyetjesh përforcuese ka disa formulime për përsëritje dhe reflektim, të cilave nxënësit duhet t'u përgjigjet.

Është e nevojshmë të lexosh formulimet dhe t'i ndihmosh nxënësit të plotësojnë rrethin e vetëvlerësimit, për të parë kështu se sa të sigurtë janë ata për njohuritë e fituara në temën mësimore.

Në klasën e parë nxënësit mund të ngjyrosin një fytyrë të qeshur apo të trishtuar për të treguar nivelin e tyre të sigurisë ose mund të vënë një shenjë vlerësimi, si p.sh. shenjën V.

Është e rëndësishme që nxënësit të tregojnë pjesët, në të cilat ata nuk ndjehen të sigurtë. Ky informacion është shumë i rëndësishëm për mësuesin dhe mundëson që të ofrosh ndihmën e nevojshme në vlerësimin përmbledhës (rubrika Vlerësimi i përmbledhës) në fund të tematikës.

Përsëritje dhe reflektim për njohuritë

Si lëvizin trupat

Nxënësit janë familjarizuar me shtytjen dhe tërheqjen. Pyeti nxënësit çfarë kanë ndjerë kur janë shtyrë ose përplasur; përpiqu të fusësh idenë e "fuqisë" dhe "forcës". Ata do të mësojnë më vonë se forca ka një kuptim të veçantë në fizikë. Lidh sëbashku idenë e "forcës" dhe "lëvizjes".

Në figurë tregohen disa mënyra se si mund ta lëvizësh trupin. A mund të shoqërosh çdo figurë me fjalën e saktë?

Kërkoju nxënësve të kujtojnë disa mënyra të lëvizjes së trupit në këtë temë. Nëse ata nuk mbajnë mend fjalët, pyeti për lëvizjet dhe shkruaj fjalën për secilën lëvizje në tabelë. Thuaje fjalën më zë të lartë dhe kërkoju nxënësve ta përsërisin atë.

- Sigurohu që nxënësit të kryejnë të gjitha lëvizjet e nevojshme për këtë veprimtari. (hedhja, ecja, lëkundja, rrotullimi).
- Ti mund ta zgjatësh veprimtarinë duke pyetur nxënësit nëse ata përdorin shtytjen, tërheqjen ose të dyja për secilën lëvizje. P.sh.:
- Si mund të kërcesh lart? A përdor forcën e shtytjes apo tërheqjes? *Përgjigjje e mundshme: Unë shtyj trupin tim.*
- Si ecën? Përdorni forcën e shtytjes apo tërheqjes? *Përgjigjje e mundshme: Unë i shtyj këmbët përpara dhe me tërheqje i kthej pas.*
- Si i lëkund krahët? A përdor forcën e shtytjes apo tërheqjes? *Përgjigje e mundshme: Unë i shtyj krahët përpara dhe pastaj i tërheq.*
- Si vërtitesh rrotull? Përdorni forcën e shtytjes apo tërheqjes? *Përgjigjje e mundshme: Unë e shtyj trupin duke e rrotulluar.*

***Përgjigje**: hedhja, ecja, rrotullimi, lëkundja.*

Ti bëjmë trupat të lëvizin më shpejt ose më ngadalë

Si mund t'i lëvizësh këta trupa? Përdorni fjalët e mëposhtë?

Kërkoju nxënësve të shikojnë fotot dhe të përfundojnë fjalinë si e bëjnë lodrën të lëvizë.

Dy të parat janë thjesht "shtytja"'dhe "tërheqja". Për dy lodrat e tjera kërkoju nxënësve të tregojnë forcën shtytëse që vjen te lodra tullumbace dhe robotilodër. Nxënësit i kanë hasur të gjitha lodrat gjatë të mësuarit të kësaj teme, prandaj janë në gjendje të përgjigjen me pak nxitje.

Qartëso se fuqia dhe forca vënë në forma të ndryshme sendet në lëvizje. Kjo të çon në tematika të tjera, ku nxënësit do të mësojnë për fuqinë e erës dhe të ujit.

***Përgjigje**: Unë mund të shtyj dhe të tërheq makinën- lodër.*

Unë mund ta tërheq rosën-lodër.

Unë mund rrotulloj robotin-lodër.

Unë mund të fryj tullumbacen, që ta lëvizë makinën lodër.

Rretho fjalën e saktë.

Vazhdo me temën e "forcës dhe lëvizjes" duke u kërkuar nxënësve të rikujtojnë si e bënë makinën-lodër të lëvizë më shpejt apo më ngadalë. Qartëso idenë se një forcë e madhe (shtytje ose tërheqje e madhe) dhe një forcë e vogël (shtytje ose tërheqje e vogël) i bëjnë trupat të lëvizin më shpejt ose më ngadalë.

***Përgjigje**: Më shumë shtytje i bën trupat të lëvizin më shpejt.*

Vëzhgim mbi trupat që lëvizin

Çfarë i lëviz trupat në figurat e mëposhtme? Shkruaj fjalën e saktë për çdo figurë.

Kërkoju nxënësve të rikujtojnë si kanë lëvizur trupat në këtë temë. p.sh:

- A mund të rikujtoni kush e lëvizte varkën me vela? Era.

Përdor pyetje për të nxjerrë se era dhe uji mund t'i lëvizin sendet. Nxënësit mund të jenë të interesuar të mësojnë se era dhe uji janë burimet më të hershme përpara se të zbulohej elektriciteti dhe nafta.

Pastaj kërkoju nxënësve të shikojnë figurat dhe të shkruajnë përgjigjet në libër.

***Përgjigje**: Era, uji.*

Vazhdo veprimtarinë duke u kërkuar nxënësve nëse mund të shikojnë fuqinë e ujit në det ose në lumë. Përdor në diskutim fjalën "forcë" .

A mund ta shohin ata fuqinë e ajrit?

Diskuto dhe thekso që ata e shohin ose e ndjejnë ndikimin, por era është e padukshme. Ti gjithashtu mund të sjellësh si shembull elektricitetin që është i padukshëm dhe i fuqishëm. Ideja vepruese e forcave të padukshme është e rëndësishme në fizikë.

Vlerësim përmbledhës

Formulimet për përsëritje dhe reflektim në librin e nxënësit janë një pikënisje e përkryer kur diskutohet për përparimin individual të çdo nxënësi. Ky informacion mund të përdoret gjithashtu për të krijuar një raport për çdo nxënës në fund të vitit shkollor.

Ai gjithashtu mund të jetë i dobishëm për të mbajtur një regjistër (vlerësimi) për të gjithë klasën për nivelin e përgjithshëm të sigurisë duke identifikuar çfarë mund të kenë nevojë të rishikohet më vonë (shih një shembull në tabelën e mëposhtme).

Formulimi për përsëritje dhe reflektim	Shumë i/e sigurt	Jo aq i/e sigurt	Jo i/e sigurt

Kjo analizë (apo ky feedback) mund të përdoret më pas për të formuar një program përmirësimi (program rehabilitimi), i cili do të shërbejë për të ndihmuar nxënësit që të përmirësohen në të ardhmen.

Thjesht mbaj dhe ruaj regjistrimin e të dhënave dhe analizën e vetëvlerësimeve të nxënësve.

Kërkohet një përshtypje e përgjithshme e vetë-vlerësimit të klasës, jo një regjistrim i vlerësimit individual të nxënësve (të dhëna individuale). Kjo është gjithçka që të duhet. P.sh.: pesëdhjetë përqind e klasës nuk ishin të sigurtë në lidhje me ...

6 Prodhimi i tingujve

Në këtë tematikë nxënësit:

- Identifikojnë burime të ndryshme dhe të shumta tingujsh;
- Kuptojnë që kur tingulli largohet nga burimi, ai dobësohet;
- dinë që ne dëgjojmë kur tingulli futet në vesh.

Njohuri përgatitore

Kjo është tematika që paraqet tingullin. Nxënësit me vështirësi dëgjimi do të kenë nëvojë për mbështetje të veçantë. Tingulli shtjellohet më tej në Fazën 4, Tematika 6, dhe dëgjimi gjithashtu trajtohet në Etapën 3, Temaika 5, Shqisat. Ky mësim fillon duke u kërkuar nxënësve të mendojnë për numrin e shumtë të tingujve që ata mund të prodhojnë; pastaj kërkoju të mendojnë për tingujt që prodhojnë kafshë të ndryshme dhe pse ato i lëshojnë këto tinguj.

Mësimi pasardhës përqëndrohet më me hollësi në idenë se kafshët komunikojnë. Nxënësit mësojnë se si ne mund të këndojmë dhe flasim me anë të zërit tonë.

Pastaj nxënësit mendojnë për larminë e madhe të tingujve. Pasi të keni diskutuar tingujt që hasen në jetën e përditshme tregoju nxënësve se në muzikë janë tingujt që prodhojmë dhe na pëlqejnë.

Nxënësit gjithashtu mësojnë se si ndryshon tingulli gjatë lëvizjes. Ata mësojnë se këmbët e kafshëve grabitqare janë përshtatur për ta zvogëluar tingullin që bëjnë kur zvarriten, për t'u hedhur mbi prenë e tyre. Pastaj diskutohet fakti që tingulli lëviz në largësi të gjata.

Në fund nxënësit mësojnë për mënyrat sesi i dëgjojmë ne tingujt. Ata mësojnë se si tingulli nga burimi i tij hyn në vesh. Nxënësit marrin me mend apo parashikojnë se si sirenat na paralajmërojnë ne për rrezikun, cila kafshë prodhon më shumë tinguj kur lëviz. Pastaj përdorin idetë e tyre për të projektuar këmbët e një kafshë grabitqare dhe të një preje. Gjithashtu tregoju nxënësve se si përdoret tingulli në sigurinë rrugore dhe se si sirenat përdoren për të na paralajmëruar ne për një rrezik.

Materiale burimore

Foto të sfungjerit.

Fjalë kyçe

Dëgjo zhurmë i ulët tingull zë

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

Vizato

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të diskutojnë rreth tingujve që mund të prodhojnë;
- të mendojnë pse kafshët prodhojnë tinguj.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të mësojnë rreth burimeve të ndryshme të tingujve.

Sa tinguj mund të prodhosh?

Kërkoju nxënësve të bëhen në grupe dyshe dhe të mendojnë se çfarë lloj tingujsh janë në gjendje të bëjnë, p.sh. të flasin, këndojnë etj.

Kujtoju atyre se mund të prodhojnë tinguj me çdo pjesë të trupit.

Ndrroi grupet dhe kërkoju të përpiqen të shohin nëse ka mundësi të tjera. Grupet do të shkëmbejnë përgjigjet e tyre me të gjithë klasën. Thekso se vetëm tingujt që ndihen do të diskutohen. Nxënësit mund të fishkëllejnë ose të zukasin.

Përgjigje e mundshme: *fishkëllima, e folura, ecja, duartrokitja, kërcitja etj.*

Pse kafshët prodhojnë tinguj?

Udhëzo nxënësit të shikojnë foton e majmunit. Kërko të diskutojnë më shokun/shoqen pse kafshët bëjnë zhurmë.

Thekso se edhe ne jemi qënie të gjalla dhe, nëse ata nuk janë të sigurt për majmunin, kërkoju të mendojnë pse bëjmë ne zhurma.

Përgjigje e mundshme*: Për të komunikuar me njëra-tjetrën siç bëjmë ne.*

Si mendoni për çfarë komunikon majmuni?

Përmes diskutimit ndihmoi të tregojnë se çfarë mund të thotë majmuni. Ai duket i frikësuar ose i inatosur, kështu që mund të jetë duke paralajmëruar majmunët e tjerë për një rrezik të mundshëm.

Përgjigje e mundshme: *Ikni! / ndihmë!*

Kujt po i thërret ai?

Nxënësit do ta kuptojnë se vetëm një majmun tjetër mund ta kuptojë, prandaj ai po përpiqet të tërheqë vëmëndjen e tyre. Ka shumë përgjigje të tjera për këtë; qëllimi në këtë fazë është që nxënësit të bëhen të vetëdijshëm se kafshët mund të komunikojnë.

Përgjigje e mundshme: *Majmunët e tjerë.*

Fakt interesant

Referoju faktit interesant. Nxënësit nuk mund ta kuptojnë se sfungjeri është një gjallesë. Pasi t'ua kesh shpjeguar këtë, bëju me dije se ajo nuk prodhon tinguj për të komunikuar. Për të zgjeruar njohuritë e nxënësve ti mund t'u kërkosh të mendojnë pse sfungjeri nuk prodhon asnjë zhurmë. Që t'i ndihmosh ato ta kuptojnë këtë, kryej kërkime se ku jetojnë sfungjerët. Sfungjerët e detit janë "ushqyesit filtër", që do të thotë se ato ushqehen me mikrogjallesa rreth tyre në det.

Formim gjuhësor

Përdor fjalët kyçe në fillim të mësimit që të njihen me kuptimet e tyre. Nxënësit mund të fillojnë "Tabelën e fjalëve" për tematikën (shiko faqe 7). Nxiti ato të përfundojnë hedhjen e fjalëve në rubrikën "Fjalori shpjegues", që t'i mundësosh të përkufizojnë termat kryesore me fjalët e tyre. Termi kryesor "tingull" përshkruhet dhe trajtohet gjerësisht në mësimin pasardhës.

Veprimtari plotësuese

1. Kërkoju nxënësve të pikturojnë një sfungjer dhe mjedisin ku jeton. Sigurohu që nxënësit të kenë paraprakisht disa foto të sfungjerit në mjedisin ku jeton.
2. Nëse në zonën tuaj ka një kopësht zoologjik ose fermë, ti mund të organizosh një vizitë. Kjo u jep mundësi nxënësve të njihen me kafshët dhe zhurmat e tyre.

Mos harro t'u kërkosh leje prindërve dhe të ndjekësh të gjitha procedurat e sigurisë për marrjen e nxënësve në udhëtime jashtë shkolle.

Flasim dhe dëgjojmë

Emërton disa nga burimet e tingujve.


Flasim dhe dëgjojmë

Emërto disa burime tingujsh.

Ideja kryesore

Kafshët komunikojnë me njëra-tjetrën.

Sa tinguj mund të prodhosh me **zërin** tënd?

Shumica e kafshëve lëshojnë **tinguj**.

Thuaj emrin e një kafshe që nuk lëshon tingull gjatë komunikimit.

Shumica e kafshëve prodhojnë tinguj për të komunikuar me njëra-tjetrën.

Pse flasim ne?

Ne flasim me njëri-tjetrin për të shkëmbyer idetë.

Disa kafshë bëjnë zhurmë për të paralajmëruar rrezikun.

Disa kafshë bëjnë zhurmë për të trembur kafshët e tjera.

Njerëzit dhe disa kafshë mund të këndojnë.

Pse këndojnë?

Zogjtë këndojnë për të dërguar informacione.

Njerëzit këndojnë për shumë arsye të ndryshme.

Muzika i gëzon njerëzit.

Atyre u pëlqen ta **dëgjojnë** atë.

Sa vegla muzikore njeh?

Mendo rreth...

Përfytyro se sa shumë tinguj janë në botë.

Fakt interesant

Njerëzit mund të dëgjojnë vetëm disa tinguj. Kandrat mund të dëgjojnë më shumë tinguj se ne.

Prodhimi i tingujve

76

77

Njohuri përgatitore

Ky mësim shtjellon më tej idenë që qëniet njerëzore dhe kafshët komunikojnë. Nxënësit mësojnë se si mund të flasim dhe të këndojmë duke përdorur vetëm zërin. Ata gjithashtu mund të shqyrtojnë tinguj të tjerë që ne mund të bëjmë me trupin tonë, si fishkëllima dhe duartrokitja. Në fund nxënësit mund të marrin pjesë në një konkurs për të dalluar tingujt e kafshëve. Qëllimi i kësaj veprimtarie është për të nxitur nxënësit të kuptojnë më shumë rreth burimeve të ndryshme të tingujve. Nxënësit mësojnë më shumë pse kafshët prodhojnë tinguj (p.sh. për të komunikuar gëzim, trishtim, kërkuar ushqim, paralajmëruar një rrezik). Nxënësit mund të reflektojnë se sa të ngjashme janë komunikimet e tingujve ndërmjet gjallesave duke na përfshirë edhe ne.

Materiale burimore

Inçizime të njerëzve duke folur dhe kënduar; inçizime të zhurmave të kafshëve; tinguj që ndeshen në jetën e përditshme për identifikim në konkurs; vegla muzikorë.

Fjalë kyçe

tinguj zë

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- Të mësojnë si mund ta përdorë trupin për të prodhuar tinguj të ndryshëm.
- Të mësojnë se kafshët prodhojnë tinguj dhe të hamendësojnë pse ndodh kjo.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të mësojnë se njerëzit përdorin trupin e tyre për të prodhuar duartrokitje dhe fishkëllima.

Sa tinguj mund të prodhosh me zërin tënd?

Kërkoju nxënësve të diskutojnë rreth pyetjes në libër. Nxiti nxënësit në dyshe të bëjnë tinguj me zërat e tyre. Diskuto tingujt për secilën dyshe dhe shënoi në tabelë.

Kjo është një mundësi e mirë që nxënësit të rikujtojnë çfarë kanë mësuar në mësimin e shkrim-leximit, p.sh. çdo shkronjë e alfabetit ka tingullin e vet ose se ndodh kombinimi i tingujve kur shkronjat bashkohen. Ftoi nxënësit të tregojnë çfarë tingujsh të tjerë të ulët, të lartë mund t'ju kujtohen nga mësimi i gjuhës shqipe, p.sh. "o" dhe "e".

Përgjigje e mundshme: *Këndoj, flas, zukat, qesh, fishkëllej, psherëtij, kërcitje.*

Thuaj emrin e një kafshe që nuk lëshon tingull gjatë komunikimit.

Kjo rubrikë ka si qëllim që t'u kujtojë nxënësve çfarë kanë mësuar në temën hyrëse të kapitullit. Kërkoju nxënësve të shkruajnë përgjigjet në fletore.

Thekso se shumica e kafshëve prodhojnë tinguj për të komunikuar. Janë disa kafshë, si krimbat dhe sfungjeri, që nuk komunikojnë në këtë mënyrë.

Përgjigje*: Sfungjeri.*

Pse flasim ne?

Kërkoju nxënësve të tregojnë pse ne flasim me njëri-tjetrin. Shpjegoju se ne flasim që të shkëmbejmë ide dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin. Lëri nxënësit të inçizojnë tingutj e njerëzve që këndojnë, bisedojnë, qeshin dhe qajnë. Pyeti nxënësit:

- Çfarë tingujsh bëjnë familjarët tuaj me zërin e tyre?

Fol rreth rasteve kur nxënësit kalojnë kohën duke biseduar me familjarët e tyre, p.sh. gjatë vakteve të ushqimit. Njerëzit kanë aftësi të punojnë sëbashku si një skuadër, për shkak se ne bisedojmë; kjo është ajo çka na bën ne të suksesshëm.

***Përgjigje e mundshme**: Për të komunikuar me njëri-tjetrin.*

Disa kafshë nxjerrin tinguj për të paralajmëruar të tjerët për një rrezik ose për të friksuar kafshët e tjera që mund t'i lëndojnë ato. Në këtë fazë mundësoju nxënësve të dëgjojnë pjesë të inçizuara ose video klipe me tinguj kafshësh. Kërkoju nxënësve të identifikojnë secilën kafshë ose të thonë se çfarë mendojnë ata se po komunikon kafsha.

Pse këndojnë?

Shpjego se njerëzit dhe kafshët mund të këndojnë. Kërkoju nxënësve të diskutojnë pse ne këndojmë. Bisedo se kur kanë dëshirë njerëzit të këndojnë ose nxjerrin tinguj muzikorë më zërin e tyre. Thekso që disa qenie të gjalla, p.sh. zogu këndon për të përcjellë një informacion te zogjtë e tjerë. Ata përdorin të kënduarit ashtu si ne përdorim të folurin për të komunikuar. Si qënie njerëzore ne këndojmë kur jemi të gëzuar apo kur jemi të mërzitur, ose kur dëgjojmë këngët e parapëlqyera. Kjo nuk është forma jonë kryesore e komunikimit, por është një mënyrë tepër e fuqishme për të shprehur emocionet.

Ndaj klasën në dy grupe. Shpjegoju atyre që ato do të mësojnë si të këndojnë dhe të duartrokasin sipas një ritmi dhe si ndikon kjo "në mesazhin" e këngës. Kërkoi grupit të parë të nxënësve të këndojnë një këngë që ti përzgjedh (parapëlqehet një këngë e njohur për nxënësit). Kërkoi grupit të dytë ta shoqërojnë këngën sipas ritmit më duartrokitje.

Ndërsa grupi i parë këndon, grupi i dytë rrit ritmin e këngës duke duartrokitur shpejt e më shpejt. Këngëtarët duhet të përpiqen të ndjekin ritmin e duartrokitjeve. Pas kësaj pyeti nxënësit si u ndjenë më të kënduarit me ritëm të shpejtë:

- A ju bëri të ndjeheni të gëzuar apo të trishtuar të kënduarit më shpejt? *Rritja e ritmit zakonisht ka ndikim dhe i bën njerëzit më të gëzuar.*

***Përgjigje e mundshme**: Për kënaqësi.*

Formim gjuhësor

Fillo me fjalët e reja dhe krijo "Tabelën e fjalëve"; kështu nxënësi do t'i shikojë shpesh fjalët kyçe dhe do të familjarizohet me to. Përdor ku të jetë e mundur piktura për fjalët në "Tabelën e fjalëve". Përfshi nxënësit në krijimin dhe mirëmbajtjen e saj.

Thekso fjalët kyçe që përdoren për tingujt që krijohen me zë dhe jep shembuj të tyre. Kontrollo që nxënësit të kuptojnë ndryshimet midis tyre, p.sh. duke folur, duke kënduar, duke qeshur, duke duartrokitur. Përshtati tingujt e ndryshëm kur thua fjalët.

Për të përforcuar njohjen me fjalët e reja kërkoju nxënësve t'i dëgjojnë, lexojnë, thonë, dhe pastaj t'i shkruajnë fjalët.

Kërkoju nxënësve të shënojnë përkufizimet për kuptimin e fjalëve kyçe "tinguj" dhe "zë".

Nxënësit mund të përdorin një magnetofon për të regjistruar dhe ruajtur këngët, bisedat e njerëzve dhe komunikimet ndërmjet kafshëve, si dhe tingujt që prodhojnë më zërin e tyre.

Veprimtari plotësuese

1. Nxënësit mund të kryejnë një studim për të gjitha kafshët e ndryshme që ata dëgjojnë se nxjerrin tinguj, p.sh. në parkun e qytetit.
2. Kërkoju nxënësve të bëjnë një pikturë të familjes së tyre duke biseduar sëbashku, duke shënuar në një rreth sipër secilit, fjalët që ato thonë.

Flasim dhe dëgjojmë

Emërton disa nga burimet e tingujve.

Njohuri përgatitore

Në këtë mësim nxënësit mësojnë se ne mund të prodhojmë tinguj me trupin tonë . Ata diskutojnë për disa mënyra të tjera që ne përdorim për të komunikuar, si duke fishkëlluar dhe duke duartrokitur. Kështu ata mësojnë që këto nuk janë tinguj që i nxjerrim me zë, por tinguj që i prodhojmë me trupin tonë. Në fund nxënësit marrin pjesë në një konkurs për tingujt e kafshëve.

Materiale burimore

Video klip të pjesëmarrësve që po duartrokasin në një takim; konkurs për tingujt e kafshëve, marrë nga interneti; (ose zhvilloje vetë konkursin); regjistrime tinguj kafshësh; letra me figura kafshësh shoqëruar me fjalë për tingujt që ato prodhojnë.

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

Shkruaj /vizato

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- Të zbulojnë se si mund ta përdorin trupin e tyre për të prodhuar tinguj të ndryshëm;
- Të zbulojnë se kafshët mund të prodhojnë tinguj.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të mësojnë për tinguj të ndryshëm që i rrethojnë duke marrë pjesë në një shëtitje dëgjimore.

Çfarë po bëjnë sportistët?

Kërkoju nxënësve të shohin foton në libër. Thekso që ne mund të bëjmë disa tinguj me trupin tonë. Fishkëllima është një tjetër tingull që ne mund të prodhojmë. Pastaj ato duhet t'i përgjigjen pyetjes në libër për çfarë arsye mendon që njerëzit fishkëllejnë?

***Përgjigje**: Fishkëllen.*

Si mendon, pse njerëzit fishkëllejnë?

Drejto pyetje për të treguar që gruaja në foto është një sportiste; shpjegoju që disa sportistë fishkëllejnë për t'i tërhequr vëmendjen lojtarëve të tjerë. Të tjerët fishkëllejnë për shkak se ndjehen mirë.

***Përgjigje e mundshme:** Për kënaqësi, për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve.*

Vëzhgim: Çfarë tingujsh mund të prodhosh?

1 Prodho disa tinguj me trupin tënd.

- Kërkoju nxënësve të bëjnë sa më shumë tinguj me trupin e tyre; thekso se do të diskutohet vetëm për tingujt e përshtatshëm.

Kërkoju nxënësve të shkëmbejnë emërtimet e tingujve që kanë bërë. Nëse i dinë emërtimet e tyre, kërkoju të bëjnë një demonstrim të tingujve, pastaj tregoju emrin e secilit tingull dhe shkruaje në tabelë. Krijo një listë me të gjithë tingujt që nxënësit prodhuan me trupin e tyre.

2 Mundohu të fishkëllesh. Bashkoji buzët dhe fry lehtë. A mund të fishkëllesh një melodi?

- Drejto pyetjen: Amund të fishkëllesh? Tregoju nxënësve si të fishkëllejnë. Kërkoju të fishkëllejnë më lehtë dhe më fort për të prodhuar tinguj.
- Është e vështirë të mësosh të fishkëllesh. Kërkoju nxënësvë të vazhdojnë të përpiqen dhe tregoju që ata duhet të praktikojnë të fishkellejnë lehtë dhe jo fort.

3 Përpjasi duart me njëra-tjetrën.

- Tregoju nxënësve pamjen në libër. Shpjego që ky person po duartroket, dhe se ky është një tingull tjetër që ne mund të prodhojmë duke përdorur trupin tonë.

Tani kërkoju nxënësve të duartrokasin lehtë dhe pastaj më fort. Diskuto se çfarë ndodhi me tingullin që ata prodhuan. Drejto nxënësit të japin përgjigjen

se duke duartrokitur më fort zhurma që prodhohet është më e lartë.

Çfarë ndodh kur ti duartroket fort?

Përgjigje e mundshme: *Ti prodhoni një tingull të lartë.*

Çfarë ndodh kur ti duartroket lehtë?

Përgjigje e mundshme: *Ti prodhon një tingull të ulët.*

4. Dëgjo ritmin e duartrokitjeve të mësuesit. A mund ta imitosh atë?

- Duartrokit një ritëm dhe kërkoju nxënësve ta imitojnë atë.
- Provo ritme të ndryshme.
- Kërkoju nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve që janë në librin e nxënësit.

Kur mund të përdorësh një tingull me duartrokitje?

Kërkoju nxënësve të diskutojnë se kur mund të përdorin një tingull duartrokitje. Tregoju atyre një video klip të njerëzve që duartrokasin në një shfaqje teatrale apo një koncert.

Përgjigje e mundshme: *Të duartrokasësh në fund të një koncerti apo kur ndodh diçka që të pëlqen.*

Mendo çfarë tingulli prodhojnë këto kafshë.

Organizo një mini-konkurs për tingujt e kafshëve. Inçizo tinguj nga TV apo radioja ose përdor një nga mini-konkurset që ndodhet në internet. Kërkoju nxënësve të dëgjojnë me vëmendje tingujt e kafshëve dhe të përpiqen të gjejnë se çfarë kafshe është ajo. Kërkoju nxënësve të shënojnë përgjigjet e tyre në një tabelë si më poshtë. Plotëso përgjigjen e parë që nxënësit ta kenë si shembull.

Numri i tingullit	Kafsha
1	miu
2	macja
3	majmuni

Ti mund të shfaqësh pamjet e disa kafshëve që t'i ndihmosh në njohjen e kafshëve, me emrin dhe gjuhën.

Pastaj kërkoju nxënësve të emërtojnë kafshët në fotot që ndodhen në librin e nxënësit dhe të gjejnë tingullin që ata prodhojnë.

Përgjigje*: Përgjigje si për veprimtarinë me shkrim që vijon.*

Plotëso vendet bosh duke përdorur fjalët "i lartë" dhe "i ulët".

Këkoju nxënësve të shkruajnë tingullin e secilës kafshë në fotot e paraqitura në libër.

Jepu formimin gjuhësor që nevojitet për të ditur si quhen tingujt e kafshëve: luaj në magnetofon secilin tinguj, pastaj thuaj emrin e secilit tingull; shkruaje atë në dërrasë dhe kërkoju nxënësve ta përsërisin fjalën.

Përgjigje*: a) trumpetoj, b) kërcet, c) mjaullin, d) pëllet.*

Formim gjuhësor

Shto piktura kafshësh në "Tabelën e fjalëve" të klasës. Nxënësit mund të shtojnë etiketa me emrin e secilës kafshë dhe të tingullit që ajo bën.

Luaj një lojë të ngjashme duke përdorur karta të gatshme që përmbajnë piktura kafshësh në njërën anë dhe emrat e tyre në anën tjetër.

Shfrytëzoje këtë mundësi për të përforcuar fjalët kyçe të veprimtarisë shkencore. Drejto pyetje të tilla, si: Cili është emri i kësaj kafshe? A mund ta emërtosh tingullin që ajo nxjerr?

Veprimtari plotësuese

Jepu nxënësve udhëzime që të kryejnë një punë tjetër vëzhguese: A mund të dëgjosh tinguj që vijnë nga prapa shpine? Puno me një shok/shoqe. Qëndro pa lëvizur dhe me sy të mbyllur. Partneri yt duhet të qëndrojë në pozicione të ndryshme përreth jush dhe të duartrokasë. A tingëllon duartrokitja njëlloj nga të gjitha drejtimet?

Tingujt dhe lëvizja

Zbulon çfarë ndodh me tingujt kur ne lëvizim.


Tingujt dhe lëvizja

Zbulo se çfarë ndodh me tingujt, kur ne lëvizim.

Ideja kryesore

Tingujt ndryshojnë kur u afrohemi dhe kur largohemi prej tyre.

Dëgjo mësuesin kur ai largohet.

Çfarë ndodh me tingullin, kur mësuesi largohet shumë prej teje?

A të kujtohet prova e shëtitjes në mjedisin e shkollës?
Për të kapur disa tinguj duhet dëgjuar me shumë kujdes.

Kur largohemi nga vendi ku prodhohet tingulli, ai dëgjohet më dobët.

80

Këtë ti mund ta provosh duke bërë një lojë.

Vëzhgim: Çfarë ndodh me tingujt, kur ti largohesh prej tyre?

1. Dil në një shesh të hapur.
Një nxënës/e qëndron në qendër me sytë mbyllur.
Ai/ajo është dëgjuesi.
2. Vendosu në një pikë të rrethit përqark dëgjuesit.
Qëndro sa më larg që të jetë e mundur.
3. Afrohu shumë qetësisht drejt dëgjuesit,
i cili dëgjon me shumë kujdes.

Nëse ai/ajo do të dëgjojë një tingull,
do të kthehet nga ti.
Nëse ai/ajo të ka dëgjuar, ti del jashtë loje.
Vendos cili do të qëndrojë i pari në qendër.

Mat sa larg je kur dëgjuesi të ka dëgjuar.

Cili nga nxënësit ndodhet
më afër dëgjuesit? Pse?

Fushimi i tingujve

81

Njohuri përgatitore

Në këtë mësim nxënësit mësojnë se tingulli ndryshon kur lëviz. Nxënësit luajnë një lojë dëgjimore e cila demonstron se, kur i afrohemi burimit tingulli bëhet më i lartë, dhe kur i largohemi bëhet më i ulët. Nxënësit matin largësinë deri ku mund ta dëgjojnë tingullin, duke matur sa larg janë kur nxënësi tjetër e dëgjon atë.

Materiale burimore

Letër, lapsa, metër shirit, fletë të mëdha letre ose karton.

Fjalë kyçe

i lartë i ulët

Fjalë kyçe për hulumtimin shkencor

hamendëso parashiko

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- të vëzhgojnë se si tingulli bëhet më i ulët kur ti largohesh nga burimi;
- të krahasojnë se si kafshët e ndryshme lëvizin me qetësi.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit mësojnë si e dëgjojmë tingullin kur hyn në veshët tanë.

Çfarë ndodh me tingullin, kur mësuesi/ja largohet shumë prej teje?

Kërkoju nxënësve të rikujtojnë shëtitjen dëgjuese të mësimit të fundit. Kujtoi ata për disa nga tingujt që kishin dëgjuar me vëmendje.

Vazhdo me shpjegimin se kur ju lëvizni larg nga burimi ku është prodhuar tingulli ai bëhet më i ulët dhe më i vështirë për ta dëgjuar. Thekso se disa tinguj dëgjohen më të lartë se disa të tjerë.

Përgjigje e mundshme: *Tingulli dëgjohet më i ulët.*

Për të përforcuar njohjen me fjalët e reja, të tilla fjalë si "më e ulët", kërkoju nxënësve ta dëgjojnë, thonë, lexojnë dhe pastaj ta shkruajnë.

Vëzhgim: Çfarë ndodh me tingujt, kur ti largohesh prej tyre?

Qëllimi i këtij vëzhgimi është që nxënësit të zbulojnë se tingulli sa më shumë largohet nga burimi aq më i ulët bëhet dhe sa më afër burimit aq më i lartë bëhet. Nxënësit do të praktikojnë fjalët kyçe të veprimtarisë shkencore të dëgjimit dhe regjistrimin e fakteve me të cilët ndeshen.

Ty të nevojiten: shesh i hapur.

Udhëzo nxënësit që ne mund të vëzhgojmë tingujt duke bërë një lojë dëgjimore. Përdor sa më shumë hapësirë që të jetë e mundur. Informo përdoruesit e tjerë që ti po realizon një lojë dëgjimore dhe kërkoju të mbajnë qetësi sa më shumë që të jetë e mundur gjatë kësaj kohe. Kjo do të sigurojë që tingujt nuk ndoten apo shkëputen nga zhurmat e tjera.

Sigurohu që hapësira është e lirë nga trafiku apo nga ndonjë rrezik tjetër.

1 Dilni në një shesh të hapur.

- Zgjidh një person që të qëndrojë në qendër me sy mbyllur. Ai do të jetë dëgjuesi; siguro që secili nga nxënësit të ketë mundësi ta praktikojnë rolin e dëgjuesit.

2 Vendosu në një pikë të rrethit përqark dëgjuesit që të jetë e mundur.

3 Afrohu shumë qetësisht drejt dëgjuesit.

- Dëgjuesit duhet të dëgjojnë me shumë vëmendje me sy të mbyllur ose me sy të lidhur me shirit. (Të jesh i/e vetëdijshëm/e se disa

nxënësve nuk u pëlqen t'ua lidhësh sytë. Kjo gjë është e pranueshme, për aq kohë sa ato përpiqen të shikojnë fshehurazi). Nëse dëgjojnë tinguj, ata duhet të kthehen menjëherë dhe të bëjnë me gisht në drejtimin nga vjen zëri, duke hapur sytë. Nëse shikojnë një nxënës duke lëvizur, nxënësi del jashtë.

- Personi që del nga rrethi bëhet dëgjuesi. Loja vazhdon përsëri.
- Në fund krahasoje lojën me mënyrën se si kafshët grabitqare gjurmojnë prenë e tyre.

Matni sa larg je kur dëgjuesi të ka dëgjuar.

Tregoju nxënësve si të përdorin një metër shirit apo një metër shufër për të matur largësinë nga dëgjuesi te personit që ata dëgjuan. Shëno rezultatet në stendën e klasës. Në fund të lojës kontrollo rezultatet dhe shiko se cili dëgjues dëgjoi tingullin më të largët dhe cili dëgjoi më të afërtin.

Cili nga nxënësit ndodhet më afër dëgjuesit?

Pas mbarimit të lojës diskuto me nxënësit pse në fillim nuk "u kapën" shumë persona. Kjo për shkak se sa më larg që të jeni aq më i ulët është tingulli. Kur u afruan më afër dëgjuesit, u kapën më shumë persona, në veçanti në rastin kur nxënësit kishin mbathur këpucë më të rënda se të tjerët.

Kërkoju nxënësve të diskutojnë pyetjen në libër. Pyeti ata nëse këpucët e disave bënë më shumë zhurmë se të tjerëve, duke parë këpucët që kishte mbathur secili. Kërko që nxënësit që dalin vullnetarë e të ecin përgjatë dhomës, ndërsa të tjerët të dëgjojnë zhurmën që bëjnë këpucët e tyre. Drejto diskutimin që nxënësit ta kuptojnë se disa lloje këpucësh bëjnë shumë zhurmë.

Përgjigje e mundshme: *Disa këpucë bëjnë shumë zhurmë disa këpucë janë më pak të zhurmshme.*

Formim gjuhësor

Shpesh për të përshkruar tingullin përdoret "I ulët". Kjo mund të shkaktojë ngatërresa sepse nxënësit mund ta lidhin këtë fjalë me kuptime të tjera, p.sh. lojë. Për të demonstruar karakteritikat "i ulët', "i lartë", mund të luhen tinguj "të ulët" dhe "të lartë". Në pamundësi të kësaj mund të përdorësh zërin tënd. Nxënësit mund të mbajnë në dorë një tendë ose copë letër të pastër të shkruar me fjalën "i ulët" në njërën anë dhe "i lartë" në anën tjetër. Kur prodhohet një tingull ata do të përdorin stendën apo fletën e letrës për të zgjedhur "i lartë" apo "i ulët"

Veprimtari plotësuese

Luaj një lojë dëgjimore duke përdorur lloje të ndryshme tingujsh, p.sh. zile ose duartrokitje, për të krahasuar largësitë nga mund të dëgjohen tingujt e ndryshëm.

Tingujt dhe lëvizja

Zbulon çfarë ndodh me tingujt kur ne lëvizim.



Njohuri përgatitore

Në këtë mësim nxënësit shqyrtojnë mënyrat që tingujt përdoren për të paralajmëruar rrezikun. Nxënësit flasin rreth ndryshimit të këmbëve të kafshëve të një grabitqari dhe présë, dhe se si putrat e këmbëve të një grabitqari zvogëlojnë zhurmën që kafshët bëjnë kur janë duke gjuajtur. Nxënësit zulojnë që njerëzit përdorin tingujt për të paralajmëruar afrimin e një makine të ndihmës së shpejtë.

Materiale burimore

Letër, lapsa, foto e një makine të ndihmës së shpejt, videoklip kafshësh grabitqare në botën e egër.

Fjalë kyçe

zë i ulët

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- Të studiojnë këmbët e kafshëve grabitqare dhe kafshëve pré;
- Të skicojnë këmbët e një kafshe grabitqare;
- Të diskutojnë cilat automjete kanë sirenë;
- Të shpjegojnë përdorimin e sirenave në automjete.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të krahasojnë të dëgjuarit me një vesh me atë me dy veshë, dhe do të diskutojnë për sigurinë rrugore.

Përfytyro sikur je në botën e kafshëve. Ty të duhet të afrohesh pa u vënë re deri te një kafshë. Çfarë këpucësh duhet të mbathësh?

Bëj një krahasim midis këpucëve të ndryshme që mbathin njerëzit dhe putrave të kafshëve. Kjo lidh temën e tingujve të kafshëve me atë çfarë kanë mësuar nxënësit në mësimet e mëparshme lidhur me ndryshimin e tingujve me largimin nga burimi. Disa kafshë janë tepër të afta në gjueti duke iu afruar presë fshehuarazi dhe disa të tjera jo. Kjo pjesërisht ka të bëjë me nivelin e zhurmës që ato prodhojnë kur lëvizin, gjë që lidhet me madhësinë dhe formën e putrës së këmbës.

Kërkoju nxënësve të diskutojnë pyetjen në librin e nxënësit.

Përgjigje e mundshme: *Shputa.*

Kërkoju nxënësve të shikojnë në librin e nxënësit foton e putrës së leopardit dhe të hienës që po gjuan antilopën. Përdor pyetje diskutuese që nxënësi të kuptojë që kafshët nuk mbathin këpucë, gjë që shpjegon se kafshët gjuetare kanë këmbë të lehta. Thekso formën e këmbës apo të një putre.

Shpjego që disa kafshë gjuetare zakonisht kanë putra në këmbët e tyre që i ndihmon të hidhen lehtë mbi kafshët e tjera. Tregoju këto në fotot e këmbëve të kafshëve. Shpjego se disa kafshë kanë thundra. Përdor foto thundrash që të shpjegosh kuptimin e fjalës. Bëju të qartë se kafshët me thundra zakonisht janë pré.

Shpjego se grabitqari është kafshë që gjuan në fshehtësi dhe ushqehet me kafshët e tjera. Ato përpiqen të afrohen sa më afër të jetë e mundur, përpara se kafsha tjetër ta dëgjojë atë; siç bëjnë nxënësit gjatë lojës. Shpjego që kafsha pré është e kundërta e kafshëve grabitqare. Ato janë kafshë që gjuhen për ushqim nga kafshët e tjera më të fuqishme ose më të mëdha.

Kërkoju nxënësve të diskutojnë:

- Çfarë ndryshimi ka midis thundrave dhe putrave? Putrat janë elastike dhe të buta dhe puthiten me sipërfaqen, kështu që nuk bëjnë zhurmë. Thundrat janë të forta dhe me to mund

të vrapojnë shpejt në sipërfaqe shkëmbore si dhe ato me bar. Por ato bëjnë më shumë zhurmë.

Çfarë makine me sirenë njeh ti? Si e ka emrin ajo?

Fillo duke u kërkuar nxënësve të listojnë në librin e nxënësit të gjitha emrat e makinave të emergjencës që njohin.

Shpjego që sirenat u bëjnë të njohur njerëzve se mund të ketë një rrezik. Ata gjithashtu u bëjnë të njohur njerëzve se shërbimet e emergjencës po vijnë. Në rrugët e ngarkuara me qarkullim shoferët e tjerë dëgjojne sirenat dhe hapin rrugën.

Përgjigje e mundshme: *Makinë zjarrfikëse, makinë policie, ambulancë, makinë e ndihmës së shpejtë.*

Për se u duhet sirena këtyre makinave?

Kërkoju nxënësve të diskutojnë pyetjen. Shpjegoju që njerëzit jo gjithmonë kanë në mendje një makinë emergjence, kështu që nuk mund të shohin gjithmonë kur afrohet një e tillë.

Kërkoju nxënësve të diskutojnë rreth arsyeve të tjera pse makinat e emergjencës kanë sirenë, p.sh. për t'u bërë të njohur njerëzve që po vjen ndihma ose për të paralajmëruar shoferët/ kalimtarët e tjerë që ata duhet të lirojnë rrugën.

Përgjigje e mundshme*: Njerëzit gjithmonë mund të dëgjojnë që po afrohet një makinë emergjence edhe nëse ato nuk e shikojnë atë.*

Vlerësimi i njohurive

Përdor rubrikën në fund të temës së mësimit për të vlerësuar të nxënit e nxënësve për këtë temë. Lejo nxënësit të plotësojnë detyrat në mënyrë të pavarur për të matur rezulatet e të nxënit.

Shkruaj dy arsye pse disa makina kanë sirenë?

Lexo me zë të lartë pyetjen përpara gjithë klasës. Kërkoju nxënësve fillimisht ta diskutojnë pyetjen me shokun/shoqen në krah. Pastaj të shkruajnë përgjigjen në librin e nxënësit.

Përgjigje të mundshme: *Për të informuar njerëzit për një rrezik. T'u bëjnë të njohur përdoruesve të tjerë të rrugës që po afrohet një makinë e ndihmës së shpejtë.*

Pse kafshët gjuetare i kanë putrat të buta?

Kërkoju nxënësve të kujtojnë çfarë kanë mësuar më parë. Kërkoju atyre të rishikojnë fotot e kafshëve në librin e nxënësit dhe ato që ti mund të kesh përdorur në shpjegimet e mëparshme. Lejoi nxënësit të kenë mundësi të diskutojnë pyetjen përpara se ata të shkruajnë përgjigjet në librin e nxënësit.

Përgjigje*: Kështu ato mund të hidhen fshehurazi mbi kafshët e tjera.*

Përsëritje dhe përforcim njohurish

Mbylle temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë veprimtarinë rishikuese reflektuese në faqen 81.

Formim gjuhësor

Shto figurat e makinave me emrat poshtë tyre. Sigurohu që nxënësit kanë shtuar përkufizimet për fjalët kyçe në rubrikën fjalor.

Veprimtari plotësuese

1 Kërkoju nxënësve të skicojnë një këmbë të shkëlqyer për grabitqarët dhe për prénë. Nëse kanë kohë ata mund të bëjnë këmbë me materiale të ndryshme, për të shqyrtuar nëse përbërja e materialeve shkakton ndryshim në zhurmën që ato bëjnë. (ti mund ta lidhësh këtë me vetitë e materialeve të studiuara në tematikën 4 "Nga çfarë përbëhen materialet"). Ata gjithashtu duhet të përpiqen të skicojnë këmbë që janë të përshatshme si për grabitqarët, ashtu edhe për prénë.

Mendo rreth ... përdor këtë detyrë për të zgjeruar të mësuarit rreth lëvizjes së tingullit. Prit një përgjigje e cila shpjegon: Tingujt lëvizin në valë nga sirena në veshët tanë, kështu që ne dëgjojmë sirenën.

Krahasimi i tingujve

Kupton se tingujt i dëgjon me veshë.



Njohuri përgatitore

Në mësimin e fundit nxënësit zbulojnë mënyrën se si ne i dëgjojmë tingujt. Ata mësojnë që tingujt lëvizin nga një burim për në veshët tanë. Ata vazhdojnë me zbulimin se ne përdorim veshët dhe sytë për t'u siguruar kur kapërcejmë rrugën, dhe bëjnë postera për sigurinë rrugore.

Materiale burimore

Muzikë apo tinguj të veçantë të inçizuar; materiale për poster; letër; mbrojtëse dëgjimi; shkumës me ngjyra.

Përshkrimi i mësimit

Çështjet kyçe mësimore për nxënësit në këtë temë janë:

- Të krahasojnë të dëgjuarit e tingullit me një vesh me të degjuarit me dy veshët;
- Të diskutojnë për sigurinë rrugore.

Në mësimin e ardhshëm nxënësit do të rishqyrtojnë mbi ato çfarë kanë mësuar në këtë tematikë.

Si mund t'i dëgjosh tingujt? Cila pjesë e trupit përdoret për të dëgjuar?

Kërkoju nxënësve të diskutojnë në grupe pyetjen:

- Si mund t'i dëgjosh tingujt?
- Cila pjesë e trupit përdoret për të dëgjuar tingujt?

Përgjigje e mundshme: *Unë/ne përdorim veshët tanë.*

Shpjego që tingulli lëviz nga burimi ku prodhohet drejt veshëve tanë. Deklaro që ne dëgjojmë kur tingulli hyn në vesh. Është veshi që na mundëson për të dëgjuar. Ne kemi dy veshë që na ndihmojnë të dëgjojmë tingujt rreth nesh.

Fakt ineresant

Referoju faktit interesant. Diskuto se si mund të dëgjojmë, nëse ne do të kishim vetëm një vesh si murgeshëza (kandërr grabitqare me një vesh).

Vëzhgim: A mund të dëgjosh vetëm me një vesh?

Qëllimi i këtij vëzhgimi është të mundësojë nxënësit të zbulojë se tingujt duken ndryshe, kur përdorim vetëm një vesh. Është e mundur të dëgjosh me një vesh, siç dëgjon murgeshëza, por është më mirë t'i përdorim të dy veshët.

Ty të nevojiten: një vend për t'u ulur i qetë dhe pa zhurma.

1 Qëndro në heshtje dhe mbyll sytë.

- Uli nxënësit në një vend të qetë dhe të sigurt ku mund të mbyllin sytë për pak kohë.

2 Mbulo me dorë njërin vesh dhe dëgjo.

- Bëj të mundur të ketë tinguj që nxënësit të dëgjojnë, p.sh. një muzikë në radio ose TV që transmetohet në një largësi të caktuar. Cakto vendin e dëgjimit të muzikës.

Pyeti nxënësit çfarë dëgjojnë. Bëj për klasën një listë me të gjithë tingujt. Pyeti nëse mund t'i dëgjojnë qartë tingujt në këtë çast.

3 Tani largoje dorën nga veshi dhe dëgjo.

- Kërkoju nxënësve t'i mbajnë sytë e mbyllur dhe të dëgjojnë përsëri.
- Pyet nxënësit si tingëllojnë tingujt tani. Pyeti nëse dëgjohen në njëfarë mënyre ndryshe.

A mund të dëgjosh të njëjtin tingull?

Kërkoju nxënësve të hapin sytë dhe të diskutojnë në grup nëse mund t'i dëgjonin të njëjtët tinguj më një vesh, ashtu si me të dy veshët.

Përgjigje të mundshme: *Po, por unë mund të dëgjoj më qartë më të dy veshët.*

1. Mbuloje veshin tjetër dhe dëgjo.

- Tani nxënësit mbyllin veshin tjetër dhe dëgjojnë përsëri. Kontrollo sëbashku me ta nëse rezultati është i njëjtë si më parë.

A dëgjon më mirë me të dy veshët apo me një?

Kërkoju nxënësve që të përdorin shënimet e tyre nga vëzhgimi për të diskutuar rreth pyetjes.

***Përgjigje e mundshme**: Dëgjimi është shumë më i mirë me të dy veshët se sa më një vesh. Ata mund të dëgjojnë më shumë se çfarë po ndodh rreth e përqark tyre.*

A të ndihmojnë sytë për të dëgjuar?

Kërkoju nxënësve të hapin sytë dhe të dëgjojnë për të kuptuar nëse ata mund të dëgjojnë më mirë me sy hapur. Ata duhet të përsërisin hapat 1-3 të vëzhgimit me sy të hapur.

Vëri nxënësit të diskutojnë rreth pyetjes në dyshe. Shpjegoju që veshët dhe sytë punojnë sëbashku për të na ndihmuar ne që të ruajmë veten.

***Përgjigje e mundshme:** Po, sepse unë mund të shoh çfarë dëgjoj gjithashtu dhe dëgjoj atë.*

Nxënësit fillojnë të mendojnë se si e përdorim dëgjimin tonë që të ruajmë veten. Kërkoju nxënësve të mendojnë sikur po kapërcejnë një rrugë më qarkullim të ngarkuar. Kërkoju të veprojnë sikur po e kalojnë rrugën. Jepu nxënësve role, p.sh. kalimtarë, autovetura, autobus, semaforë. Kërkoi 'trafikut' të bëjë zhurmat e duhura dhe të kalojnë me shpejtësi në anën tjetër të 'rrugës". Pyeti "kalimtarët" çfarë duhet të bëjnë që ta kalojnë rrugën në mënyrë të sigurt (d.m.th ."shiko, dëgjo"). Nxit diskutimin se ata të kuptojnë që duhet të përdorin sytë e tyre për të parë trafikun dhe veshët për të dëgjuar trafikun. Kujtoju nxënësve tingujt që ata dëgjuan gjatë ushtrimit "shëtitje dëgjimore". Disa tinguj (p.sh. sirenat) mund të vinin nga shumë larg por ato prap se prapë mund të dëgjoheshin shumë qartë. Pyet:

- Sa vëmendje duhet ti kushtosh një tingulli që vjen nga larg?

Bëj një postër për sigurinë rrugore. Tregoju shokëve/shoqeve se si t'i përdorin sytë dhe veshët kur duan të kalojnë rrugën.

Nxënësit mund të punojnë për posterat e tyre në grupe të vogla osë në mënyrë individuale. Siguroju nxënësve mjete të mjaftueshme krijuese për të bërë posterat.

Vlerësimi i njohurive

Kërkoju nxënësve të përfundojnë rubrikën në fund të mësimit për të vlerësuar të nxënit e tyre për këtë temë. Ata duhet ta plotesojnë në mënyrë të pavarur, për të treguar njohuritë e tyre.

Si mund të dëgjojmë? Qarko përgjigjen e saktë.

Kërkoju nxënësve të qarkojnë përgjigjen e saktë për secilën deklaratë: e saktë ose e gabuar.

Përgjigje:

Tingulli prodhohet nga syri ynë. *E gabuar*

Dy veshë të ndihmojnë për të dëgjuar më mirë se një. *E vërtetë*

Sytë dhe veshët të ndihmojnë për të kaluar rrugën më i/e sigurt. *E vërtetë*

Përsëritje dhe përforcim njohurish

Mbylle temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë rubrikën veprimtari rishiko dhe reflekto, fq. 87 të librit të nxënësit (shiko gjithashtu shënimet e mësuesit.)

Formim gjuhësor

Kërkoju nxënësve të plotësojnë fjalorin në "Tabelën e fjalëve". Të gjitha fjalët kyçe janë përdorur tashmë gjatë tematikës. Përdore këtë mundësi për të praktikuar drejtshkrimin dhe kuptimin e fjalëve 'vesh' dhe 'dëgjoj'. Këto fjalë tingëllojnë njëlloj, por kanë kuptime të ndryshme. Trego veshin tënd dhe shpjego se është pjesë e trupit që na ndihmon për të dëgjuar. Luaj një lojë në të cilën një nxënës thotë njërën nga fjalët 'vesh' ose 'dëgjoj' duke i gjuajtur (hedhur) atij/asaj një top të butë në të njëjtën kohë. Nxënësi pastaj duhet të formojë një fjali të thjeshtë ku të përdorë fjalën, p.sh: unë mund t'ju dëgjoj. Nxënësi pastaj shqipton ' vesh' ose 'dëgjoj', ndërsa i hedh topin një nxënësi tjetër.

Veprimtari plotësuese

Tregoju nxënësve se disa njërëz nuk mund të dëgjojnë aq mirë sa të tjerët. Pyeti nxënësit: Si mund t'i ndihmoni ata të kalojnë një rrugë të zënë? Mendo se për çfarë duhet të shikojnë ata kur u duhet të kalojnë rrugën.

Çfarë kemi mësuar rreth prodhimit të tingullit


Çfarë kemi mësuar rreth prodhimit të tingullit

Flasim dhe dëgjojmë

Kafshët prodhojnë tinguj për shumë arsye. Këtu janë paraqitur disa nga arsyet. A mund të plotësosh vendet bosh?

lajmërimin të dhënë të trembur

Për _____ e rrezikut

Për ___ _____ kafshët e tjera.

Për ___ _____ informacion.

Njerëzit dhe kafshët prodhojnë tinguj. Po sendet a prodhojnë tinguj? Shkruaj dy prej tyre.

Unë di se ka shumë sende që prodhojnë tinguj.

86

Tingujt dhe lëvizja

Autoambulancat kanë sirena. Tingulli i cilës autoambulancë është i lartë dhe i cilës është i ulët?

i lartë i ulët

a.

b.

Unë di se, kur tingujt largohen nga ne, dëgjohen më dobët.

Krahasimi i tingujve

Cilat nga shqisat janë më të rëndësishme për ne, kur kalojmë kryqëzimin? Shëno shqisat e sakta.

a. e nuhatjes b. e shijes c. e dëgjimit d. e prekjes e. e shikimit

Unë di që ne përdorim veshët për të dëgjuar tingujt.

87

Prodhimi i tingujve

Njohuri përgatitore

Qëllimi i kësaj pjesë është të nxitë nxënësit të përsëritin njohuritë e fituara në çdo temë mësimore të këaj tematikë. Çdo temë ka disa pyetje përforcuese, të cilave nxënësi duhet t'u përgjigjen. Këto janë pyetje që do të vlerësojnë njohuritë e nxënësit si dhe do të tregojnë të kuptuarin e temave nga ana e tij/saj.

Pas çdo grupi pyetjesh përforcuese ka disa formulime për përsëritje dhe reflektim, të cilave nxënësit duhet t'u përgjigjet.

Është e nevojshmë të lexosh formulimet dhe t'i ndihmosh nxënësit të plotësojnë rrethin e vetëvlerësimit, për të parë kështu se sa të sigurtë janë ata për njohuritë e fituara në temën mësimore.

Në klasën e parë nxënësit mund të ngjyrosin një fytyrë të qeshur apo të trishtuar për të treguar nivelin e tyre të sigurisë ose mund të vënë një shenjë vlerësimi, si p.sh. shenjën V.

Është e rëndësishme që nxënësit të tregojnë pjesët, në të cilat ata nuk ndjehen të sigurtë. Ky informacion është shumë i rëndësishëm për mësuesin dhe mundëson që të ofrosh ndihmën e nevojshme në vlerësimin përmbledhës (rubrika Vlerësimi i përmbledhës) në fund të tematikës.

Përsëritje dhe refleksione për njohuritë

Flasim dhe dëgjojmë

Kafshët prodhojnë tinguj për shumë arsye. Këtu janë paraqitur disa nga arsyet. A mund të plotësosh vëndet bosh?

Kërkoju nxënësve të rikujtojnë pse njerëzit dhe kafshët prodhojnë tinguj. Nxënësit mund të përmendin: për të përcjellë informacion, paralajmëruar rrezikun, frikësohen nga kafshët e tjera. Ato mund të përmendin gjithashtu për të biseduar. Shpjego me fjalë të thjeshta se të folurit është niveli më i lartë i komunikimit dhe është i kufizuar vetëm për njerëzit. Aftësia për të folur na bën ne qenien e gjallë më të suksesshme në Tokë.

Kur nxënësit të jenë të sigurtë për arsyet pse kafshët prodhojnë tinguj, kërkoju të plotësojnë vendet bosh në librin e nxënësit.

Përgjigje:

1 *Për <u>të lajmëruar</u> rrezikun.*
2 *Për <u>të trembur</u> kafshët e tjera.*
3 *Për <u>të dhënë</u> informacion.*

Njerëzit dhe kafshët prodhojnë tinguj. Po sendet a prodhojnë tinguj? Shkruaj dy prej tyre.

Diskuto dhe krahaso tingujt e prodhuar nga kafshët me tingujt e prodhuar nga njeriu: të prodhuara me sende, si vegla muzikore, telefon, TV, makineri, sirena etj.

Ti mund ta mbështetësh këtë veprimtari duke shkruar në tabelë përgjigjet e mundshme nga nxënësit.

***Përgjigje e mundshme**: Veglat muzikore, sirenat, telefoni, këmbana, zilja, etc.*

Tingujt dhe lëvizja

Autoambulancat kanë sirena. Tingulli i cilës autoambulancë është i lartë dhe i cilës është i ulët?

Pyeti nxënësit për ndryshimin midis të dëgjuarit të mësuesit kur ti je përballë klasës dhe kur je i kthyer me shpinë nga klasa. Thuaj një fjali me zë të ulët dhe kërkoi një nxënësi ta përsërisë çfarë the. Pastaj thuaj një fjali tjetër me të njëjtin zë dhe kërkoi nxënësit të ulur pas të parit nëse mund ta përsërisë atë.

Thekso se largësia nga veshi te burimi i tingullit ndikon se sa 'i lartë' ose 'i ulët' mund të na duket tingulli. Burimi mund të largohet nga nxënësi ose nxënësi mund të largohet nga burimi. Rezultati është i njëjtë: tingulli bëhet më pak i dëgjueshëm kur largohet nga veshi.

***Përgjigje**: a) I ulët , b) I lartë.*

Krahasimi i tingujve

Cilat nga shqisat janë më të rëndësishme për ne, kur kalojmë kryqëzimin? Shëno shqisat e sakta.

Kërkoju nxënësve të punojnë në dyshe. Njëri nxënës do të mbulojë veshët dhe tjetri do t'i pëshpërisë atij.

Pyet atë: A dëgjove çfarë tha shoku yt? *Jo.*

Përforco konceptin e lëvizjes së tingujve në veshët tanë. Derisa ato të hyjnë dhe të regjistrohen në trurin tonë, ne nuk dëgjojmë asgjë.

Diskuto me nxënësit ndjesinë e jashtëzakonshme të dëgjimit që kemi. Për shembull ne mund të dëgjojmë mijëra tinguj të ndryshëm muzikorë, tinguj kompleks gjuhësorë etj. Luaj muzikë dhe lexo gjuhën komplekse me shpejtësi për të treguar sa e mahnitshme është ndjesia e të dëgjuarit.

Përdor një skenar rruge-kalimi, për të sqaruar se si veshët tanë zbulojnë tingullin dhe drejtimin nga vjen ai. Bëj pyetje për të nxjerrë se ne kemi një vesh në secilën anë të kokës që na ndihmon të identifikojmë nga vjen tingulli. Sytë tanë përcaktojnë (burimin) se kush e prodhon tingullin. Dy shqisat punojnë sëbashku për të na mbrojtur nga rreziku.

***Përgjigje**: Nxënësit duhet të qarkojnë të dëgjuarit, të parit.*

Vlerësim përmbledhës

Formulimet për përsëritje dhe reflektim në librin e nxënësit janë një pikënisje e përkryer kur diskutohet për përparimin individual të çdo nxënësi. Ky informacion mund të përdoret gjithashtu për të krijuar një raport për çdo nxënës në fund të vitit shkollor.

Ai gjithashtu mund të jetë i dobishëm për të mbajtur një regjistër (vlerësimi) për të gjithë klasën për nivelin e përgjithshëm të sigurisë duke identifikuar çfarë mund të kenë nevojë të rishikohet më vonë (shih një shembull në tabelën e mëposhtme).

Formulimi për përsëritje dhe reflektim	Shumë i/e sigurt	Jo aq i/e sigurt	Jo i/e sigurt

Kjo analizë (apo ky feedback) mund të përdoret më pas për të formuar një program përmirësimi (program rehabilitimi), i cili do të shërbejë për të ndihmuar nxënësit që të përmirësohen në të ardhmen.

Thjesht mbaj dhe ruaj regjistrimin e të dhënave dhe analizën e vetëvlerësimeve të nxënësve.

Kërkohet një përshtypje e përgjithshme e vetë-vlerësimit të klasës, jo një regjistrim i vlerësimit individual të nxënësve (të dhëna individuale). Kjo është gjithçka që të duhet. P.sh.: pesëdhjetë përqind e klasës nuk ishin të sigurtë në lidhje me ...

Fjalor

bimë gjallesa; bimët e bëjnë vetë ushqimin e tyre duke përdorur ujin, ajrin (dioksidin e karbonit) dhe rrezet e diellit; bimët mund të jenë barishtore, shkurrre dhe drurë.

dëgjim (të dëgjuarit) një nga shqisat tona, shqisa e dëgjimit; kur diçka prodhon një tingull, ne e dëgjojmë me veshët tanë.

dëgjo ne dëgjojmë kur përqëndrohemi, kur përpiqemi të dëgjojmë një zë; kur mësuesi flet nxënësit përpiqen ta dëgjojnë.

diskuto kur flasim për diçka, kur bëjmë një diskutim në lidhje me të; kur diskutohet, idetë shkëmbehen lirisht me të tjerët, merren mendime për të zgjidhur sa më mirë një çështje.

dritë drita është formë e energjisë që mund ta shikojmë me sy. Drita vjen nga burime të ndryshme.

dru drurët janë bimë me kërcell të zhvilluar, me trung; ne përdorim dru për të bërë orendi, për ndërtimin e shtëpive etj.

e ngadaltë kur diçka është e ngadaltë, ajo harxhon shumë kohë për të lëvizur. Një breshkë është shumë e ngadaltë.

familje familja ka një nënë, një baba dhe fëmijët e tyre.

farë farat prodhohen nga bimët; nga farat rriten bimë që lulëzojnë; farat e disa bimëve hahen.

fermë një fermë është një vend ku prodhohet ushqim, ku rriten bimë të caktuara bujqësore ose mbahen lloje të caktuara kafshësh.

gisht ne kemi gishta të dorës (dhjetë) dhe gishta të këmbës (dhjetë); ata janë të lidhur me trupin në skajet e duarve dhe këmbëve tona.

gjej kur gjen diçka, do të thotë që e zbulon atë; ne mund ta shohim atë për herë të parë.

gjethe pjesë e bimës; bimët e bëjnë ushqimin në gjethet e tyre të gjelbra.

gju gjuri është vendi ku ndodh lidhja ndërmjet pjesës së sipërme të këmbës me pjesën e poshtme të saj.

gojë goja jonë është një hapje në kokë që na shërben për të ngrënë dhe për të folur; në gojë janë dhëmbët dhe gjuha.

gomë lëndë e zgjatëshme e bërë nga lëngu i një peme të veçantë.

ha ne hamë ushqim.

hundë hunda shërben për nuhatje; qentë e shpëtimit mund të nuhasin njerëz të varrosur në dëborë.

i pazgjatshëm një trup i ngurtë që nuk e rrit madhësinë kur tërhiqet.

i shpejtë një trup është i shpejtë kur lëviz shpejt. Makinat e Formula 1 mund të lëvizin shumë shpejt.

i zgjatshëm një material i cili rrit madhësinë gjatë tërheqjes.

jogjallesë diçka që kurrë nuk ka qenë e/i gjallë; shkëmbi, metali dhe xhami nuk kanë qenë asnjëherë të gjallë.

kafshë kafshët janë gjallesa; ato hanë, lëvizin, ndiejnë etj., por nuk janë në gjendje të mendojnë e të veprojnë në mënyrë të ndërgjegjshme.

këmbë ne kemi dy këmbë; ato janë pjesët e trupit që na shërbejnë për të qëndruar drejt dhe për të ecur; disa kafshë kanë thundra, putra apo këmbë të pajisura me membrana (p.sh., tek brekosa).

kërcell pjesa e fortë e një bime që mban gjethet.

kokë pjesa e sipërme e trupit të njeriut; shumica e kafshëve kanë trurin, sytë, veshët, hundën dhe gojën në kokën e tyre.

krah ne kemi dy krahë; krahët tanë janë pjesë të trupit tonë; ata janë të lidhur me trupin në shpatulla.

krahaso kur krahasojmë, shikojmë për gjërat që janë të njëjta dhe për ato që janë të ndryshme; p.sh., kur krahasojmë flokët bëjmë krahasimin e flokëve të shkurtër me ata të gjatë.

lëkundje kur ti lëkundesh, lëviz në ajër vazhdimisht para-prapa. Mund të lëkundësh krahët ose lëkundesh kur luan me shilarës.

letër letra bëhet duke përzier drurin me ujë dhe duke e shtrirë në fletë të rrafshta. Letrën e përdorim kur printojmë, si letër guzhine, si letër higjenike etj.

lëviz kur ndryshojmë vendndodhjen kemi lëvizur. Për të lëvizur ne përdorim pjesë të ndryshme të trupit. Psh. kur ecim, lëvizim këmbët. Lëvizje bëjnë edhe kafshët apo trupa të ndryshëm, si makinat etj.

lule lulet janë pjesë të një bime që bën fara.

material materiali është çfarë e përbën një trup. Pëlhura, plastika, druri janë lloje materialesh.

mbaj vesh ne mbajmë vesh kur përqëndrohemi të dëgjojmë një tingull, psh. kur flet mësuesi.

metal metalet janë të fortë, me shkëlqim dhe të ftohtë në prekje.

ndaj në shkencë ne ndajmë rezultatet dhe idetë tona me njerëzit e tjerë; ne u tregojmë atyre lidhur me atë që ne dimë dhe që kemi arritur.

ndalon ndalimi është e kundërta e nisjes. Psh. mund të nisësh vrapimin dhe pastaj të ndalosh.

ndjek ne ndjekim diçka kur e vërshtrojmë me kujdes. Kështu ndjekim një video ose TV.

njeri ti je një njeri, pjesëtar i shoqërisë njerëzore; njeriu është i aftë të mendojë e të flasë, të bëjë vegla e t'i përdorë ato.

nuhat nuhatja është një nga shqisat tona. Për të nuhatur ne përdorim hundën.

nuhatje (të nuhaturit) një prej shqisave tona; ne nuhatim në sajë të hundës.

parashikim kur ti parashikon nuk e di përgjigjen, por mendon se ke të drejtë.

pëlhurë material që përdoret për të bërë veshje, perde dhe mbulesa orendish.

përgjigje kur dikush na bën një pyetje, ne i japim një përgjigje.

pi ne pimë ujë dhe lëngje të tjera.

plastikë plastika prodhohet nga nafta. Plastikës mund t'i jepen forma shumë të ndryshme

prekje (të prekurit) një prej shqisave tona; ne prekim me lëkurë dhe ndjejmë, p.sh., nxehtësinë, të ftohtit, të butën, të fortën etj.

provë e drejtë (test i besueshëm) provë e drejtë është ajo provë, që ne ajo provë, që ne mund ta përsëritim; për të bërë një provë të drejtë ne ndryshojmë një gjë (faktor, që në këtë rast e quajmë ndryshore) për një kohë të caktuar; faktorët e tjerë i mbajmë të pandryshuar.

pyet kur duam të dimë diçka, ne bëjmë një pyetje.

pyetje kur ne duam të mësojmë diçka bëjmë një pyetje.

qelq qelqi është një material i thyeshëm, i ndritshëm dhe i tejdukshëm.

qenie të gjalla gjallesat mund të ushqehen, të rritet dhe të shumojnë veten e tyre; kafshët kanë shqisa, si shqisën e shikimit, të prekjes, të dëgjimit etj.

rrënjë pjesa kryesisht nën dhe e një bime barishtore, e një shkurreje apo e një druri; ajo e mban

Fjalor

	bimën të ngulur dhe i shërben për të thithur ujin (dhe kripërat minerale) nga toka; rrënjët e disa bimëve përdoren për ushqim, për të bërë barna apo pije etj.
rrit	gjallesat rriten dhe bëhen më të mëdha; drurët rriten dhe bëhen më të mëdha gjatë gjithë jetës së tyre.
rrotullim	kur kthen diçka që po lëviz ti ke ndryshuar drejtimin e lëvizjes. Psh. rrotullon çelësin ose dorezën e derës.
shfaq	kur ne tregojmë diçka dhe duam që të tjerët ta shohin; shkencëtarët shfaqin (tregojnë) rezultatet e tyre, në mënyrë që njerëzit mund të mësojnë prej tyre.
shije	një prej shqisave tona; ne shijojmë në sajë të gjuhës sonë, shijojmë ushqimin që hamë.
shikim (të shikuarit)	një prej shqisave tona; sytë na shërbejnë për të parë.
shiko	kur ne shikojmë një njeri apo një objekt ne përdorim sytë tanë; pra, përpiqemi të dallojmë diçka me anë të shikimit.
shkëmbej	në shkencë ne i shkëmbejmë idetë dhe rezultatet tona me njerëzit e tjerë duke u treguar çfarë dimë.
shqisë	me anë të shqisave ne njohim botën; pesë shqisat tona janë shqisa e shikimit (e të shikuarit), e dëgjimit (e të dëgjuarit), e prekjes (e të prekurit), e nuhatjes (e të nuhaturit) dhe e shijes (e të shijuarit).
skico	bëj një vizatim me disa vija duke paraqitur vetëm linjat kryesore, si punë paraprake për ta plotësuar më pas; duke skicuar figura ne ndihmojmë në shpjegimin e ideve.
sup	supet ndodhen në pjesën e sipërme të krahëve tanë; ata bashkojnë krahët me trupin.
supozo	kur supozon, nuk e di përgjigjen, por mendon se ajo (përgjigja) mund të jetë e drejtë.
sy	ne shohim gjërat me sytë tanë; disa kafshë kanë sy të mëdhenj për t'u ndihmuar që të shohin natën.
thuaj	kur flasim, themi fjalë për t'u treguar të tjerëve lidhur me idetë tona.
tingull	tingulli shkaktohet prej dridhjeve. Ti e dëgjon tingullin me anë të veshëve. Kur ti godet një daulle, ajo dridhet dhe prodhon tingull
tregoj	kur ti i tregon diçka dikujt, bisedon me të për ato që di ose për idetë e tua.
trup	trupi i njeriut apo i një kafshe përfshin të gjitha pjesët që e ndërtojnë.
ujë	në kushte të zakonshme uji është lëng. Ai është baza e jetës së qënieve të gjalla. Mund të gjëndet në formë të ngurtë (akull) dhe të gaztë (avull).
ushqim	kafshëve u nevojitet ushqim për energji dhe për t'u rritur; bimët e bëjnë vetë ushqimin e tyre nga uji, ajri dhe rrezet e diellit.
vesh	me veshët tanë ne dëgjojmë tingujt; veshët kanë forma dhe madhësi të ndryshme.
vizato	vizatojmë një pamje për të shpjeguar idetë tona.
zbulo	kur ne mësojmë rreth tyre, ne zbulojmë gjëra rreth tyre.
zë	zëri ynë është tingulli që prodhojmë kur flasim ose këndojmë.
zë i lartë	një zë i lartë është e kundërta e një zëri të qetë (të ulët, të butë)
zë i qetë	i qetë është e kundërta e zërit të lartë. Kur duam të dëgjojmë zëra të qetë duhet të mbajmë vesh me kujdes.
zgjedh	kur ne veçojmë diçka nga një grup gjërash, themi se kemi zgjedhur.